

Eknath Easwaran dhe Diana Morrison

Bhagavad Gita e shqipëruar

*(Vargjet, pjesë nga parathënia e përkthyesit në anglisht
dhe hyrjet e kapitujve)*

përzgjedhi dhe shqipëroi Ridvan Bunjaku
nëntor 2020, janar-shkurt, gusht-tetor 2022

Përmbajtja

Bhagavad Gita	3
Kapitulli një: Lufta përbrenda	3
Kapitulli dy: Kuptimi intuitiv i Vetes.....	7
Kapitulli tre: Shërbimi pa-veten	14
Kapitulli katër: Urtia në veprim	18
Kapitulli pesë: Heqja dorë dhe shijimi	22
Kapitulli gjashtë: Praktika e meditimit	25
Kapitulli shtatë: Urtia nga kuptimi intuitiv	30
Kapitulli tetë: Esenca e përhershme e Zotit	33
Kapitulli nëntë: Rruga mbretërore	36
Kapitulli dhjetë: Bukuria madhështore hyjnore.....	40
Kapitulli njëmbëdhjetë: Vegimi kozmik	44
Kapitulli dymbëdhjetë: Rruga e dashurisë.....	51
Kapitulli trembëdhjetë: Fusha dhe njohësi.....	53
Kapitulli katërbëdhjetë: Forcat e evolucionit.....	56
Kapitulli pesëmbëdhjetë: Vetja supreme.....	59
Kapitulli gjashtëmbëdhjetë: Dy rrugët.....	61
Kapitulli shtatëmbëdhjetë: Fuqia e besimit	64
Kapitulli tetëmbëdhjetë: Liria dhe heqja dorë.....	67
Parathënia dhe hyrjet e kapitujve	74
Hyrje	75
<i>Sfondi upanishadik dhe monoteizmi</i>	77
<i>Esenca e Gitës</i>	79
<i>Një imazh më i lartë</i>	87
<i>Besimi dhe evolucioni shpirtëror</i>	89
Kapitulli një: Lufta përbrenda	93
Kapitulli dy: Kuptimi intuitiv i Vetes.....	96
Kapitulli tre: Shërbimi pa-veten	101
Kapitulli katër: Urtia në veprim	104
Kapitulli pesë: Heqja dorë dhe shijimi	107
Kapitulli gjashtë: Praktika e meditimit	110
Kapitulli shtatë: Urtia nga kuptimi intuitiv	114
Kapitulli tetë: Esenca e përhershme e Zotit.....	117
Kapitulli nëntë: Rruga mbretërore	122
Kapitulli dhjetë: Bukuria madhështore hyjnore.....	125
Kapitulli njëmbëdhjetë: Vegimi kozmik	128
Kapitulli dymbëdhjetë: Rruga e dashurisë.....	130
Kapitulli trembëdhjetë: Fusha dhe njohësi.....	134
Kapitulli katërbëdhjetë: Forcat e evolucionit.....	137
Kapitulli pesëmbëdhjetë: Vetja supreme.....	139
Kapitulli gjashtëmbëdhjetë: Dy rrugët.....	141
Kapitulli shtatëmbëdhjetë: Fuqia e besimit	143
Kapitulli tetëmbëdhjetë: Liria dhe heqja dorë.....	145
Bibliografia	148
Online	148
Licensimi.....	148

Bhagavad Gita

Kapitulli një: Lufta përbrenda

D H R I T A R A S H T R A

¹ O Sanxhaja, më trego se çka ndodhi në Kurukshetra, në fushën e d'harmës, ku u mblodhën për të luftuar familja ime dhe Pandavët.

S A N X H A J A

² Pasi i inspektoi forcat e Pandavëve të rreshtuara për betejë, princi Durjod'hana iu afrua mësuesit të tij, Drona, dhe foli. ³ “O mësuesi im, shikoje këtë ushtri të fuqishme të Pandavëve, të grumbulluar nga vetë dishepulli yt i talentuar, Jud'hishthira. ⁴ Ka luftëtarë heroikë dhe harkëtarë të shkëlqyer që janë të barabartë me Bhimën dhe Arxhunën: Jujudhana, Virata, Drupada i fuqishëm, ⁵ Dhristaketu, Çetikana, mbreti trim e i vendosur i Kashit, Puruxhit, Kuntibhoja, udhëheqësi i madh Shaibja, ⁶ Judhamanju i fuqishëm, Uttamaujas trim e i vendosur dhe djali i Subhadrës, si dhe djemtë e Draupadit. Të gjithë këta komandojnë karroca të fuqishme.

⁷ “O më i miri i brahminëve, dëgjoji emrat e atyre që dallohen ndër forcat tona:

⁸ Bhishma, Karna, dhe Kripa fitimtar; Ashvatthama, Vikarna dhe djali i Somadattës.

⁹ “Ka edhe shumë të tjerë, heronj që e japin jetën për hir timin, të gjithë të aftë në luftë dhe të armatosur me armë të ndryshme. ¹⁰ Ushtria jonë është e pakufizuar dhe e komanduar nga Bhishma; e tyrja është e vogël dhe e komanduar nga Bhima. ¹¹ Secili le ta zërë vendin e vet të duhur dhe le të qëndrojë fort duke e përkrahur Bhishmën!”

¹² Pastaj Bhishma i fuqishëm, gjyshi, më i vjetri nga të gjithë Kurutë, për ta brohoritur Durjod'hanën, gjëmoi si luan dhe i ra borisë. ¹³ Dhe pas Bhishmës, u ngrit një zhurmë e madhe e brirëve të guaskave dhe të lopëve dhe e goditjeve nëpër daulle.

¹⁴ Pastaj Sri Krishna dhe Arxhuna, që po qëndronin në një karrocë të fuqishme me kuaj të bardhë në zgjedhë u frynë brirëve të tyre hyjnorë të guaskave. ¹⁵ Sri Krishna e fryu bririn që quhej Pançaxhania, dhe Arxhuna e fryu atë të quajtur Devadatta. Bhima i fuqishëm i fryu bririt të fuqishëm Paundra. ¹⁶ Judhishthira, mbreti, i biri i Kuntit, i fryu bririt Ananta vixhaja; edhe Nakula dhe Sahadeva i frynë brirët e vet. ¹⁷ Pastaj mbreti i Kashit, harkëtari kryesor, luftëtari i madh Shikhanid, Dhristadajumna, Virata, Satjaki i pathyeshëm, ¹⁸ Drupada, të gjithë djemtë e Draupadit, dhe djali krahë-fortë i Subhadrës u bashkuan, ¹⁹ dhe zhurma çau nëpër zemrën e ushtrisë së Durjod'hanës. Vërtet, tingulli ishte i zhurmshëm, duke bërë jehonë nëpër tërë qiellin dhe tokën.

²⁰ Pastaj, o Dhritarashtra, zotërues i tokës, pasi i pa forcat e djalit tënd të vendosura nëpër vendet e tyre dhe luftën që donte të fillonte, Arxhuna ia tha këto fjalë Sri Krishnës:

A R X H U N A

²¹ O Krishna, çoje qerren time ndërmjet dy ushtrive. ²² Dua t'i shoh ata që duan të luftojnë me mua. Me kë do të bëhet kjo betejë? ²³ Dua t'i shoh ata që janë mbledhur për të luftuar për Durjodhanën, ata që kërkojnë ta kënaqin djalin dashakeq të Dhritarashtrës duke u angazhuar në luftë.

S A N X H A J A

²⁴ Kështu foli Arxhuna, dhe Sri Krishna, duke e ngarë qerren e tij të shkëlqyer ndërmjet dy ushtrive, ²⁵ përballë Bhishmës dhe Dronës dhe të gjithë mbretërve të tokës, tha: “Arxhuna, ja ku janë mbledhur të gjithë Kuru-të”.

²⁶ Dhe Arxhuna, duke qëndruar midis dy ushtrive, pa baballarë dhe gjyshër, mësues, xhaxhallarë dhe vëllezër, bij e nipa, vjehërr e miq. Duke i parë familjarët e tij të vendosur në anën e kundërt, ²⁸ Arxhuna u pushtua nga pikëllimi. Duke u dëshpëruar, i tha këto fjalë:

A R X H U N A

O Krishna, i shoh familjarët e mi këtu në ankth për të luftuar, ²⁹ dhe gjymtyrët po më dobësohen; goja më është tharë, trupi po më dridhet dhe flokët po më ngriten. ³⁰ Lëkura po më digjet dhe harku Gandiva më ka rrëshqitur nga dora. Nuk jam në gjendje të rri në këmbë; më duket sikur mendja po më rrotullohet. ³¹ Këto shenja e parashikojnë të keqen për ne. Nuk shoh se mund të vijë ndonjë e mirë nga vrasja e familjarëve tanë në betejë. ³² O Krishna, nuk kam kurrfarë merak për fitore, as për mbretëri as për kënaqësitë. Çfarë dobie ka një mbretëri apo kënaqësi apo edhe jeta, ³³ nëse ata për hir të të cilëve i kemi merak këto gjëra – ³⁴ mësuesit, baballarët, djemtë, gjyshërit, xhaxhallarët, vjehrrit, nipërit dhe të tjerët me lidhje familjare – po angazhohen në këtë betejë, duke hequr dorë nga pasuria dhe jeta e tyre? ³⁵ Edhe po të më vrisnin, nuk do të doja t’i vrisja, as të bëhesha sundimtar i tri botëve. Aq më pak vetëm i tokës?

³⁶ O Krishna, çfarë kënaqësie do të mund të gjenim në vrasjen e djemve të Dhritarashtrës? Do të bëheshim mëkatarë duke i vrarë këta njerëz, edhe pse janë të këqij. ³⁷ Bijtë e Dhritarashtrës janë të një familjeje me ne; prandaj nuk do të duhej t’i vrisnim. Si mund të fitojmë lumturi duke i vrarë anëtarët e familjes sonë?

³⁸ Edhe pse ata janë të pushtuar nga lakmia dhe nuk e shohin asnjë të keqe në shkatërrimin e familjeve apo në plagosjen e miqve, ne i shohim këto të këqija.

³⁹ Pse nuk duhet të largohemi nga ky mëkat? ⁴⁰ Kur një familje bie, traditat e lashta shkatërrohen. Me to humbin themelet shpirtërore për jetën dhe familja e humb ndjesinë e unitetit. ⁴¹ Aty ku nuk ka ndjesi të unitetit, gratë e familjes korruptohen; dhe me korruptimin e grave të saj, shoqëria zhytet në kaos. ⁴² Kaosi shoqëror është ferr për familjen si dhe për ata që e kanë shkatërruar familjen. Ai e prish procesin e evolucionit shpirtëror të nisur nga paraardhësit tanë. ⁴³ Themelet shpirtërore të përhershme të familjes e të shoqërisë do të shkatërroheshin nga këto vepra të tmerrshme, që e cenojnë unitetin e jetës.

⁴⁴ Thuhet se ata të cilëve u është shkatërruar d'harma familjare, rrinë në ferr.

⁴⁵ Ky është mëkat i madh! Jemi të përgatitur t'i vrasim familjarët tanë për shkak të lakmisë për kënaqësitë e një mbretërie. ⁴⁶ Mua do të më binte më mirë nëse bijtë e Dhritarashtrës, me armë në dorë, do të më sulmonin në betejë dhe të më vrisnin të paarmatosur dhe duke mos rezistuar.

S A N X H A J A

⁴⁷ I pushtuar nga pikëllimi, Arxhuna i tha këto fjalë. Dhe duke e hedhur harkun dhe shigjetat e tij, u ul në qerren e tij në mes të fushëbetjës.

Kapitulli dy: Kuptimi intuitiv i Vetes

S A N X H A J A

¹ Këto janë fjalët që Sri Krishna ia tha Arxhunës së dëshpëruar, sytë e të cilit digjeshin me lotë të pikëllimit dhe të hutisë:

K R I S H N A

² Ky dëshpërim dhe kjo dobësi në kohë të krizës janë të këqij dhe të padenjë për ty, Arxhuna. Si ke rënë në një gjendje kaq të largët nga rruga e çlirimit? ³ Nuk të ka hije t'i jepesh kësaj dobësie. Ngritu me zemër të guximshme dhe shkatërroje armikun.

A R X H U N A

⁴ Si mund ta bëj veten ndonjëherë të luftoj kundër Bhishmës dhe Dronës, që janë të denjë për nderim? Si mundem, Krishna? ⁵ Sigurisht do të ishte më mirë ta kaloja jetën duke lypur sesa t'i vrisja këta shpirtra të mëdhenj e të denjë! Po t'i vrisja, çdo kënaqësi që do ta gjeja do të ndotej. ⁶ Madje as nuk e di se çka do të ishte më mirë: t'i mposhtim apo të na mposhtin. Bijtë e Dhritarashtrës na u kanë kundërvënë; por pse do të na interesonte të jetonim po t'i vrisnim?

⁷ Vullneti më është paralizuar dhe jam krejtësisht i hutuar. Më trego se cila është rruga më e mirë për mua. Më lejo të jem dishepulli yt. Kam rënë te këmbët e tua; më jep udhëzime. ⁸ Çka mund ta kapërcejë një pikëllim që ma dobëson tërë gjallërinë? Madje edhe pushteti mbi njerëzit e perënditë apo pasuria e një perandorie duken boshe.

S A N X H A J A

⁹ Kjo është mënyra se si Arxhuna, luftëtari i madh, i foli Sri Krishnës. Me fjalët: “O Krishna, nuk do të luftoj”, ra në heshtje. ¹⁰ Gjersa rrinin mes dy ushtrive, Sri Krishna buzëqeshi dhe iu përgjigj Arxhunës, që ishte zhytur në dëshpërim:

K R I S H N A

¹¹ Ti flet sinqerisht, por pikëllimi yt është pa shkak. Të urtët nuk pikëllohen as për të gjallët as për të vdekurit. ¹² Nuk ka pasur kurrë ndonjë kohë kur ti dhe unë dhe mbretërit e mbledhur këtu nuk kemi ekzistuar, as s’do të ketë ndonjë kohë kur do të ndalemi së ekzistuari. ¹³ Siç e banon i njëjti person trupin gjatë fëmijërisë, rinisë dhe pleqërisë, ashtu edhe në kohën e vdekjes ai e fiton një trup tjetër.

¹⁴ Kur shqisat i kontaktojnë objektet e shqisave, një person e përjeton të ftohtin apo nxehtësinë, kënaqësinë apo dhembjen. Këto përjetime janë kalimtare; vijnë e shkojnë. Pranoji me durim, Arxhuna. ¹⁵ Ata që janë të pandikuar nga këto ndryshime, që janë të njëjtë në kënaqësi e dhembje, janë vërtet të urtë dhe të përshtatshëm për pavdekësi. Pohoje vendosmërisht fuqinë tënde dhe kuptoje intuitivisht këtë!

¹⁶ E papërhershëmja nuk ka realitet; realiteti qëndron në të përhershmen. Ata që e kanë parë kufirin mes këtyre dyjave e kanë arritur fundin e tërë dijes. ¹⁷ Kuptoje intuitivisht atë që e përshkon gjithësinë dhe është e pashkatërrueshme; asnjë fuqi nuk mund të ndikojë në këtë realitet të pandryshueshëm, të pashueshëm. ¹⁸ Trupi është i vdekshëm, por ai që rri në trup është i pavdekshëm dhe i pamatshëm. Prandaj, Arxhuna, lufto në këtë betejë.

¹⁹ Njëri beson se është vrasësi i dhunshëm, tjetri beson se është i vrari. Të dy janë të paditur; nuk ka as vrasës as të vrarë. ²⁰ Kurrë nuk je lindur; kurrë nuk do të vdesësh. Kurrë nuk ke ndryshuar; kurrë s’mund të ndryshosh. I palindur, i përhershëm, i pandryshueshëm, më i vjetër se koha, ti nuk vdes kur vdes trupi.

²¹ Duke e kuptuar intuitivisht atë që është e pashkatërrueshme, e përhershme, e palindur dhe e pandryshueshme, si mund të vrasësh apo ta bësh tjetrin të vrasë?

²² Siç i braktis dikush rrobat e konsumuara dhe fiton të reja, ashtu kur trupi konsumohet – një tjetër fitohet nga Vetja, e cila jeton përbrenda.

²³ Vetja nuk mund të shpohet nga armët apo të digjet nga zjarri; uji nuk mund ta lagë, as era nuk mund ta thajë. ²⁴ Vetja nuk mund të shpohet a të digjet, të laget a të thahet. Është e përhershme dhe e pafund, duke qëndruar në themelet e palëvizshme të përherësisë. ²⁵ Vetja është e pamanifestuar, përtej tërë mendimit, përtej tërë ndryshimit. Duke e ditur këtë, nuk duhet të pikëllohesh.

²⁶ O Arxhuna i fuqishëm, edhe nëse e beson Vetën t'i nënshtrohet lindjes dhe vdekjes, nuk duhet të pikëllohesh. ²⁷ Vdekja është e pashmangshme për të gjallët; lindja është e pashmangshme për të vdekurit. Meqë këto janë të pashmangshme, nuk duhet të pikëllohesh. ²⁸ Çdo krijesë është e pamanifestuar fillimisht dhe pastaj e arrin manifestimin. Kur i ka ardhur fundi, prapë bëhet e pamanifestuar. Çka ka për t'u vajtuar këtu?

²⁹ Lavdia e Vetes vërehet nga pak njerëz, dhe pak njerëz e përshkruajnë atë; pak njerëz dëgjojnë por shumë njerëz pa kuptuar. ³⁰ Vetja e të gjitha qenieve – që jeton brenda trupit – është e përhershme dhe nuk mund të dëmtohet. Prandaj, mos u pikëllo.

³¹ Duke e marrë parasysh d'harmën tënde, nuk duhet të lëkundesh. Për një luftëtar, nuk ka asgjë më lart se një luftë kundër së keqes. ³² Luftëtari i përballur me një luftë të tillë duhet të jetë i kënaqur, Arxhuna, se ajo vjen si portë e hapur për në qiell. ³³ Por nëse ti nuk merr pjesë në këtë betejë kundër së keqes, do të bësh mëkat, duke e cenuar d'harmën tënde dhe nderin tënd.

³⁴ Tregimi i çnderimit tënd do të përsëritet pafundësisht; dhe për një njeri të nderit, çnderimi është më i keq se vdekja. ³⁵ Këta luftëtarë trima do të mendojnë se je tërhequr nga beteja për shkak të frikës, dhe ata që dikur të çmonin do të të

trajtojnë pa respekt. ³⁶ Armiqtë e tu do të tallen me forcën tënde dhe do të thonë gjëra që nuk duhet të thuhën. Çka mund të jetë më e dhembshme se kjo?

³⁷ Vdekja do të thotë arritja e qiellit; fitorja do të thotë kënaqësia e tokës. Prandaj ngritu, Arxhuna, i vendosur për të luftuar! ³⁸ Duke e bërë veten njësoj në dhembje e kënaqësi, fitim e humbje, fitore e disfatë, angazhohu në këtë betejë të madhe dhe do të jesh i çliruar nga mëkati.

³⁹ E ke dëgjuar shpjegimin intelektual të Sankhja-s, Arxhuna; tash dëgjoji parimet e jogës. Duke i praktikuar këto mund t'i këputësh zinxhirët e karmës. ⁴⁰ Në këtë rrugë, përpjekja kurrë nuk shkon kot, dhe nuk ka dështim. Qoftë edhe pak përpjekje drejt vetëdijes shpirtërore do të të mbrojë nga frika më e madhe.

⁴¹ Ata që e ndjekin këtë rrugë, duke vendosur thellë brenda vetes të më kërkojnë veç mua, e arrijnë njëshmërinë e destinimit. Për ata që u mungon vendosmëria, vendimet e jetës janë me shumë degë dhe të pafundme.

⁴² Ka njerëz të paditur që flasin fjalë të lulëzuara dhe kënaqen me ligjin pikë për pikë, duke thënë se nuk ka asgjë tjetër. ⁴³ Zemrat e tyre janë plot me merake vetjake, Arxhuna. Ideja e tyre e qiellit është kënaqësia e tyre, dhe synimi i të gjitha aktiviteteve të tyre është kënaqësia dhe pushteti. Fruti i veprimeve të tyre është rilindja e vazhdueshme. ⁴⁴ Ata, mendjet e të cilëve janë rrëmbyer nga ndjekja e kënaqësisë dhe e pushtetit janë të paaftë ta ndjekin qëllimin suprem dhe nuk do ta arrijnë samadhi-n.

⁴⁵ Shkrimet e shenjta i përshkruajnë tri gunat. Por ti duhet të jesh i lirë nga veprimi i gunave, i mirëvendosur në të vërtetën e përhershme, i vetë-kontrolluar, pa ndonjë ndjesi të dualitetit apo merak për të fituar dhe grumbulluar.

⁴⁶ Si një rezervuar që ka pak dobi kur i gjithë fshati është përmbytur, shkrimet e shenjta kanë pak dobi për burrin apo gruan e përndritur, që e sheh Zotëruesin^a kudo.

⁴⁷ E ke të drejtën ndaj punës, por kurrë ndaj frutit të punës. Kurrë nuk duhet të angazhohesh në veprim për hir të shpërblimit, as s’duhet të etesh për joveprim.

⁴⁸ Kryeje punën në këtë botë, Arxhuna, si njeri i mirëvendosur brenda vetes – pa lidhje vetjake, dhe njësoj si në sukses edhe në disfatë. Se joga është njëtrajtshmëria e përsosur e mendjes.

⁴⁹ Kërko strehim në qëndrimin mendor të shkëputjes dhe do ta grumbullosh pasurinë e vetëdijes shpirtërore. Ata që janë të motivuar veç nga merak për frutat e veprimit janë të mjerë, se janë vazhdimisht në siklet për rezultatet e asaj që e bëjnë. ⁵⁰ Mirëpo, kur vetëdijesia është e unifikuar, tërë ankthi i kotë lihet prapa. Nuk ka shkak për shqetësim, qoftë nëse gjërat shkojnë mirë apo keq. Prandaj, përkushtoj disiplainave të jogës, se joga është aftësi në veprim.

⁵¹ Të urtët e unifikojnë vetëdijesinë e vet dhe e braktisin lidhjen me frutat e veprimit, e cila e lidh një person me rilindje të vazhdueshme. Kështu e arrijnë një gjendje përtej tërë të keqes.

⁵² Kur mendja jote ta ketë kapërcyer hutinë e dualitetit, do ta arrish gjendjen e mospërfilljes hyjnore ndaj gjërave që i dëgjon dhe gjërave që i ke dëgjuar. ⁵³ Kur je i pandjenjë nga hutia e ideve dhe mendja jote është plotësisht e bashkuar në samadhi të thellë, do ta arrish gjendjen e jogës së përsosur.

A R X H U N A

⁵⁴ Më trego për ata që jetojnë të mirëvendosur në urti, gjithmonë të vetëdijshëm për Vetën, O Krishna. Si flasin? Si rrinë ulur? Si lëvizin përreth?

^a Fjala “Lord” është përkthyer “Zotërues” për dallim nga fjala “God” që është përkthyer “Zot” (shënim i shqipëruarit).

K R I S H N A

⁵⁵ Jetojnë në urti ata që e shohin veten në të gjitha dhe të gjitha në ta, që kanë hequr dorë nga çdo merak vetjak dhe nga çdo ndjesi shumë e fortë e dëshirimit shqisor që e torturon zemrën. ⁵⁶ As të trazuar nga pikëllimi as të etur pas kënaqësisë, jetojnë të lirë nga epshi e frika e zemërimi. Të mirëvendosur në meditim, janë vërtet të urtë. ⁵⁷ Të paprangosur më nga lidhjet vetjake, as nuk ngazëlleshen nga fati i mirë as nuk dëshpërohen nga i keqi. Të tillë janë të thellët në shpirt.

⁵⁸ Siç i tërheq një breshkë gjymtyrët e saj, të urtët mund t'i tërheqin shqisat e tyre sipas dëshirës. ⁵⁹ Aspirantët abstenojnë nga kënaqësitë shqisore, por ende kanë dëshirë të zjarrtë për to. Këto dëshirime të gjitha zhduken kur ata e shohin qëllimin më të lartë. ⁶⁰ Madje edhe atyre që e ecin rrugën, shqisat e stuhishme mund t'ua marrin mendtë. ⁶¹ Jetojnë në urti ata që i nënshtrojnë shqisat e tyre dhe e mbajnë mendjen e vet gjithmonë të interesuar thellësisht në mua.

⁶² Kur vazhdon të mendosh për objektet shqisore, vjen lidhshmëria. Lidhshmëria e prodhon merakun, epshin e zotërimit që digjet në zemërim. ⁶³ Zemërimi e mjegullon gjykimin; më nuk mund të mësosh nga gabimet e shkuara. Humbet fuqia për të zgjedhur midis të urtës dhe të paurtës, dhe jeta jote është shpërdorim i plotë. ⁶⁴ Por kur lëviz në mes të botës së shqisave, i lirë si nga lidhshmëria edhe nga neveria, ⁶⁵ vjen paqja në të cilën mbarojnë të gjitha pikëllimet, dhe ti jeton në urtinë e Vetes.

⁶⁶ Mendja e pabashkuar nuk është fare e urtë; si mund të meditojë? Si të jetë në paqe? Kur ti nuk njeh paqe, si mund të njohësh gëzim? ⁶⁷ Kur e lë mendjen ta ndjekë thirrjen e shqisave, ato ta largojnë gjykimin më të mirë si stuhitë që e shmangin një barkë nga drejtimi i saj i planifikuar në det.

⁶⁸ Përdore tërë fuqinë tënde për t'i çliruar shqisat si nga lidhshmëria edhe nga neveria dhe jeto në urtinë e plotë të Vetes. ⁶⁹ Një urtak i tillë zgjohet ndaj dritës në natën e të gjitha krijesave. Ajo të cilën bota e quan ditë është nata e paditurisë për të urtin.

⁷⁰ Si lumenjtë që rrjedhin në oqean por nuk mund ta bëjnë oqeanin e paanë të vërshojë, ashtu derdhen rrjedhat e botës-shqisore në detin e paqes që është urtaku. Por kjo nuk është kështu me merakuesin e merakeve.

⁷¹ Janë përgjithmonë të lirë ata që heqin dorë nga të gjitha meraket vetjake dhe shkëputen nga kafazi-ego i “unë”, “mua” dhe “imja” për t’u bashkuar me Zotëruesin. ⁷² Kjo është gjendja supreme. Arrije këtë dhe kalo nga vdekja në pavdekësi.

Kapitulli tre: Shërbimi pa-veten

A R X H U N A

¹ O Krishna, ke thënë se njohja është më e madhe se veprimi; pse pra më kërkon ta nis e ta bëj këtë luftë të tmerrshme? ² Këshilla jote duket jokonsistente. Ma jep një rrugë që më çon tek e mira supreme.

K R I S H N A

³ Në fillin e kohës i deklarova dy rrugë për zemrën e pastër – xhnana joga: rruga e reflektimit të thellë e urtisë shpirtërore, dhe karma joga: rruga aktive e shërbimit pa-veten.

⁴ Ai që i shmanget veprimit nuk e arrin lirinë; askush nuk mund ta fitojë përsosmërinë duke u përmbajtur nga puna. ⁵ Në të vërtetë, nuk ka njeri që pushon as edhe një çast; të gjitha krijesat janë të shtyra në veprim nga natyra e tyre.

⁶ Ata që përmbahen nga veprimi gjersa e lejojnë mendjen të rrijë në kënaqësinë shqisore nuk mund të quhen aspirantë të sinqertë shpirtërore. ⁷ Por shkëlqejnë ata që i kontrollojnë shqisat e veta përmes mendjes, duke i përdorur për shërbim pa-veten.

⁸ Përmbushi të gjitha detyrat e tua; veprimi është më i mirë se mosveprimi. Madje dhe për ta mirëmbajtur trupin tënd, Arxhuna, je i detyruar të veprosh.

⁹ Veprimi vetjak e burgos botën. Vepro pa-veten, pa ndonjë mendim për përfitim personal.

¹⁰ Në fillim, njerëzimi dhe obligimi i shërbimit pa-veten u krijuan së bashku. “Përmes shërbimit pa-veten, gjithmonë do të jesh i frytshëm dhe do ta gjesh përmbushjen e merakeve tua”: ky është premtimi i Krijuesit.

¹¹ Nderoji dhe gëzohju devave gjersa të nderojnë dhe të gëzohen; përmes këtij nderi dhe dashurie do ta arrish të mirën supreme. ¹² Të gjitha meraket njerëzore përmbushen nga devat, të cilat kënaqen nga shërbimi pa-veten. Por kushdo që i shijon gjërat e dhëna nga devat pa ofruar veprime pa-veten në këmbim – është hajn.

¹³ Ata me mendje shpirtërore, që hanë në frymën e shërbimit, janë të çliruar nga të gjitha mëkatet e veta; por vetjakët, që përgatisin ushqim për kënaqësinë e vet, hanë mëkat. ¹⁴ Krijesat e gjalla mbahen gjallë me ushqim dhe ushqimi mbahet gjallë me shi; vetë shiu është uji i jetës, që vjen nga adhurimi dhe shërbimi pa-veten.

¹⁵ Çdo akt pa-veten, Arxhuna, lindet nga Brahmani, Esenca e përhershme, e pafundme e Zotit.^a Brahmani është prezent në çdo akt të shërbimit. ¹⁶ Tërë jeta sillet rreth këtij ligji, o Arxhuna. Ata që e shkelin, duke i llastuar shqisat për kënaqësinë e tyre dhe duke i injoruar nevojat e të tjerëve, e kanë çuar jetën e tyre kot. ¹⁷ Por ata që e kuptojnë intuitivisht Vetën janë gjithmonë të kënaqur. Meqë e kanë gjetur burimin e gëzimit dhe të përmbushjes, më nuk kërkojnë lumturi nga bota e jashtme. ¹⁸ Nuk kanë asgjë për të fituar apo për të humbur me asnjë veprim; as njerëzit as gjërat nuk mund të ndikojnë në sigurinë e tyre.

¹⁹ Përpiqu vazhdimisht t’i shërbesh mirëqenies së botës; njeriu, me përkushtim ndaj punës pa-veten e arrin qëllimin suprem të jetës. ²⁰ Bëje punën tënde duke e pasur gjithmonë në mendje mirëqenien e të tjerëve. Ishte pikërisht puna e tillë përmes së cilës Xhanaka e arriti përsosmërinë; edhe të tjerët e kanë ndjekur këtë rrugë.

^a Fjala “God” është përkthyer “Zot” për dallim nga fjala “Lord” që është përkthyer “Zotërues” (shënim i shqipëruarit).

²¹ Atë që e bën njeriu i shquar, të tjerët do të përpiqen ta bëjnë. Standardet që i krijojnë njerëzit e tillë do të ndiqen nga tërë bota. ²² Nuk ka asgjë në të tri botët për përfitimin tim, Arxhuna, as s'ka asgjë që nuk e kam; vazhdoj të veproj, por nuk jam i shtyrë nga asnjë nevojë e imja. ²³ Po të përmbahesha ndonjëherë nga puna e vazhdueshme, secili do ta ndiqte menjëherë shembullin tim. ²⁴ Po të ndalesha së punuari, do të isha shkaku i kaosit kozmik dhe në fund i shkatërrimit të kësaj bote dhe të këtyre njerëzve.

²⁵ Injorantët punojnë për përfitimin e vet, Arxhuna; të urtët punojnë për mirëqenien e botës, pa mendim për veten. ²⁶ Duke hequr dorë nga puna do t'i hutosh injorantët, që janë të zhytur në veprimet e tyre. Kryeji të gjitha punët me kujdes, i udhëhequr nga dhembshuria.

²⁷ Të gjitha veprimet kryhen nga gunat e prakritit. I deluzionuar nga identifikimi me egon, një person mendon: “Unë jam bërësi.” ²⁸ Por burri apo gruaja e përndritur e kupton domenin e gunave dhe nuk është i-e lidhur. Njerëzit e tillë e dinë se gunat ndërveprojnë me njëra-tjetrën; ato nuk pretendojnë të jenë bërësi.

²⁹ Ata që janë të deluzionuar nga funksionimi i gunave bëhen të lidhur me rezultatet e veprimit të tyre. Ata që i kuptojnë këto të vërteta nuk duhet ta shqetësojnë injorantin. ³⁰ Duke i kryer të gjitha veprimet për hir timin, i zhytur plotësisht në Vetën, dhe pa pritshmëri, lufto! – por rri i lirë nga ethet e egos.

³¹ Ata që jetojnë në përputhje me këto ligje hyjnore pa u ankuar, të mirëvendosur fort në besim, çlirohen nga karma. ³² Ata që i shkelin këto ligje, duke kritikuar e duke u ankuar, janë krejtësisht të deluzionuar, dhe janë shkaku i vuajtjes së tyre.

³³ Edhe të urtët veprojnë brenda kufijve të natyrës së tyre. Çdo krijesë ndikohet nga prakriti; çfarë dobie ka represioni? ³⁴ Shqisat janë të ndikuara nga tërheqja ndaj të këndshmes dhe nga neveria ndaj të pakëndshmes. Mos u sundo prej tyre; ato janë pengesa në rrugën tënde.

³⁵ Është më mirë të orvatesh në d'harmën tënde se sa të kesh sukses në d'harmën e tjetrit. Asgjë nuk humbet kurrë gjatë ndjekjes së d'harmës tënde, por gara në d'harmën e dikujt tjetër ngjall frikë dhe pasiguri.

A R X H U N A

³⁶ Cila është forca që na lidh me veprat vetjake, O Krishna? Çfarë fuqie na lëviz, goftë edhe kundër vullnetit tonë, sikur na detyron disi?

K R I S H N A

³⁷ Është merakuri dhe zemërimi vetjak, që del nga guna e raxhave; këto janë orekset dhe të këqijat që e kërcënojnë njeriun në këtë jetë.

³⁸ Siç mbulohet zjarri nga tymi dhe një pasqyrë turbullohet nga pluhuri, siç pushon embrioni thellë brenda mitrës, njohjen e fsheh merakuri vetjak – ³⁹ e fsheh, Arxhuna, ky zjarr i pangopshëm për vetë-kënaqësi, armiku i pandreqshëm i të urtëve.

⁴⁰ Merakuri vetjak gjendet në shqisa, në mendje dhe në intelekt, duke i keqduhëzuar dhe duke e varrosur të kuptuarit në deluzion. ⁴¹ Lufto me tërë forcën tënde, Arxhuna! Duke i kontrolluar shqisat e tua, mposhte armikun, shkatërruesin e njohjes dhe të kuptimit intuitiv.

⁴² Shqisat janë më të larta se trupi, mendja më e lartë se shqisat; mbi mendjen është intelektin, dhe mbi intelektin është Atmani. ⁴³ Kështu, duke e ditur atë që është supreme, lëre Atmanin ta sundojë egon. Përdori krahët e tu të fuqishëm për ta vrarë armikun i cili është merakuri vetjak.

Kapitulli katër: Urtia në veprim

K R I S H N A

¹ Ia tregova këtë fshehtësi të përhershme Vivasvatit. Vivasvati e mësoi Manunë, e Manuja e mësoi Ikshvakun. ² Kështu, Arxhuna, urtakët e shquar e morën njohjen e jogës në traditë të vazhdueshme. Por përgjatë kohës prakika e jogës u humb në botë.

³ Fshehtësia e këtyre mësimëve është e thellë. T'i kam shpjeguar sot sepse je miku dhe ndjekësi im shpirtëror.

A R X H U N A

⁴ Ti je lindur shumë kohë pas Vivasvatit; ai jetoi shumë kohë më parë. Pse po thua se ia ke mësuar këtë jogë në fillim?

K R I S H N A

⁵ Ti dhe unë kemi kaluar nëpër shumë lindje, Arxhuna. Ti ke harruar, por unë i kujtoj të gjitha. ⁶ Qenia ime e vërtetë është e palindur dhe e pandryshueshme. Unë jam Zotëruesi që rri në secilën krijesë. Përmes fuqisë së maia-s sime, e manifestoj veten në formë të fundme.

⁷ Kurdo që përkeqësohet d'hurma dhe harrohet qëllimi i jetës, e manifestoj veten në tokë. ⁸ Jam lindur në çdo epokë për ta mbrojtur të mirën, për ta shkatërruar të keqen, dhe për ta rivendosur d'harmën.

⁹ Ata që më njohin si Vetja e tyre hyjnore i këpusin zinxhirët e besimit se janë trupi dhe se nuk rilinden si krijesa të veçanta. Një i tillë, Arxhuna, është i bashkuar me mua. ¹⁰ Të çliruar nga lidhja vetjake, frika dhe zemërimi, të mbushur me mua, duke m'i dorëzuar vetet e tyre, të pastruar në zjarrin e qenies sime, shumë njerëz e kanë arritur gjendjen e bashkimit në mua.

¹¹ Siç më afrohen, ashtu i pranoj. Të gjitha shtigjet, Arxhuna, çojnë tek unë.

¹² Ata që e kanë merak suksesin në veprimet e tyre i adhurojnë zotat; përmes veprimit në botën e vdekatarëve, merakët e tyre përmbushen shpejt. ¹³ Dallimet e klasës shoqërore, gunës dhe karmës kanë ardhur nga unë. Jam shkaku i tyre, por vetë jam i pandryshueshëm dhe përtej tërë veprimit. ¹⁴ Veprimet nuk më ngjiten sepse nuk jam i lidhur me rezultatet e tyre. Ata që e kuptojnë këtë dhe e praktikojnë – jetojnë në liri. ¹⁵ Duke e ditur këtë të vërtetë, aspirantët që e kishin merak çlirimin në kohët e lashta angazhoheshin në veprim. Edhe ti mund ta bësh të njëjtën gjë, duke ndjekur jetë aktive në mënyrën e atyre urtakëve të lashtë.

¹⁶ Ç'është veprimi dhe ç'është joveprimi? Kjo pyetje i ka hutuar urtakët më të mëdhenj. Do të ta jap fshehtësinë e veprimit, me të cilën mund të çlirohesh nga robëria. ¹⁷ Natyra e vërtetë e veprimit është e vështirë të kuptohet intuitivisht. Duhet ta kuptosh se çka është veprimi dhe çka është joveprimi, dhe çfarë lloji i veprimit duhet të shmanget.

¹⁸ Urtakët e shohin se ka veprim nëpër joveprim dhe joveprim nëpër veprim. Vetëdijesia e tyre është e unifikuar, dhe çdo veprim bëhet me vetëdije të plotë.

¹⁹ Urtakët e zgjuar e quajnë një person të urtë kur të gjitha ndërmarrjet e tij janë të lira nga ankthi për rezultatet; të gjitha merakët e tij vetjake janë konsumuar në zjarrin e njohjes. ²⁰ Të urtët, gjithmonë të kënaqur, i kanë braktisur të gjitha mbështetjet e jashtme. Siguria e tyre është e pandikuar nga rezultatet e veprimit

të tyre; madje edhe gjersa veprojnë, vërtet nuk bëjnë asgjë fare.²¹ Të lirë nga pritshmëritë dhe nga tërë ndjesia e zotërimit, me mendjen dhe trupin të kontrolluar vendosmërisht nga Vetja, nuk bëjnë mëkat përmes kryerjes së veprimit fizik.

²² Jetojnë në liri ata që kanë shkuar përtej dualiteteve të jetës. Duke mos garuar me askë, janë njësoj në sukses dhe në dështim dhe të kënaqur me çkado që u vjen.

²³ Janë të lirë, pa lidhshmëri vetjake; mendjet e tyre janë të fiksuara në njohje. E kryejnë tërë punën në frymë të shërbimit, dhe karma e tyre tretet.

²⁴ Procesi i ofrimit është Brahmani; ajo që ofrohet është Brahmani. Brahmani e ofron flijimin në zjarrin e Brahmanit. Brahmani arrihet nga ata që e shohin Brahmanin në secilin veprim.

²⁵ Disa aspirantë u ofrojnë flijime materiale zotave. Të tjerë ofrojnë shërbim paveten si flijim në zjarrin e Brahmanit.²⁶ Disa heqin dorë nga tërë kënaqësitë e shqisave, duke i flijuar ato në zjarrin e vetë-përmbajtjes shqisore. Të tjerë përfshihen në objektet shqisore por i ofrojnë ato në shërbim përmes zjarrit të shqisave.²⁷ Disa i ofrojnë funksionet e shqisave dhe forcat vitale përmes zjarrit të vetë-kontrollit, të ndezur në rrugën e njohjes.

²⁸ Disa ofrojnë pasuri; të tjerë ofrojnë vetëpërmbajtje të shqisave dhe vuajtje. Disa bëjnë zotime dhe e ofrojnë njohjen dhe studimin e shkrimeve të shenjta; dhe disa e bëjnë ofertën flijuese të meditimit.²⁹ Disa i ofrojnë forcat e vitalitetit, duke e rregulluar frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen, dhe kështu fitojnë kontroll mbi këto forca.³⁰ Të tjerë i ofrojnë forcat e vitalitetit përmes vetëpërmbajtjes së shqisave të veta. Të gjithë këta e kuptojnë domethënien e shërbimit dhe do të pastrohen nga papastërtitë e tyre.

³¹ Mbajtja e vërtetë e jetës është në shërbim, dhe përmes tij një burrë apo një grua e arrin Brahmanin e përhershëm. Por ata që nuk kërkojnë të shërbejnë janë pa shtëpi në këtë botë. Arxhuna, si mund të jenë në shtëpi në çfarëdo bote që do të vijë?

³² Këto oferta flijuese dalin nga puna dhe secila e udhëzon njerëzimin nëpër një shteg kah Brahmani. Duke e kuptuar këtë, do ta arrish çlirim. ³³ Oferta flijuese e urtisë është më e mirë se çfarëdo oferte flijuese materiale, Arxhuna; se qëllimi i tërë punës është urtia shpirtërore.

³⁴ Afroju atyre që e kanë kuptuar intuitivisht destinimin e jetës dhe pyeti me nderim e përkushtim; ata do të të udhëzojnë në këtë urti. ³⁵ Posa ta kesh arritur atë, më nuk do të deluzionohesh kurrë. Do t'i shohësh të gjitha krijesat në Vetën, dhe të gjitha në mua.

³⁶ Edhe po të ishe më mëkatari i mëkatarëve, Arxhuna, do të mund të kapërcesh përtej tërë mëkateve me trapin e urtisë shpirtërore. ³⁷ Siç e kthen nxehtësia e zjarrit drurin në hi, zjarri i njohjes e bën tërë karmën hi. ³⁸ Asgjë në këtë botë nuk pastron si urtia shpirtërore. Ajo është përsosmëria e arritur në kohë përmes rrugës së jogës, rruga që çon te Vetja përbrenda.

³⁹ Ata që e marrin urtinë si qëllimin e tyre më të lartë, besimi i të cilëve është i thellë dhe shqisat e të cilëve janë të stërvitura, e arrijnë urtinë shpejt dhe hyjnë në paqe të përsosur. ⁴⁰ Por injorantët, të pavendosur dhe pa besim, e çojnë dëm jetën e tyre. Ata s'mund të jenë kurrë të lumtur në këtë botë apo në ndonjë tjetër.

⁴¹ Ata që janë të mirëvendosur në Vetën kanë hequr dorë nga lidhshmëritë vetjake me veprimet e tyre dhe kanë çarë nëpër dyshime me urti shpirtërore. Ata veprojnë në liri. ⁴² Arxhuna, çaj nëpër këtë dyshim në zemrën tënde me shpatën e urtisë shpirtërore. Ngritu; nisu rrugës së jogës!

Kapitulli pesë: Heqja dorë dhe shijimi

A R X H U N A

¹ O Krishna, e ke rekomanduar edhe rrugën e veprimit pa-veten edhe *sannjasa-n*, rrugën e heqjes dorë nga veprimi. Më trego përfundimisht se cila është më e mirë.

K R I S H N A

² Edhe heqja dorë nga veprimi edhe kryerja e veprimit në mënyrë pa-veten çojnë te qëllimi suprem. Por rruga e veprimit është më e mirë se heqja dorë.

³ Ata që e kanë arritur heqjen dorë të përsosur janë të lirë nga çdo ndjesi e dualitetit; janë të pandikuar nga pëlqimet dhe mospëlqimet, Arxhuna, dhe janë të lirë nga robëria e vetë-vullnetit. ⁴ Të papjekurit mendojnë se njohja dhe veprimi janë të ndryshme, por të urtët i shohin si të njëjta. Personi që është i mirëvendosur në një rrugë do t'i arrijë shpërblimet e të dyjave. ⁵ Qëllimi i njohjes dhe qëllimi i shërbimit janë të njëjtë; ata që nuk arrijnë ta shohin këtë janë të verbër. ⁶ Heqja dorë e përsosur është e vështirë të arrihet pa kryer veprim. Por të urtët, duke e ndjekur rrugën e shërbimit pa-veten, e arrijnë Brahmanin shpejt.

⁷ Ata që e ndjekin rrugën e shërbimit, që i kanë pastruar plotësisht vetet dhe i kanë mposhtur shqisat dhe vetë-vullnetin e vet, e shohin Vetën në të gjitha krijesat dhe janë të paprekur nga cilido veprim që kryejnë.

⁸ Ata që e dinë këtë të vërtetë, vetëdijësia e të cilëve është e unifikuar, gjithmonë mendojnë: “Unë nuk jam bërësi.” Gjatë të pamurit apo dëgjimit, prekjes apo nuhatjes; ngrënies, lëvizjes përreth, apo fjetjes; frymëmarrjes ⁹ apo të folurit, shkëputjes apo kapjes për diçka, madje edhe gjatë hapjes apo mbylljes së syve, e kuptojnë se këto janë veç lëvizje të shqisave midis objekteve shqisore.

¹⁰ Ata që ia dorëzojnë Brahmanit të gjitha lidhshmëritë vetjake janë si fleta e një lotusi që pluskon e pastër dhe e thatë në ujë. Mëkati nuk mund t'i prekë. ¹¹ Duke hequr dorë nga lidhshmëritë e tyre vetjake, ata që e ndjekin rrugën e shërbimit punojnë me trup, me shqisa dhe me mendje për hir të vetë-pastrimit.

¹² Ata vetëdijesia e të cilëve është e unifikuar e braktisin tërë lidhshmërinë me rezultatet e veprimit dhe e arrijnë paqen supreme. Por ata merakët e të cilëve janë të copëtuara, që janë të lidhur në mënyrë vetjake me rezultatet e punës së tyre, janë të kufizuar në gjithçka që e bëjnë.

¹³ Ata që heqin dorë nga lidhshmëria në të gjitha veprat e tyre jetojnë të kënaqur në “qytetin e nëntë portave”, trupin, si padronin e tij. Ata nuk janë të shtyrë të veprojnë, as nuk i përfshijnë të tjerët në veprim.

¹⁴ As ndjesia e veprimit, as veprimet, as lidhja e shkakut dhe efektit nuk vjen nga Zotëruesi i kësaj bote. Këto trija dalin nga natyra.

¹⁵ Zotëruesi nuk merr pjesë në veprat e mira dhe të këqija të asnjë personi; gjykimi errësohet kur urtia mjegullohet nga injoranca. ¹⁶ Por injoranca shkatërrohet nga njohja e Vetes përbrenda. Drita e kësaj njohjeje shkëlqen si dielli, duke e zbuluar Brahmanin suprem. ¹⁷ Ata që e flakin mëkatin përmes kësaj njohjeje, të zhytur në Zotëruesin dhe të mirëvendosur në të si qëllimi dhe streha e tyre e vetme, nuk rilindin si krijesa të veçanta.

¹⁸ Ata që e posedojnë këtë urti i respektojnë bars të gjithë. E shohin Vetën e njëjtë në një aspirant shpirtëror dhe në një të dëbuar nga kasta, në elefant, lopë e qen. ¹⁹ Njerëzit e tillë e kanë zotëruar jetën. Me mendje të qetë pushojnë në Brahmanin, që është i përsosur dhe është kudo i njëjtë. ²⁰ Nuk disponohen nga fati i mirë as s'dëshpërohen nga i keqi. Me mendjen të mirëvendosur në Brahmanin, janë të lirë nga deluzioni. ²¹ Të pavarur nga ndonjë mbështetje e jashtme, e kuptojnë intuitivisht gëzimin e vetëdijes shpirtërore. Me vetëdijesinë e unifikuar përmes meditimit, jetojnë në gëzim të qëndrueshëm.

²² Kënaqësitë e ngjizura në botën e shqisave kanë fillim dhe fund dhe e linden mjerimin, Arxhuna. Të urtët nuk kërkojnë lumturi në to. ²³ Por ata që i mposhtin shtysat e epshit dhe të zemërimit që shfaqen në trup bëhen të plotë dhe jetojnë në gëzim. ²⁴ Ata e gjejnë gëzimin e tyre, pushimin e tyre dhe dritën e tyre plotësisht brenda vetes. Të bashkuar me Zotëruesin, e arrijnë nirvanën në Brahmanin.

²⁵ Të shëruar nga mëkatet dhe konfliktet e tyre, duke punuar për të mirën e të gjitha qenieve, urtakët e shenjtë e arrijnë nirvanën në Brahmanin. ²⁶ Të lirë nga zemërimi dhe merakut vetjak, të bashkuar në mendje, ata që e ndjekin rrugën e jogës dhe e kuptojnë intuitivisht Vetën janë të mirëvendosur përgjithmonë në atë gjendje supreme.

²⁷ Duke i mbyllur sytë, duke e stabilizuar frymëmarrjen dhe duke e përqendruar vëmendjen e tyre në qendrën e vetëdijesisë shpirtërore, ²⁸ urtakët i zotërojnë shqisat, mendjen dhe intelektin e tyre përmes meditimit. Kuptimi Intuitiv i Vetes është qëllimi i tyre i vetëm. Të çliruar nga merakut vetjak, frika dhe zemërimi, jetojnë në liri gjithmonë. ²⁹ Duke më njohur mua si mikun e të gjitha krijesave, Zotëruesin e gjithësisë, destinimin e të gjitha flijimeve dhe të tërë disiplinave shpirtërore, ata e arrijnë paqen e përhershme.

Kapitulli gjashtë: Praktika e meditimit

K R I S H N A

¹ Jo ata që u mungon energjia apo përmbahen nga veprimi, por ata që punojnë pa pritshmëri apo shpërblim janë ata që e arrijnë qëllimin e meditimit. E tyrja është heqja dorë e vërtetë. ² Prandaj, Arxhuna duhet ta kuptosh se heqja dorë dhe kryerja e shërbimit pa-veten janë të njëjta. Ata që nuk mund të heqin dorë nga lidhshmëria me rezultatet e punës së tyre janë larg nga rruga.

³ Për aspirantët që duan të ngjiten në malin e vetëdijes shpirtërore, rruga është puna pa-veten; për ata që janë ngritur në joga rruga është prehja dhe paqja. ⁴ Kur ta kesh çliruar veten nga lidhshmëria me rezultatet e punës, dhe nga meraket për shijimin e objekteve shqisore, do të ngritesh në gjendjen unitive.

⁵ Riformoje veten përmes fuqisë së vullnetit tënd; kurrë mos e lër veten të degradohesh nga vetë-vullneti. Vullneti është miku i vetëm i Vetes, dhe vullneti është armiku i vetëm i Vetes.

⁶ Për ata që e kanë mposhtur veten, vullneti është mik. Por është armik i atyre që nuk e kanë gjetur Vetën brenda tyre.

⁷ Realiteti suprem qëndron i zbuluar në vetëdijesinë e atyre që e kanë mposhtur veten. Ata jetojnë në paqe, në të ftohtë e në të nxehtë, në kënaqësi e dhembje, në lavdërim e fajësim.

⁸ Ata janë të përmbushur plotësisht nga urtia shpirtërore dhe Kuptimi Intuitiv i Vetes. Meqë i kanë mposhtur shqisat e veta, ata janë ngritur në majën e vetëdijesisë njerëzore. Për njerëz të tillë, një plis dhé, një gur dhe ari janë njësoj.

⁹ Ata janë njësoj të prirë ndaj familjes, armiqve dhe miqve, atyre që i përkrahin dhe atyre që janë armiqtë, si ndaj të mirëve edhe ndaj të këqijve. Meqë janë të paanshëm, ngriten në lartësi të mëdha.

¹⁰ Ata që e aspirojnë gjendjen e jogës duhet ta kërkojnë Vetën në vetmi të këndshme të brendshme përmes meditimit. Me trupin dhe mendjen e kontrolluar duhet ta praktikojnë vazhdimisht një-pikësinë, të lirë nga pritshmëritë dhe lidhshmëritë me pasuritë materiale.

¹¹ Zgjedhe një vend të pastër, as tepër lart as tepër poshtë, dhe ulu në një pëlhurë, lëkurë dreri dhe bar kusha. ¹² Pastaj, pasi të jesh ulur, përpiku t'i qetësosh mendimet e tua. Bëje mendjen tënde të një-pikësuar në meditim, dhe zemra jote do të pastrohet. ¹³ Mbaje trupin, kokën dhe qafën vendosmërisht në vijë të drejtë, dhe mbaji sytë të mos enden. ¹⁴ Me të gjitha frikat të tretura në paqen e Vetes dhe të gjitha veprimet të përkushtuara Brahmanit, duke e kontrolluar mendjen dhe duke e fiksuar atë në mua, ulu në meditim me mua si qëllimin tënd të vetëm. ¹⁵ Me shqisat dhe mendjen vazhdimisht të kontrolluar përmes meditimit, i bashkuar me Vetën përbrenda, një aspirant e arrin nirvanën, gjendjen e gëzimit dhe paqes së qëndrueshme në mua.

¹⁶ Arxhuna, ata që hanë tepër shumë apo hanë tepër pak, që flenë tepër shumë apo që flenë tepër pak, nuk do të kenë sukses në meditim. ¹⁷ Por ata që janë të përmbajtur në ngrënie e fjetje, në punë e argëtim, do ta arrijnë fundin e pikëllimit përmes meditimit. ¹⁸ Përmes përpjekjes së vazhdueshme mësojnë ta tërheqin mendjen nga dëshirimet vetjake dhe ta shkrijnë atë në Vetën. Kështu e arrijnë gjendjen e bashkimit.

¹⁹ Kur zotërohet meditimi, mendja është e palëkundur si flaka e një lllampe në një vend pa erëra. ²⁰ Në mendjen e prehur, në thellësitë e meditimit, zbulohet Vetja. Duke e shikuar Vetën me anë të Vetes, një aspirant e njeh gëzimin dhe paqen e përmbushjes së plotë. ²¹ Pas arritjes së atij gëzimi të qëndrueshëm përtej shqisave, të zbuluar në mendjen e prehur, ata nuk shmangen kurrë nga e vërteta e përhershme. ²² Nuk kanë merak asgjë tjetër dhe nuk mund të tronditen as nga barra më e rëndë e pikëllimit.

²³ Praktika e meditimit e çliron njeriun nga çdo mundim. Kjo është rruga e jogës. Ndiqe atë me vendosmëri dhe entuziazëm të qëndrueshëm. ²⁴ Duke hequr dorë me gjithë zemër nga të gjitha meraket dhe pritshmëritë vetjake, përdore vullnetin tënd për t'i kontrolluar shqisat. ²⁵ Pak nga pak, me durim dhe përpjekje të përsëritura, mendja do të bëhet e prehur në Vetën.

²⁶ Kudo që të endet mendja, e shqetësuar dhe e shpërndarë në kërkimin e vet të kënaqësisë përjashta, drejtoje përbrenda; stërvite të pushojë në Vetën. ²⁷ Gëzimi i qëndrueshëm u vjen atyre që e prehin mendjen. Duke e çliruar veten nga njollat e vetë-vullnetit, me vetëdijesinë e tyre të unifikuar, ata bëhen një me Brahmanin.

²⁸ Gëzimi i pafund i prekjes së Brahmanit arrihet lehtë nga ata që janë të lirë nga barra e së keqes dhe të mirëvendosur brenda vetes. ²⁹ Ata e shohin Vetën në secilën krijesë dhe tërë krijimin në Vetën. Me vetëdijesinë e unifikuar përmes meditimit, shohin gjithçka me një sy të barabartë.

³⁰ Unë jam gjithmonë prezent ndaj atyre që më kanë kuptuar intuitivisht në secilën krijesë. Duke e parë tërë jetën si manifestim timin, nuk janë kurrë të ndarë nga unë. ³¹ Më adhurojnë në zemrat e gjithçkaje, dhe të gjitha veprimet e tyre rrjedhin nga unë. Kudo që jetojnë, rrinë në mua.

³² Kur një person u përgjigjet gëzimeve dhe pikëllimeve të të tjerëve sikur të ishin të tijat, ai e ka arritur gjendjen më të lartë të bashkimit shpirtëror.

A R X H U N A

³³ O Krishna, prehja e bashkimit hyjnor që po e përshkruan është përtej të kuptuarit tim. Si mundet mendja, që është kaq e shqetësuar, të arrijë paqe të qëndrueshme? ³⁴ Krishna, mendja është e shqetësuar, e trazuar, e fuqishme, e dhunshme; të përpiqesh ta kontrollosh është si të përpiqesh ta zbutësh^a erën.

^a Ta zbutësh si kafshën e egër (shënim i shqipëruarit).

K R I S H N A

³⁵ Është e vërtetë që mendja është e shqetësuar dhe e vështirë për t'u kontrolluar. Por ajo mund të mposhtet, Arxhuna, përmes praktikës së rregullt dhe shkëputjes. ³⁶ Ata që nuk kanë vetë-kontroll do ta kenë të vështirë të përparojnë në meditim; por ata që janë të vetë-kontrolluar, duke u përpjekur me zell me mjetet e duhura, do ta arrijnë qëllimin.

A R X H U N A

³⁷ Krishna, çka ndodh me atë që ka besim, por që nuk ka vetë-kontroll dhe bredh e del nga rruga, duke mos arritur sukses në joga? ³⁸ Nëse ai bëhet i deluzionuar në rrugën shpirtërore, a do ta humbë përkrahjen e të dy botëve, si një re e shpërndarë nëpër qiell? ³⁹ Krishna, ti mund t'i largosh të gjitha dyshimet; ma hiq këtë dyshim që më shtrëngon.

K R I S H N A

⁴⁰ Arxhuna, biri im, një person i tillë nuk do të shkatërrohet. Askush që bën punë të mirë nuk do të ketë kurrë fund të keq, as këtu as në botën që do të vijë.

⁴¹ Kur njerëzit e tillë vdesin, shkojnë në vende të tjera ku jetojnë të drejtët. Ata rrinë aty për vite të panumërta dhe pastaj rilinden ⁴² në një shtëpi që është e pastër dhe e suksesshme. Apo mund të lindin në një familje ku praktikohet meditimi; të lindesh në një familje të tillë është jashtëzakonisht e rrallë. ⁴³ Urtia që e kanë fituar në jetët e mëparshme do të rizgjohet, Arxhuna, dhe do të përpiqen edhe më shumë për Kuptimin Intuitiv të Vetes. ⁴⁴ Në të vërtetë, do të nxiten nga forca e disiplinave të tyre të shkuara. Madje edhe ai që interesohet për praktikën e meditimit ngritet mbi ata që thjesht kryejnë rituale.

⁴⁵ Përmes përpjekjes së vazhdueshme përgjatë shumë jetëve, një person bëhet i pastruar nga të gjitha meraket vetjake dhe e arrin qëllimin suprem të jetës.

⁴⁶ Meditimi është superior ndaj asketizimit të ashpër dhe rrugës së njohjes. Është po ashtu superior ndaj shërbimit pa-veten. E arritsh qëllimin e meditimit, Arxhuna! ⁴⁷ Edhe midis atyre që meditojnë, ai burrë apo grua që më adhuron me besim të përsosur, i zhytur plotësisht në mua, është më i mirëvendosuri në joga.

Kapitulli shtatë: Urtia nga kuptimi intuitiv

K R I S H N A

¹ Me mendjen tënde të synuar tek unë, Arxhuna, dispiplinoje veten me praktikën e jogës. Mbështetu plotësisht tek unë. Dëgjo, dhe do t'i largoj krejt dyshimet; gradualisht do të më njohësh plotësisht dhe do jesh i bashkuar me mua.

² Do ta jap edhe xhnana-n edhe vixhnana-n. Kur kuptohen intuitivisht këto të dyja, nuk ka asgjë tjetër që duhet të dish.

³ Një person – ndër shumë mijëra – mund ta kërkojë përsosmërinë, e megjithatë nga këta vetëm disa e arrijnë qëllimin dhe arrijnë të më kuptojnë intuitivisht.

⁴ Toka, uji, zjarri, ajri, *akasha*, mendja, intelekti dhe ego – këto janë tetë ndarjet e praktikës tim. ⁵ Por përtej kësaj e kam një natyrë tjetër, më të lartë, Arxhuna: ajo e mban tërë gjithësinë dhe është burimi i jetës në të gjitha qeniet.

⁶ Në këto dy aspekte të natyrës sime është mitra e tërë krijimit. Lindja dhe shpërbërja e vetë kozmosit ndodhin në mua. ⁷ Nuk ka asgjë që ekziston e ndarë nga unë, Arxhuna. E tërë gjithësia është e varur në mua si gjerdan i xhevahirëve.

⁸ Arxhuna, unë jam shija e ujit të pastër dhe rrezatimi i diellit e i hënës. Jam fjala e shenjtë dhe tingulli i dëgjuar në ajër, dhe guximi i qenieve njerëzore. ⁹ Jam aroma e këndshme në tokë dhe rrezatimi i zjarrit; jam jeta në çdo krijesë dhe përpjekja e aspirantit shpirtëror.

¹⁰ Fara ime e përhershme, Arxhuna, gjendet në çdo krijesë. Jam fuqia e aftësisë dalluese në ata që janë inteligjentë, dhe lavdia e fisnikëve. ¹¹ Në ata që janë të fortë, jam forca, i lirë nga pasioni dhe lidhshmëria vetjake. Jam vetë merak, nëse ai merak është në harmoni me destinimin e jetës.

¹² Gjendjet e sattva-s, raxhas dhe tamas vijnë nga unë, por nuk jam në to. ¹³ Këto tri guna e mashtrojnë botën: njerëzit nuk arrijnë të shohin përtej tyre tek unë, supremi dhe i pashueshmi. ¹⁴ Tri gunat e përbëjnë *maia*-n time hyjnore, të vështirë për t'u kapërcyer. Por e kalojnë këtë *maia* ata që strehohen në mua. ¹⁵ Të tjerët janë të deluzionuar nga *maia*; duke bërë vepra të këqija, nuk kanë përkushtim ndaj meje. Duke e humbur tërë aftësinë dalluese, e ndjekin rrugën e natyrës së tyre më të ulët.

¹⁶ Njerëzit e mirë vijnë të më adhurojnë për arsye të ndryshme. Disa vijnë në jetën shpirtërore për shkak të vuajtjes, disa për ta kuptuar jetën; disa vijnë përmes një merakut për ta arritur destinimin e jetës, dhe disa vijnë që janë burra e gra të urtisë. ¹⁷ I palëkundur në përkushtim, gjithmonë i bashkuar me mua, burri apo gruaja e urtisë i tejkalon të gjithë të tjerët. Për ta jam i dashuri më i shtrenjtë dhe ata janë shumë të dashur për mua. ¹⁸ Të gjithë ata që e ndjekin rrugën shpirtërore janë të bekuar. Por të urtët që janë gjithmonë të mirëvendosur në bashkim, prej nga nuk ka qëllim më të lartë se unë, mund të konsiderohen pikërisht si Vetja ime.

¹⁹ Pas shumë lindjeve të urtët kërkojnë strehim tek unë, duke më parë kudo dhe në gjithçka. Shpirtat e tillë të mëdhenj janë shumë të rrallë. ²⁰ Ka të tjerë aftësia dalluese e të cilëve është e çorientuar nga shumë merake. Duke e ndjekur natyrën e vet, ata adhurojnë zota më të ulët, duke praktikuar rite të ndryshme.

²¹ Kur një person i përkushtohet diçkaje me besim të plotë, unë e bashkoj besimin e tij në atë diçka. ²² Pastaj, kur besimi unifikohet plotësisht, njeriu e fiton objektin e përkushtimit. Në këtë mënyrë, çdo merak përmbushet nga unë. ²³ Ata kuptimi i të cilëve është i vogël arrijnë veç kënaqësi kalimtare: ata që i adhurojnë zotat shkojnë te zotat. Por të përkushtuarit e mi vijnë tek unë.

²⁴ Nga mungesa e të kuptuarit, njerëzit besojnë se unë, I Pamanifestuari,^a kam hyrë në ndonjë formë. Ata nuk arrijnë ta kuptojnë natyrën time të vërtetë, që e tejkalon lindjen dhe vdekjen. ²⁵ Pak [njerëz] shohin përtej vellos së *maia*-s. Bota, e deluzionuar, nuk e di se jam pa lindje dhe i pandryshim. ²⁶ Unë di gjithçka për

^a Apo E Pamanifestuara (shënim i shqipëruarit)

të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, Arxhuna; por nuk ka njeri që më njih plotësisht.

²⁷ Deluzioni shfaqet nga dualiteti i tërheqjes dhe i neverisë, Arxhuna; çdo krijesë është e deluzionuar nga këto që nga lindja. ²⁸ Por ata që e kanë çliruar veten nga tërë keqbërjet janë të mirëvendosur fort në të adhuruarit mua. Veprimet i kanë të pastra dhe janë të lirë nga deluzioni i shkaktuar nga çiftet e të kundërtave.

²⁹ Ata që strehohen tek unë, duke u përpjekur për çlirim nga pleqëria dhe vdekja, gradualisht e njohin Brahmanin, Vetën dhe natyrën e tërë veprimit. ³⁰ Ata që më shohin duke e sunduar kozmosin, që më shohin në *ad'hibhuta*, *ad'hidaiwa* dhe *ad'hixhaxhna*, janë të vetëdijsëm për mua madje edhe në kohën e vdekjes.

Kapitulli tetë: Esenca e përhershme e Zotit

ARXHUNA

¹ O Krishna, çka është Brahmani dhe çfarë është natyra e veprimit? Çka është *ad'hiatma*, *ad'hibhuta*, *ad'hidaiva*? ² Çka është *ad'hijaxhna*, flijimi suprem, dhe si duhet të ofrohet? Si janë njerëzit e vetë-kontrolluar të bashkuar me ty në kohën e vdekjes?

KRISHNA

³ Natyra ime më e larta, Brahmani i pashueshëm, ia jep secilës krijesë ekzistencën e vet dhe jeton në secilën krijesë si *ad'hiatma*. Veprimi im është krijimi dhe prodhimi i krijesave. ⁴ *Ad'hibhuta* është trupi i shueshëm; *ad'hidaiva* është Purusha, shpirti i përhershëm. *Ad'hijaxhna*, flijimi suprem, më bëhet mua si Zotëruesin brenda teje.

⁵ Ata që më kujtojnë në kohën e vdekjes do të vijnë tek unë. Mos e dysho këtë. ⁶ Çkado me të cilën preokupohet mendja në kohën e vdekjes e përcakton destinacionin e të vdekurve; gjithmonë do të priren kah ajo gjendje e qenies. ⁷ Prandaj, kujtomë në çdo kohë dhe vazhdo të luftosh. Me zemrën dhe mendjen tënde të synuar në mua, sigurisht që do të vish tek unë. ⁸ Kur e bën mendjen tënde të njëpikësuar përmes praktikës së rregullt të meditimit, do ta gjesh lavdinë supreme të Zotëruesit.

⁹ Zotëruesi është poeti suprem, shkaku i parë, sunduesi sovran, më subtil se grimca më e imët, mbështetja e të gjithëve, i pakonceptueshëm, i ndritshëm si dielli, përtej territorit. ¹⁰ Duke e kujtuar kështu në kohën e vdekjes, përmes përkushtimit dhe fuqisë së meditimit, me mendjen tënde plotësisht të prehur dhe përqendrimin tënd të fiksuar në qendrën e vetëdijes shpirtërore ndërmjet vetullave, do ta kuptosh intuitivisht Zotëruesin suprem.

¹¹ Do të të tregoj shkurt për gjendjen e përhershme që e pohojnë të gjitha shkrimet e shenjta, në të cilën mund të hyjnë veç ata që janë të vetë-kontrolluar dhe të lirë nga pasionet vetjake. Ata jeta e të cilëve i kushtohet Brahmanit e arrijnë këtë qëllim suprem.

¹² Duke më kujtuar në kohën e vdekjes, mbylli dyert e shqisave dhe vendose mendjen në zemër. Pastaj, gjersa je i zhytur në meditim, fokusoje tërë energjinë përpjetë deri te koka. ¹³ Duke e përsëritur në këtë gjendje emrin hyjnor, rrokjen *Om* që e përfaqëson Brahmanin e pandryshueshëm, do të largohesh nga trupi dhe do ta arrish qëllimin suprem.

¹⁴ Mua më arrin lehtësisht ai që më kujton gjithmonë dhe nuk është i lidhur me asgjë tjetër. Një person i tillë është jogi i vërtetë, Arxhuna. ¹⁵ Shpirtrat e mëdhenj e bëjnë jetën e tyre të përsosur dhe më gjejnë; ata janë të çliruar nga vdekësia dhe vuajtja e kësaj ekzistence të veçantë. ¹⁶ Çdo krijesë në gjithësi e përjeton rilindjen, Arxhuna, pos atij që është i bashkuar me mua.

¹⁷ Ata që i kuptojnë ligjet kozmike e dinë se Dita e Brahmës mbaron pas një mijë jugash dhe Nata e Brahmës mbaron pas një mijë jugash. ¹⁸ Kur zbardh dita e Brahmës, format shkaktohen nga E Pamanifestuara; kur vjen nata e Brahmës, këto forma shkrihen përsëri në Të Paformën. ¹⁹ Kjo shumësi e qenieve krijohet dhe shkatërrohet përsëri e përsëri në ditët dhe netët pasuese të Brahmës. ²⁰ Por përtej kësaj gjendjeje të paformë është një realitet tjetër, i pamanifestuar, që është i përhershëm dhe nuk tretet kur shkatërrohet kozmosi. ²¹ Ata që e kuptojnë intuitivisht qëllimin suprem të jetës e dinë se jam i pamanifestuar dhe jondryshues. Duke pasë ardhur në shtëpi tek unë, nuk kthehen kurrë në ekzistencë të veçantë.

²² Ky Zotërues suprem që e përshkon tërë ekzistencën, Vetja e vërtetë e të gjitha krijesave, mund të kuptohet intuitivisht përmes dashurisë së fortë e të pastër. ²³ Janë dy rrugë, Arxhuna, që shpirti mund t'i ndjekë në kohën e vdekjes. Njëra çon në rilindje dhe tjetra në çlirim.

²⁴ Gjashtë muajt e rrugës veriore të diellit, shtegut të dritës, të zjarrit, të ditës, të djavëshit të ndritshëm, i çojnë njohësit e Brahmanit te qëllimi suprem.

²⁵ Gjashtë muajt e rrugës jugore të diellit, shtegut të tymit, të natës, të dyjavëshit të errët, i çojnë shpirtrat e tjerë te drita e hënës dhe te rilindja.

²⁶ Këto dy rrugë, drita dhe terri, thuhet se janë të përhershme, duke i çuar disa në çlirim e të tjerë në rilindje. ²⁷ Pasi t'i kesh njohur këto dy rrugë, Arxhuna, më nuk mund të deluzionohesh. Arrije këtë njohuri përmes vendosmërisë së vazhdueshme në joga. ²⁸ Ka meritë në studimin e shkrimeve të shenjta, në shërbim pa-veten, në asketizëm dhe në dhënie, por praktika e meditimit të çon përtej të gjitha këtyre në vend-qëndrimin suprem të Zotëruesit më të lartë.

Kapitulli nëntë: Rruga mbretërore

K R I S H N A

¹ Për shkak të besimit tënd, do të ta tregoj më të thellën nga fshehtësitë: duke e marrë me shumë përpjekje edhe xhnanën edhe vixhnanën, do të jesh i lirë nga të gjitha të këqijat.

² Kjo njohje mbretërore, kjo fshehtësi mbretërore, është pastruesi më i madh. E drejtë dhe e pashueshme, është gëzim ta praktikosh dhe mund të përjetohet drejtpërdrejt. ³ Por ata që nuk kanë besim në ligjin suprem të jetës nuk më gjejnë, Arxhuna. I kthehen botës, duke kaluar nga vdekja në vdekje.

⁴ Unë e përshkoj tërë gjithësinë në formën time të pamanifestuar. Të gjitha krijesat e gjejnë ekzistencën e tyre tek unë, por unë nuk jam i kufizuar nga to. ⁵ Vëreje misterin tim hyjnor! Këto krijesa nuk rrinë vërtet në mua, dhe megjithëse unë i prodhoj dhe i mbështes, nuk jam i mbyllur përbrenda tyre. ⁶ Ato lëvizin në mua siç lëvizin erërat në çdo drejtim në hapësirë. ⁷ Në fund të eonit^a këto krijesa kthehen në materien e pashfaqur; në fillimin e ciklit tjetër i dërgoj përsëri. ⁸ Duke e kontrolluar prakritin tim, përsëri e përsëri i prodhoj këto forma të shumta dhe i vë nën ndikimin e ligjeve të prakritit. ⁹ Asnjë nga këto veprime nuk më lidh, Arxhuna. Jam i palidhur me to, kështu që nuk ma shqetësojnë natyrën.

¹⁰ Nën syrin tim vigjilent, ligjet e natyrës e marrin rrugën e tyre. Kështu vihet në lëvizje bota; kështu krijohen qeniet e gjalla dhe të pagjalla.

^a Periudhë jashtëzakonisht e gjatë e kohës (shënim i shqipëruarit).

¹¹ Të papjekurit nuk shikojnë përtej pamjeve fizike për ta parë natyrën time të vërtetë si Zotëruesi i tërë krijimit. ¹² Dija e njerëzve kaq të deluzionuar është e zbrazët; jeta e tyre është e mbushur plot fatkeqësi dhe të këqija, dhe puna e veprat e tyre janë të gjitha të kota.

¹³ Por shpirtrat vërtet të mëdhenj e kërkojnë natyrën time hyjnore. Ata më adhurojnë me mendje të njëpikësuar, meqë e kanë kuptuar intuitivisht se jam burimi i përhershëm i të gjithave. ¹⁴ Duke u përpjekur vazhdimisht, ata e bëjnë të fortë vendosmërinë e tyre dhe më adhurojnë pa u lëkundur. Plot përkushtim, i këndojnë lavdisë sime hyjnore.

¹⁵ Të tjerët e ndjekin rrugën e xhnanës, urtisë shpirtërore. E shohin se aty ku është Një, ai Një jam unë; aty ku ka shumë, të gjithë janë unë; ata e shohin fytyrën time kudo.

¹⁶ Unë jam rituali dhe flijimi; jam ilaçi dhe mantra e vërtetë. Jam oferta flijuese dhe zjarri që e konsumon atë, dhe ai të cilit i ofrohet ajo.

¹⁷ Jam babai dhe nëna e kësaj gjithësie, dhe edhe gjyshi i saj; jam mbështetja e plotë e saj. Jam shuma e të gjitha njohjeve, pastruesi, rrokja *Om*; jam shkrimet e shenjta, Rig-u, Jaxhur-i dhe Sama Veda-t.

¹⁸ Jam qëllimi i jetës, Zotëruesi dhe mbështetja e të gjithëve, dëshmitari i brendshëm, vend-banimi i të gjithëve. Jam strehimi i vetëm, miku i vetëm i vërtetë; jam fillimi, të qëndruarit,^a dhe fundi i krijimit; jam mitra, dhe fara e përhershme.

¹⁹ Jam nxehtësia; unë e jap shiun dhe unë e mbaj pa e dhënë. Jam pavdekësia dhe jam vdekja; jam ajo që është dhe ajo që nuk është.

^a të rrish (shënim i shqipëruarit)

²⁰ Ata që i ndjekin ritualet e dhëna në Veda, që ofrojnë flijime dhe pinë soma^a, e çlirojnë veten nga e keqja dhe e arrijnë qiellin gjigant të zotave, ku i shijojnë kënaqësitë qiellore. ²¹ Kur t'i kenë shijuar këto plotësisht, merita e tyre shterohet dhe ata kthehen në këtë tokë të vdekjes. Kështu duke i respektuar ritualet Vedike, por të kapur në një zinxhir të pafund të merakeve, ata vijnë e shkojnë.

²² Ata që më adhurojnë dhe meditojnë për mua vazhdimisht, pa ndonjë mendim tjetër – do t'i furnizoj për të gjitha nevojat.

²³ Ata që adhurojnë zota të tjerë me besim dhe përkushtim – më adhurojnë edhe mua, Arxhuna, edhe nëse nuk i respektojnë format e zakonshme. ²⁴ Unë jam objekti i të gjitha adhurimeve, shijuesi i tyre dhe Zotëruesi. Por ata që dështojnë ta kuptojnë intuitivisht natyrën time të vërtetë duhet të rilinden. ²⁵ Ata që i adhurojnë deva-t do të shkojnë në mbretërinë e devave; ata që i adhurojnë paraardhësit e tyre do të bashkohen me ta pas vdekjes. Ata që i adhurojnë fantazmat do të bëhen fantazma; por të përkushtuarit e mi do të vijnë tek unë.

²⁶ Çkado që më ofrohet me përkushtim me zemër të pastër – gjethe, lule, frut apo ujë – unë marr hise nga ajo ofertë flijuese e dashurisë. ²⁷ Çkado që bën, bëje ofertë flijuese për mua – ushqimin që e ha, flijimet që i bën, ndihmën që e jep, madje edhe vuajtjen tënde. ²⁸ Kështu do të çlirohesh nga skllavëria e karmës, dhe nga rezultatet e saj, edhe të këndshmet edhe të dhembshmet. Pastaj, me vendosmëri për heqjen dorë dhe jogën, me zemrën tënde të lirë, do të vish tek unë.

²⁹ Unë i shikoj të gjitha krijesat njësoj; asnjë [grup] nga to nuk janë më pak të dashura dhe asnjë [grup] nga to nuk janë më të dashura. Por ata që më adhurojnë me dashuri jetojnë në mua, dhe gjallërohem në ta.

³⁰ Madje edhe mëkatarët bëhen të shenjtë kur më adhurojnë veç mua me vendosmëri të fortë. ³¹ Shpejt shpirtrat e tyre i përshtaten d'harmës dhe ata e arrijnë paqen e pakufi. Kurrë mos e harro këtë, Arxhuna: askush që është i përkushtuar ndaj meje nuk do të dëmtohet kurrë.

^a pije rituale (shënim i shqipëruesit)

³² Të gjithë ata që gjejnë strehë tek unë, pavarësisht nga lindja, raca, gjinia apo kasta e tyre, do ta arrijnë qëllimin suprem; ky kuptim intuitiv mund të arrihet edhe nga ata që përçmohen nga shoqëria. ³³ Edhe mbretërit dhe urtakët e kërkojnë këtë qëllim me përkushtim. Prandaj, duke qenë i lindur në këtë botë kalimtare e të zymtë, jepma mua gjithë dashurinë tënde. ³⁴ Mbushe mendjen tënde me mua; duamë; shërbemë; adhuromë gjithmonë. Duke më kërkuar në zemrën tënde, më në fund do të bashkohesh me mua.

Kapitulli dhjetë: Bukuria madhështore hyjnore

K R I S H N A

¹ Dëgjoje tutje, Arxhuna, mësimin tim suprem, që të jep kaq gëzim. Duke ta dashur mirëqenien, O luftëtar i armatosur fort, do të të tregoj më shumë.

² As zotat as të urtët nuk e dinë zanafillën time, se jam burimi nga i cili vijnë zotat dhe urtakët. ³ Kushdo që më njeh si Zotëruesin e tërë krijimin, pa lindje a fillim, e di të vërtetën dhe e çliron veten nga të gjitha të këqijat.

⁴ Aftësia dalluese, urtia, të kuptuarit, falja e të tjerëve, e vërteta, vetë-kontrolli dhe paqja e mendjes; kënaqësia e dhembja, lindja e vdekja, frika e guximi, nderimi e çnderimi; ⁵ jodhuna, bamirësia, të qenët i qetë në situatë të vështirë, të qenët i kënaqur dhe qëndrueshmëria e vazhdueshme në disiplinat shpirtërore – të gjitha cilësitë e ndryshme që gjenden në krijesat e gjalla e kanë burimin tek unë.

⁶ Shtatë të urtët e mëdhenj dhe katër para-ardhësit e lashtë u lindën nga mendja ime dhe e pranuan fuqinë nga unë. Prej tyre dolën të gjitha krijesat e kësaj bote.

⁷ Kushdo që e kupton fuqinë time dhe misterin e manifestimeve të mija bëhet pa dyshim i bashkuar me mua.

⁸ Unë jam burimi nga i cili evoluojnë të gjitha krijesat. Të urtët e mbajnë mend këtë dhe më adhurojnë me përkushtim të dashur. ⁹ Mendimet e tyre janë të gjitha të zhytura në mua, dhe gjithë gjallëria e tyre rrjedh tek unë. Duke e mësuar njëri-tjetrin, duke folur për mua gjithmonë, janë të lumtur dhe të përmbushur.

¹⁰ Atyre që janë të qëndrueshëm në dashuri e përkushtim ua jap urtinë shpirtërore, që të mund të vijnë tek unë. ¹¹ Për shkak të dhembshurisë ua shkatërroj errësirën e injorancës. Nga përbrenda ua ndez llampën e urtisë dhe ua davaris tërë errësirën nga jeta.

A R X H U N A

¹² Ti je Brahmani suprem, vend-banimi më i lartë, pastruesi suprem, vetë-ndriçuesi, shpirti i përhershëm, i pari ndër zotat, i palindur dhe i pafund. ¹³ Të urtët dhe parashikuesit e mëdhenj – Narada, Asita, Devala dhe Viasa po ashtu – të kanë vlerësuar kështu; tash ma ke deklaruar vetë.

¹⁴ Tash, O Krishna, besoj se gjithçka që më ke thënë është e vërtetë hyjnore. O Zotërues, as zotat as demonët nuk ta njohin natyrën reale. ¹⁵ Në të vërtetë, veç ti e njeh veten, O shpirt i lartë. Ti je burimi i qenies dhe zotëruesi i çdo krijese, Zoti i zotave, Zotëruesi i gjithësisë.

¹⁶ Tregomi të gjitha cilësitë e tua hyjnore, duke mos lënë asgjë të pathënë. Tregomë për lavditë me të cilat e mbush kozmosin. ¹⁷ Krishna, je mjeshtër suprem i jogës. Tregomë si duhet të meditoj për të fituar vetëdijesi të vazhdueshme për ty. Në çfarë gjërash dhe në çfarë mënyrash duhet të meditoj për ty? ¹⁸ O Krishna, ti që i vë në lëvizje zemrat e njerëzve, tregomi hollësisht cilësitë e tua dhe fuqitë e tua; nuk lodhem kurrë duke i dëgjuar fjalët e tua të pavdekshme.

K R I S H N A

¹⁹ Në rregull, Arxhuna, do të të tregoj për fuqitë e mija hyjnore. Do t'i përmend veç më të lavdishmet; se ato nuk kanë fund.

²⁰ Unë jam Vetja e vërtetë në zemrën e çdo krijese, Arxhuna, dhe fillimi, mesi dhe fundi i ekzistencës së tyre.

²¹ Ndër zotat e ndritur jam Vishnu; ndër ndriçuesit jam dielli; ndër zotat e stuhisë jam Mariçi, dhe në qiellin e natës jam hëna.

²² Ndër shkrimet e shenjta jam Sama Veda dhe ndër zotat më të vegjël jam Indra. Ndër shqisat jam mendja, e në qeniet e gjalla jam vetëdija.

²³ Ndër Rudrat jam Shankara. Ndër shpirtrat e botës natyrore jam Kubera, zoti i pasurisë dhe Pavaka, zjarri pastrues. Ndër malet jam Meru.

²⁴ Ndër priftërinjtë jam Brihaspati, e ndër udhëheqësit ushtarakë jam Skanda. Ndër trupat ujorë jam oqeani.

²⁵ Ndër parashikuesit e mëdhenj jam Bhrigu, e ndër fjalët jam rrokja *Om*; jam përsëritja e emrit të shenjtë, e ndër malet jam Himalajet.

²⁶ Ndër pemët jam *ashvattha*, fiku i shenjtë; ndër *gand'harvat*, muzikantët qiellorë, jam Çitrarat'ha. Ndër parashikuesit hyjnorë jam Narada, dhe ndër urtakët jam Kapila.

²⁷ U linda nga nektari i pavdekësisë si kali primordial dhe si elefanti fisnik i Indrës. Ndër qeniet njerëzore, jam mbreti.

²⁸ Ndër armët jam rrufeja. Jam Kamad'huk-u – lopa që i plotëson të gjitha meraket; jam Kandarpa – fuqia e seksit, dhe Vasuki – mbreti i gjarpërinjve.

²⁹ Jam Ananta – gjarpri i madh kozmik, dhe Varuna – zoti i ujit; jam Ariamani ndër para-ardhësit fisnikë. Ndër forcat që frenojnë jam Iama, zoti i vdekjes.

³⁰ Ndër kafshët jam luani; ndër zogjtë – shqiponja Garuda. Jam Prahlada, i lindur ndër demonët, dhe nga të gjitha masat, jam koha.

³¹ Ndër forcat pastruese jam era; ndër luftëtarët, Rama. Nga krijesat e ujit jam krokodili, dhe nga lumenjtë jam Gangu.

³² Jam fillimi, mesi dhe fundi i krijimit. Nga të gjitha shkencat jam shkenca e Vetë-njohjes, dhe jam logjika në ata që debatojnë. ³³ Ndër shkronjat jam A-ja; ndër togfjalëshat gramatikorë jam *dvandva*. Jam koha e pafund dhe mbajtësi i qenies – fytyra e të cilit shihet kudo.

³⁴ Jam vdekja, që i mposht të gjithë, dhe burimi i të gjitha qenieve që kanë për të lindur. Jam cilësitë femërore: fama, bukuria, të folurit e përsosur, kujtesa, inteligjenca, besnikëria dhe falja.

³⁵ Ndër himnet e Sama Veda-s jam Brihat-i; ndër metrikat poetike, Gaiatri. Ndër muajt jam Margashirsha, i pari i vitit; ndër stinët jam pranvera, që i nxjerr lulet.

³⁶ Jam bixhozi i bixhozxiut dhe rrezatimi në gjithçka që shkëlqen. Jam përpjekja, jam fitorja, dhe jam mirësia e të virtytshmit.

³⁷ Ndër Vrishni-t jam Krishna, dhe ndër Pandava-t jam Arxhuna. Ndër urtakët jam Viasa, e ndër poetët – Ushanas.

³⁸ Jam skeptri që e jep ndëshkimin dhe arti i qeverisjes në ata që udhëheqin. Jam heshtja e të panjohurës dhe urtia e të urtëve.

³⁹ Jam fara që mund të gjendet në çdo krijesë, Arxhuna; se pa mua s'mund të ekzistojë asgjë, as e gjallë as e pagjallë.

⁴⁰ Por nuk ka fund për cilësitë e mija hyjnore, Arxhuna; këto që i kam përmendur janë veç disa. ⁴¹ Kudo që të gjesh forcë, a bukuri a fuqi shpirtërore mund të jesh i sigurt që këto kanë dalë nga një shkëndijë e esencës sime.

⁴² Por çfarë dobie ke t'i dish të gjitha këto, Arxhuna? Veç kujtoje se jam, dhe se e mbështes tërë kozmosin veç me një fragment të qenies sime.

Kapitulli njëmbëdhjetë: Vegimi kozmik

A R X H U N A

¹ Për shkak të dhembshurisë ma ke mësuar misterin suprem të Vetes. Përmes fjalëve tua, deluzioni im është zhdukur. ² E ke shpjeguar zanafillën dhe fundin e çdo krijese, O sy-lotusi^a, dhe ma tregove ekzistencën tënde supreme, të pakufishme.

³ Pikërisht siç e ke përshkruar lavdinë tënde të pafundme, O Zotërues, tash digjem ta shoh atë. Dua të të shoh si sunduesin suprem të krijimit. ⁴ O Zotërues, mjeshër i jogës, nëse më mendon mjaft të fortë për ta parë, tregoma Vetën tënde të pavdekshme.

K R I S H N A

⁵ Shihi, Arxhuna, një milion forma hyjnore, me larmi të pafundme të ngjyrave e trajtave. ⁶ Shihi zotat e botës natyrore dhe shumë mrekulli të tjera të pazbuluara më parë. ⁷ Shihe tërë kozmosin duke u kthyer përbrenda trupit tim, dhe gjërat e tjera që ke merak t'i shohësh.

⁸ Por këto gjëra nuk mund të shihen me sytë e tu fizikë; prandaj po të jap shikim shpirtëror për ta perceptuar fuqinë time madhështore.

^a Lotusi është zambak i ujit (shënim i shqipëruarit)

S A N X H A J A

⁹ Pasi i tha këto fjalë, Krishna, mjeshtri i jogës, ia zbuloi Arxhunës formën e tij më të lartësuar, zotëruese.

¹⁰ Ai u shfaq me numër të pafund të fytyrave, të zbukuruar me xhevahire qiellore, duke shfaqur mrekulli të pafundme dhe armët e panumërta të fuqisë së tij. ¹¹ I veshur me rroba qiellore dhe i mbuluar me kurora të luleve, me erë të mirë me aroma qiellore, ai e shfaqti veten si Zotëruesi i pafund, burimi i të gjitha mrekullive, fytyra e të cilit është kudo.

¹² Nëse një mijë diej do të lindnin në qiej në të njëjtën kohë, flaka e dritës së tyre do t'i ngjante shkëlqimit të atij shpirti suprem.

¹³ Aty, brenda trupit të Zotit të zotave, Arxhuna i pa të gjitha format e shumëfishta të gjithësisë të bashkuara si një. ¹⁴ I mbushur me habi, me flokët e ngritura në ekstazë, u përkul para Zotëruesit me pëllëmbët e bashkuara dhe i tha këto fjalë.

A R X H U N A

¹⁵ O Zotërues, i shoh brenda trupit tënd të gjithë zotat dhe çdo lloj krijese të gjallë. E shoh Brahmën, Krijuesin, të ulur në lotus; i shoh urtakët e lashtë dhe gjarpërinjtë e mëdhenj qiellorë.

¹⁶ Shoh pafund gojë e krahë, stomakë e sy, dhe ti je i mishëruar në secilën formë. Të shoh kudo, pa fillim, mes a fund. Ti je Zotëruesi i tërë krijimit, dhe kozmosi është trupi yt.

¹⁷ Ti e mban një kurorë dhe e bart një topuz dhe një disk; rrezatimi yt është verbues dhe i pamatshëm. Të shoh ty, që je kaq i vështirë për t'u parë, duke shkëlqyer si diell i zjarrtë që flakëron në çdo drejtim.

¹⁸ Ti je Realiteti suprem, i pandryshueshëm, e vetmja gjë për t'u njohur. Je streha e tërë krijimit, shpirti i pavdekshëm, kujdestari i përhershëm i d'harmës së përhershme.

¹⁹ Je pa fillim, mes a fund; prek gjithçka me fuqinë tënde të pafund. Dielli dhe hëna janë sy të tutë, dhe goja jote është zjarr; rrezatimi yt e ngroh kozmosin.

²⁰ O Zotërues, prezenca jote i mbush qiejt dhe tokën dhe shtrihet në çdo drejtim. I shoh tri botët që dridhen para kësaj bukurie verbuese të formës tënde të mrekullueshme dhe të jashtëzakonshme.

²¹ Zotat hyjnë në qenien tënde, disa duke të të thirrur dhe duke të përshëndetur me frikë. Shenjtorët e mëdhenj e këndojnë lavdinë tënde, duke u lutur: “Qoftë mirë gjithçka!”

²² Shumësitë e zotave, gjysmëzotave dhe të demonëve janë të gjithë të dërrmuar nga pamja jote. ²³ O Zotërues i fuqishëm, në pamjen e morisë së syve e gojëve tua, krahëve e këmbëve, stomakëve e dhëmbëve të frikshëm, unë dhe tërë gjithësia dridhemi nga tmerri.

²⁴ O Vishnu, mund t'i shoh sytë e tu që shkëlqejnë; me gojë të hapur, ti shkëlqen në një varg ngjyrash, dhe trupi yt e prek qiellin. Të shikoj dhe zemra më dridhet; e kam humbur tërë guximin dhe tërë paqen e mendjes.

²⁵ Kur i shoh gojët e tua me dhëmbët e tyre të frikshëm, gojët që digjen si flakët në fundin e kohës, harroj ku jam dhe s'kam ku të shkoj. O Zotërues, ti je mbështetja e gjithësisë, ki mëshirë për mua!

²⁶ I shoh të gjithë bijtë e Dhritarashtrës; e shoh Bhishmën, Dronën dhe Karnën; i shoh luftëtarët tanë dhe të gjithë mbretërit që janë këtu për të luftuar. ²⁷ Të gjithë po nxitojnë te nofullat e tua të tmerrshme; i shoh disa nga ta të shtypur nga dhëmbët e tu. ²⁸ Siç rrjedhin lumenjtë në oqean, të gjithë luftëtarët e kësaj bote po kalojnë nëpër nofullat e tua të zjarrita; ²⁹ të gjitha krijesat nxitojnë kah shkatërrimi i tyre si fluturat e natës në flakë.

³⁰ Ti i lëpin botët me gjuhë dhe i fut në gojët e tua që digjen dhe i gëlltit. I mbushur me rrezatimin tënd të jashtëzakonshëm, O Vishnu, i tërë krijimi shpërthen nëpër flaka.

³¹ Më thuaj kush je, O Zotërues i formës së jashtëzakonshme. Përkulem para teje; ki mëshirë! Dua ta di se kush je, ti që ke ekzistuar para tërë krijimit. Natyra dhe veprimet e tua më hutojnë.

K R I S H N A

³² Unë jam koha, shkatërruesi i të gjithave; kam ardhur ta konsumoj botën. Madje edhe pa pjesëmarrjen tënde, të gjithë luftëtarët e mbledhur këtu do të vdesin.

³³ Prandaj ngritu, Arxhuna; mposhti armiqtë e tu dhe shijoje lavdinë e sovranitetit. Tashmë i kam vvarë të gjithë këta luftëtarë; ti do të jesh veç instrumenti im.

³⁴ Bhishma, Drona, Xhaiadratha, Karna dhe shumë të tjerë tashmë janë vvarë. Vriti ata që i kam vvarë. Mos hezito. Lufto në këtë betejë dhe do t'i mposhtësh armiqtë e tu.

S A N X H A J A

³⁵ Pasi i dëgjoji këtë fjalë, Arxhuna u drodh nga frika. Me pëllëmbët e bashkuara u përkul para Krishnës dhe iu drejtua duke belbëzuar.

A R X H U N A

³⁶ O Krishna, është e drejtë që bota kënaqet dhe gëzohet në lavdërimin tënd, që të gjithë shenjtorët dhe urtakët të përkulen dhe e tërë e keqja ik para teje në skajet e largëta të gjithësisë.

³⁷ Si mos të të adhurojnë, O Zotërues? Je shpirti i përhershëm, që ekzistonte para Brahmës–Krijuesit dhe që nuk do të pushojë kurrë së qeni. Zotëruesi i zotave, je vend-banimi i gjithësisë. I pandryshueshëm, je ajo që është dhe ajo që nuk është, dhe përtej dualitetit të ekzistencës dhe të joekzistencës. ³⁸ Je i pari ndër zotat, shpirti i pakohë, vendi pushues i të gjitha qenieve. Je njohësi dhe gjëja që njihet. Je shtëpia e fundit; me formën tënde të pafund e përshkon kozmosin.

³⁹ Ti je Vaiu, zoti i erës; Iama, zoti i vdekjes; Agni, zoti i zjarrit; Varuna, zoti i ujit. Je hëna dhe krijuesi Praxhapati, dhe stërgjyshi i të gjitha krijesave. Përulem para teje dhe të përshëndes përsëri e përsëri.

⁴⁰ Je prapa meje dhe para meje; të përulem nga çdo anë. Fuqia jote është e pamatshme. Ti përshkon gjithçka; je gjithçka.

⁴¹ Nganjëherë, meqë ishim miq, thosha me nxitim: “Oh, Krishna! Më thuaj, mik!” – vërejtje të rastit, të pakujdesshme. Çkado që mund të kem thënë me shkujdesje, qoftë kur luanim a pushonim, vetëm a në shoqëri, ulur bashkë a duke ngrënë, ⁴² nëse ishte mungesë respekti, më fal, O Krishna. Nuk e dija madhësitinë e natyrës tënde, të pandryshueshme e të pashkatërrueshme.

⁴³ Ti je babai i gjithësisë, i qenieve të gjalla dhe të pagjalla; je objekti i tërë adhurimit, guru-ja më i madh. Nuk ka askush të barazohet me ty në tri botët. Kush mund të matet me fuqinë tënde? ⁴⁴ O Zotërues dashamirës, gjunjëzohem para teje dhe ta kërkoj bekimin tënd. Siç e fal babai të birin, apo miku mikun, apo një dashurues të dashurën e vet, ashtu duhet të më falësh.

⁴⁵ Gëzohem që të shoh siç nuk je parë kurrë më parë, e megjithatë jam i mbushur me frikë nga kjo pamje e jotja si vend-banimi i gjithësisë. Të lutem më lejo të të shoh përsëri si Zotin shkëlqyes të zotave. ⁴⁶ Megjithëse je mishërimi i tërë krijimit, më lejo të të shoh përsëri jo me një mijë krahë, por me katër, duke e mbajtur topuzin dhe diskun dhe me kurorë.

K R I S H N A

⁴⁷ Arxhuna, përmes hirësisë sime ke qenë i bashkuar me mua dhe e ke pranuar këtë pamje të formës sime rrezatuese, universale, pa fillim a fund, të cilën askush tjetër nuk e ka parë ndonjëherë.

⁴⁸ As nga njohja e Vedave, as nga flijimi, as nga bamirësia, as nga ritualet, madje as nga asketizmi i ashpër nuk e ka parë ndonjë vdekatar tjetër atë që e ke parë ti, O Arxhuna heroik.

⁴⁹ Mos u shqetëso; mos ki frikë nga forma ime e jashtëzakonshme. Le të jetë zemra jote e kënaqur dhe frikat tua të davaritura duke më shikuar siç isha më parë.

S A N X H A J A

⁵⁰ Pasi i tha këto fjalë, Zotëruesi edhe një herë e mori formën e dashur të Krishnës dhe e ngushëlloi të përkushtuarin e tij, që kish qenë kaq i frikësuar.

A R X H U N A

⁵¹ O Krishna, tash që e kam parë formën tënde të dashur njerëzore, mendja ime është përsëri e qetë dhe e kthyer në normalitet.

K R I S H N A

⁵² Është jashtëzakonisht e vështirë të pajisesh me vegimin që e ke pasur; madje edhe zotat janë të etur gjithmonë të më shohin në këtë aspekt. ⁵³ As njohja e Vedave, as jeta asketike, as bamirësia, as flijimi nuk mund ta sjellin vegimin që e ke parë. ⁵⁴ Por përmes përkushtimit të qëndrueshëm, Arxhuna, mund të më njohësh, të më shohësh dhe ta arrish bashkimin me mua. ⁵⁵ Ata që më bëjnë qëllimin suprem të gjithë punës së tyre dhe veprojnë pa lidhshmëri vetjake, që m'i përkushtojnë vetet e tyre plotësisht dhe janë të lirë nga vullneti i keq për çdo krijesë, hyjnë në mua.

Kapitulli dymbëdhjetë: Rruga e dashurisë

A R X H U N A

¹ Nga të përkushtuarit që të duan dhe ata që të kërkojnë si Realitetin e përhershëm të paformë, cilët janë më të mirëvendosur në joga?

K R I S H N A

² Ata që e vënë zemrën në mua dhe më adhurojnë me përkushtim e besim të pandryshueshëm janë më të mirëvendosur në joga.

³ Sa u përket atyre që e kërkojnë Realitetin transcendental, pa emër, pa formë, duke reflektuar për Të Pamanifestuarën, përtej mundësive të mendimit dhe të ndjenjës, ⁴ me shqisat e tyre të nënshtruara dhe mendjen të qetë dhe duke u përpjekur për të mirën e të gjitha qenieve, edhe ata vërtet do të vijnë tek unë.

⁵ E megjithatë e rrezikshme dhe e ngadalshme është rruga drejt Të Pazbuluarës, e vështirë për t'u shkelur nga krijesat fizike. ⁶ Por ata për të cilët jam qëllimi suprem, që i bëjnë të gjitha punët duke hequr dorë nga vetja për mua dhe meditojnë për mua me përkushtim të sinqertë, ⁷ këta do t'i shpëtoj shpejt nga cikli fragmentar i lindjes e vdekjes, se vetëdijesia e tyre ka hyrë në mua.

⁸ Prehe mendjen në mua, prehe intelektin në mua, dhe pa dyshim do të jesh i bashkuar me mua përgjithmonë. ⁹ Nëse nuk mund ta prehësh mendjen në mua, mëso ta bësh këtë përmes praktikës së rregullt të meditimit. ¹⁰ Nëse të mungon vullneti për vetë-disiplinë të tillë, angazhohu në punën time, se shërbimi pa-veten mund të të çojë më në fund në përmbushje të plotë. ¹¹ Nëse nuk je në gjendje ta bësh as këtë, dorëzoma veten, duke e disiplinuar veten dhe duke hequr dorë nga rezultatet e të gjitha veprimeve tua.

¹² Më e mirë, vërtet, është njohja se sa praktika mekanike. Më i mirë se njohja është meditimi. Por edhe më i mirë është dorëzimi i lidhshmërisë me rezultatet, sepse aty pason paqja e menjëhershme.

¹³ E dua atë që është i pa-aftë për keqdashje, që është miqësor dhe dashamirës i dhembshur. Ata që jetojnë përtej asaj që e mbërrin *Unë-i* dhe *imja* dhe që e mbërrin kënaqësia e dhembja, ¹⁴ të durueshmit, të kënaqurit, ata që e kontrollojnë veten, të qëndrueshmit në besim, që më janë dhënë me tërë zemrën e vet dhe mendjen e vet – me të tillët jam i dashuruar.

¹⁵ Duke mos e trazuar botën as duke mos u trazuar nga ajo, qëndrojnë mbi ndikimin e ngazëllimit, të konkurrencës e të frikës: ai është i dashuri im.

¹⁶ Ata janë të shkëputur, të pastër, efikasë, të paanshëm, asnjëherë të shqetësuar, pa-veten në të gjitha ndërmarrjet e tyre; ata janë të përkushtuarit e mi, shumë të dashur për mua.

¹⁷ I dashur për mua është ai që nuk vrapon pas të këndshmes apo të ikë nga e dhembshmja, që nuk pikëllohet, nuk e pshon, por i lë gjërat të vijnë e të shkojnë siç ndodhin.

¹⁸ Ai njeri i përkushtuar që e shikon mikun dhe armikun në mënyrë të njëjtë, që nuk inkurajohet nga lavdërimi as nuk zhgënjehet nga fajësimi, njësoj në të nxehtë e në të ftohtë, në kënaqësi e dhembje, i lirë nga lidhshmëritë vetjake, ¹⁹ i njëjtë në nderim e çnderim, i qetë, gjithnjë i plotë, në harmoni kudo, i qëndrueshëm në besim – i tilli është i dashur për mua.

²⁰ Ata që meditojnë mbi këtë d'harma të pavdekshme siç e kam deklaruar, plot besim dhe duke më kërkuar si qëllimin suprem të jetës, janë vërtet të përkushtuarit e mi, dhe dashuria ime për ta është shumë e madhe.

Kapitulli trembëdhjetë: Fusha dhe njohësi

K R I S H N A

¹ Trupi quhet fushë, Arxhuna; ai që e njeh atë quhet Njohësi i fushës. Kjo është njohja e atyre që dinë. ² Unë jam Njohësi i fushës në secilin, Arxhuna. Njohja e fushës dhe e Njohësit të saj është njohje e vërtetë.

³ Dëgjo dhe do ta shpjegoj natyrën e fushës dhe si ndodh ndryshimi brenda saj. Do ta përshkruaj edhe Njohësin e fushës dhe fuqinë e tij. ⁴ Këto të vërteta janë kënduar nga urtakët e mëdhenj në mënyra të ndryshme dhe janë zbërthyer në argumente precize në lidhje me Brahmanin.

⁵ Fusha, Arxhuna, përbëhet nga këto: pesë fushat e perceptimit shqisor; pesë elementet; pesë organet e shqisave dhe pesë organet e veprimit; tri komponentat e mendjes: *manas*, *buddhi* dhe *ahamkara*; dhe energjia pa tipare dalluese nga e cila evoluon të gjitha këto. ⁶ Në këtë fushë shfaqet merakuri e neveria, kënaqësia e dhembja, trupi, inteligjenca dhe vullneti.

⁷ Ata që dinë vërtet[,] janë të lirë nga krenaria e mashtrimi. Janë të butë, falës, të drejtë dhe të pastër; të përkushtuar ndaj mësuesit të tyre shpirtëror, të mbushur me forcë të brendshme, dhe e kontrollojnë veten. ⁸ Të shkëputur nga objektet shqisore dhe vetë-vullneti, e kanë mësuar mësimin e dhembshëm të lindjes së veçuar e të vuajtjes, të pleqërisë, të sëmundjes e të vdekjes.

⁹ Të lirë nga lidhshmëria vetjake, nuk ngatërrohen në mënyrë të pakontrollueshme madje as në shtëpi dhe familje. Janë me mendje të njëtrajtshme në fat të mirë dhe të keq. ¹⁰ Përkushtimi i tyre ndaj meje është i pashkëputur. Duke e shijuar vetminë e këndshme dhe duke mos e ndjekur turmën, më kërkojnë veç mua. ¹¹ Kjo është njohje e vërtetë, ta kërkojë Vetën si qëllimin e vërtetë të urtisë gjithmonë. Të kërkojë çkado tjetër është injorancë.

¹² Do të të tregoj për urtinë që çon në pavdekësi: Brahmani i pafillim, që s'mund të quhet as qenie as jo-qenie.

¹³ Ai rri në të gjithë, në çdo dorë e këmbë e kokë, në çdo gojë e sy e vesh në gjithësi. ¹⁴ Vetë pa shqisa, shkëlqen përmes funksionimit të shqisave. Plotësisht i pavarur, i mbështet të gjitha gjërat. Përtej gunave, e shijon lojën e tyre.

¹⁵ Është edhe afër edhe larg, edhe përbrenda edhe përjashta secilës krijesë; lëviz dhe është i palëvizshëm. ¹⁶ Në subtilitetin e vet është përtej aftësisë për të kuptuar. Është i pandashëm, e megjithatë duket i ndarë në krijesa të veçanta. Dije se është krijuesi, ruajtësi dhe shkatërruesi.

¹⁷ Duke ndenjur në secilën zemër, është përtej errësirës. Quhet drita e dritës, objekti dhe qëllimi i njohjes dhe vetë njohja.

¹⁸ Ta kam zbuluar natyrën e fushës dhe kuptimin dhe objektin e njohjes së vërtetë. Ata që më janë përkushtuar, duke i njohur këto gjëra, janë të bashkuar me mua.

¹⁹ Dije se prakriti dhe Purusha janë të dyjat pa fillim, dhe se nga prakriti vijnë gunat dhe gjithçka që ndryshon. ²⁰ Prakriti është agjenti, shkaktari dhe efekti i secilit veprim, por është Purusha që duket se përjeton kënaqësi e dhembje.

²¹ Purusha, duke pushuar në prakriti, e dëshmon lojën e gunave të lindur nga prakriti. Por lidhshmëria me gunat e bën një person të lindet për të mirë apo për të keq.

²² Brenda trupit Purusha supreme quhet dëshmitare, miratuese, mbështetëse, shijuese, Zotëruesi suprem, Vetja më e lartë.

²³ Kushdo që e kupton intuitivisht natyrën e vërtetë të Purushës, praktitin dhe gunat, çfarëdo rruge që të ndjekë ai apo ajo, më nuk lindet përsëri ndaras.

²⁴ Disa e kuptojnë intuitivisht Vetën brenda tyre përmes praktikës së meditimit, disa përmes rrugës së urtisë dhe të tjerë përmes shërbimit pa-veten. ²⁵ Të tjerë mund të mos i njohin këto rrugë; por duke i dëgjuar dhe ndjekur udhëzimet e një mësuesi të ndriçuar, edhe ata shkojnë përtej vdekjes.

²⁶ Çkado që ekziston, Arxhuna, e gjallë a e pagjallë, lindet përmes bashkimit të fushës dhe Njohësit të saj.

²⁷ Shohin vërtet veç ata që e shohin Zotëruesin njëjtë në secilën krijesë, që e shohin të pavdekshmen në zemrat e gjithçkaje që vdes. ²⁸ Duke e parë të njëjtin Zotërues kudo, nuk e dëmtojnë veten as të tjerët. Kështu e arrijnë qëllimin suprem.

²⁹ Shohin vërtet veç ata që e shohin se të gjitha veprimet kryhen nga prakriti, gjersa Vetja mbetet e palëkundur. ³⁰ Kur e shohin shumëllojësinë e krijimit të rrënjësor në atë unitet dhe duke u rritur prej tij, e arrijnë përmbushjen në Brahmanin.

³¹ Kjo Vete supreme është pa fillim, pa tipare dalluese, e pavdekshme. Megjithëse rri në trup, Arxhuna, as s'vepron as s'preket nga veprimi. ³² Gjersa akasha e përshkon kozmosin por mbetet e pandotur, Vetja s'mund të ndotet kurrë megjithëse rri në secilën krijesë.

³³ Gjersa dielli e ndriçon botën, Vetja që rri në fushë është burimi i tërë dritës në fushë. ³⁴ Ata që, me syrin e urtisë, e dallojnë fushën nga Njohësi i saj dhe rrugën drejt lirisë nga zinxhirët e prakritit, e arrijnë qëllimin suprem.

Kapitulli katërbëdhjetë: Forcat e evolucionit

K R I S H N A

¹ Më lejo të të tregoj më shumë për urtinë që e tejkalon tërë njohjen, përmes së cilës shenjtorët dhe urtakët e arritën përsosmërinë. ² Ata që mbështeten në këtë urti do të jenë të bashkuar me mua. Për ta nuk ka as rilindje as frikë nga vdekja.

³ Mitra ime është prakriti; në të e vendosi farën. Kështu linden të gjitha gjërat e krijuara. ⁴ Gjithçka e lindur, Arxhuna, vjen nga mitra e prakritit, dhe unë jam babai farë-dhënës.

⁵ Janë tri gunat e lindura nga prakriti – sattva, raxhas dhe tamas – që e lidhin Vetën e pavdekshme me trupin. ⁶ Sattva – e pastër, e ndritshme dhe e lirë nga pikëllimi – na ndërlidh me lidhshmërinë ndaj lumturisë e urtisë. ⁷ Raxhas është pasioni, që del nga merakuri vetjak dhe lidhshmëria. Këto e ndërlidhin Vetën me veprimin e pakontrollueshëm. ⁸ Tamas, e lindur nga injoranca, i deluzionon të gjitha krijesat përmes të qenët të pavëmendshëm, përtacisë e gjumit.

⁹ Sattva na ndërlidh me lumturinë; raxhas na ndërlidh me veprimin. Tamas, duke e shtrembëruar të kuptuarit tonë, na ndërlidh me deluzionin.

¹⁰ Sattva mbizotëron kur transformohen raxhas dhe tamas. Raxhas triumfon kur sattva është e dobët dhe tamas e mposhtur. Tamas triumfon kur raxhas dhe sattva janë të fjetura.

¹¹ Kur mbizotëron sattva, drita e urtisë shkëlqen nëpër çdo portë të trupit. ¹² Kur mbizotëron raxhas, personi vrapon për të ndjekur qëllime vetjake dhe të pangopura, të nxitura nga shqetësimi dhe merakuri. ¹³ Kur tamas është dominuese personi jeton në terr – përtac, i hutuar dhe lehtësisht i magjepsur.

¹⁴ Ata që vdesin në gjendjen e sattva-s i arrijnë botët e pastra të të urtëve. ¹⁵ Ata që vdesin në raxhas rilinden mes njerëzve të nxitur nga puna. Por ata që vdesin në tamas ngjizen në mitrat e injorantëve.

¹⁶ Fruti i veprave të mira është i pastër dhe sattvik. Fruti i raxhas është vuajtja. Fruti i tamas është injoranca dhe pandjeshmëria.

¹⁷ Nga sattva vjen të kuptuarit; nga raxhas – lakmia. Por rezultati i tamas është hutia, magjepsja dhe injoranca.

¹⁸ Ata që jetojnë në sattva shkojnë përjetë; ata në raxhas mbesin ku janë. Por të zhyturit në tama fundosen teposhtë.

¹⁹ Të urtët e shohin qartë se çdo veprim është vepër e gunave. Duke e ditur atë që është mbi gunat, hyjnë në bashkim me mua.

²⁰ Duke shkuar përtej tri gunave që e formojnë trupin, e lënë prapa ciklin e lindjes e të vdekjes, plakjes shëndetlige e pikëllimit, dhe arrijnë në pavdekësi.

A R X H U N A

²¹ Cilat janë karakteristikat e atyre që kanë shkuar përtej gunave, O Zotërues? Si veprojnë? Si kanë kaluar përtej kapjes së gunave?

K R I S H N A

²² Ata janë të paemocion ndaj harmonisë së sattva-s, aktivitetit të raxhas apo deluzionit të tamas. Nuk ndjejnë neveri kur këto forca janë aktive, as nuk eten për to kur këto forca ulen.

²³ Ata mbahen të paanshëm, të pashqetësuar nga veprimet e gunave. Duke e ditur se janë gunat ato që veprojnë, ata rrinë brenda vetes dhe nuk lëkunden.

²⁴ Të mirëvendosur brenda vetes, janë të njëjtë ndaj kënaqësisë e dhembjes, lavdërimit e fajësimit, sjelljes së mirë e të pamirë. Balta, shkëmbi dhe ari janë të njëjtë për ta. ²⁵ Të njëjtë në nderim e në çnderim, të njëjtë ndaj mikut e armikut, kanë hequr dorë nga çdo kërkim vetjak. Të tillë janë ata që kanë shkuar përtej gunave.

²⁶ Duke më shërbyer me dashuri të qëndrueshme, një burrë apo grua shkon përtej gunave. I tilli është i përshtatshëm për bashkim me Brahmanin. ²⁷ Se unë jam mbështetja e Brahmanit, të d'harmës së përhershme, të pandryshueshme, të pavdekshme, burimit të gjithë gëzimit.

Kapitulli pesëmbëdhjetë: Vetja supreme

K R I S H N A

¹ Urtakët flasin për pemën e pandryshueshme ashvattha, me krye-rrënjën e saj lart dhe degët e saj poshtë. Në këtë pemë rriten shkrimet e shenjta; duke e parë burimin e tyre, njeriu e njeh esencën e tyre.

² Të ushqyera nga gunat, gjymtyrët e kësaj peme përhapen lart e poshtë. Objektet shqisore rriten në gjymtyrë si sytha; rrënjët që varen poshtë na lidhin me veprimin në këtë botë.

³ Forma e vërtetë e kësaj peme – esenca, fillimi dhe fundi i saj – nuk perceptohet në këtë tokë. Këtë pemë të rrënjëzuar fort preje me sëpatën e mprehtë të shkëputjes; ⁴ pastaj gjeje rrugën që nuk kthehet prapa më. Kërkoje Atë, Shkakun E Parë, nga i cili erdhi gjithësia para shumë kohësh.

⁵ Të pa-deluzionuar nga krenaria, të lirë nga lidhshmëria vetjake dhe meraku vetjak, përtej dualitetit të kënaqësisë e dhembjes, gjithnjë të vetëdijsëm për Vetën, të urtët shkojnë përpara kah ai qëllim i përhershëm. ⁶ As dielli as hëna as zjarri nuk mund t'i shtojnë asaj drite. Ky është vend-banimit im suprem, dhe ata që hyjnë aty nuk kthehen në ekzistencë të veçuar.

⁷ Një pjesë e përhershme e imja hyn në botë, duke i marrë fuqitë e veprimit dhe të perceptimit dhe një mendje të bërë nga prakriti. ⁸ Kur Vetja hyjnore hyn dhe del nga një trup, i merr këto me vete siç e bart era një aromë nga një vend në tjetrin. ⁹ Duke e përdorur mendjen, veshët, sytë, hundën dhe shqisat e shijes e të prekjes, Vetja kënaqet me objektet shqisore.

¹⁰ Të deluzionuarit nuk e shohin Vetën kur e lë trupin apo kur rri brenda tij. Ata nuk e shohin Vetën duke u kënaqur me objektet shqisore apo duke vepruar përmes gunave. Por ata që e kanë syrin e urtisë shohin.

¹¹ Ata që përpiqen me vendosmëri në rrugën e jogës e shohin Vetën përbrenda. Të pavëmendshmit, që përpiqen në mënyrë të papërsosur, nuk e shohin.

¹² Shkëlqimi i diellit që e ndriçon botën, shkëlqimi i hënës e i zjarrit – këto janë lavdi im. ¹³ Me sasi të vockël të energjisë hyj në tokë dhe i mbështes të gjitha krijesat. Përmes hënës, enës së lëngut jetë-dhënës, i ushqej të gjitha bimët. ¹⁴ Hyj në krijesat që marrin frymë dhe rri përbrenda si fryma jetëdhënëse. Jam zjarri në stomakun që e tret tërë ushqimin.

¹⁵ Duke hyrë në çdo zemër, e jap fuqinë për të kujtuar dhe kuptuar; jam unë përsëri ai që e merr atë fuqi. Të gjitha shkrimet e shenjta çojnë tek unë; jam autori dhe urtia e tyre.

¹⁶ Në këtë botë janë dy rende të qenies: krijesa e kalbshme e ndarë dhe shpirti i pandryshueshëm. ¹⁷ Por përtej këtyre është një tjetër, Vetja supreme, Zotëruesi i përhershëm, që hyn në tërë gjithësinë dhe e mbështet nga përbrenda.

¹⁸ Unë jam ajo Vete supreme, e lavdëruar nga shkrimet e shenjta si ajo që është përtej të ndryshueshmes dhe të pandryshueshmes. ¹⁹ Ata që e shohin në mua atë Vete supreme shohin vërtet. Ata e kanë gjetur burimin e tërë urtisë, Arxhuna, dhe më adhurojnë me gjithë zemër.

²⁰ E kam ndarë këtë të vërtetë të thellë me ty, Arxhuna. Ata që e kuptojnë do ta arrijnë urtinë; ata do ta kenë bërë atë që duhet bërë.

Kapitulli gjashtëmbëdhjetë: Dy rrugët

K R I S H N A

¹ Ji i patrembur dhe i pastër; kurrë mos u lëkund në vendosmërinë apo përkushtimin tënd ndaj jetës shpirtërore. Jep lirisht! Ji asi që e kontrollon veten, i sinqertë, i vërtetë, i dashur dhe plot merak për të shërbyer. Kuptoje intuitivisht të vërtetën e shkrimeve të shenjta; mësohu të jesh i shkëputur dhe të gëzohesh në heqjen dorë. ² Mos u zemëro apo ta lëndosh asnjë krijesë të gjallë, por ji dashamirës i dhembshur e i butë; shfaqju vullnet të mirë të gjithëve. ³ Kultivoje entuziazmin, durimin, vullnetin, pastërtinë; shmange ligësinë e krenarinë. Pastaj, Arxhuna, do ta arrish fatin tënd hyjnor.

⁴ Cilësi të tjera, Arxhuna, e bëjnë një person gjithnjë e më jonjerëzor: hipokrizia, arroganca, mendjemadhësia, zemërimi, mizoria, injoranca.

⁵ Cilësitë hyjnore çojnë në liri; djallëzoret, në robëri. Por mos u pikëllo, Arxhuna; je lindur me attribute hyjnore.

⁶ Disa njerëz kanë prirje hyjnore, të tjerë demonike. E kam përshkruar hyjnoren gjerësisht, Arxhuna; tash dëgjo gjersa e përshkruaj demoniken.

⁷ Demonikët bëjnë gjëra që duhet t'i shmangin dhe i shmangin gjërat që duhet t'i bëjnë. Ata nuk kanë ndjenjë të drejtësisë, të pastërtisë apo të të vërtetës.

⁸ “S’ka Zot”, thonë, “as të vërtetë, as ligj shpirtëror, as rregull moral. Baza e jetës është seksi; çka tjetër mund të jetë?” ⁹ Duke mbajtur pikëpamje të tilla të shtrembëruara, duke pasur aftësi shumë të vogël dalluese, bëhen armiq të botës, duke shkaktuar vuajtje e shkatërrim.

¹⁰ Hipokritë, krenarë e arrogantë, duke jetuar në deluzion dhe duke u kapur pas ideve deluzive, të pangopur në merakët e tyre, i ndjekin qëllimet e tyre të papastra. ¹¹ Megjithëse të ngarkuar me frika që përfundojnë veç me vdekje, ende pohojnë me siguri të plotë: “Kënaqësia e epshit është më e larta që mund ta ofrojë jeta.”

¹² Të lidhur nga të gjitha anët nga planet e fshehta e ankthi, të shtyrë nga zemërimi e lakmia, e grumbullojnë me çdo mënyrë që mundën një sasi të madhe të fshehtë të parave për kënaqjen e dëshirave të tyre të zjarra.

¹³ “Sot e mora këtë”, thonë; “nesër do ta marr atë. Kjo pasuri është e imja, dhe edhe ajo do të jetë e imja. ¹⁴ I kam shkatërruar armiqtë e mi. Do t’i shkatërroj edhe të tjerët! A nuk jam si Zoti? Shijoj çka të dua. Jam i suksesshëm. Jam i pushtetshëm. Jam i lumtur. ¹⁵ Jam i pasur dhe i lindur në familje shumë të vlerësuar. Kush është i barabartë me mua? Do të bëj fljime dhe do të jap dhurata, dhe do të gëzohem në bujarinë time.” Kështu vazhdojnë, të deluzionuar nga injoranca. ¹⁶ Të lidhur nga lakmia e tyre dhe të ngatërruar në rrijetë të deluzionit, të futur në vorbull nga një mendje e copëtuar, bien në ferr të errët.

¹⁷ Duke e konsideruar veten si më të rëndësishmin, kokëfortë, të rrëmbyer nga krenaria e pasurisë, kryejnë fljime për t’u dukur, që t’u bëjnë përshtyje njerëzve, pa ndonjë konsideratë për destinimin e tyre. ¹⁸ Egoistë, të dhunshëm, arrogantë, epshorë, të zemëruar, ziliqarë për të gjithë, abuzojnë me prezencën time përbrenda trupave të tyre dhe në trupat e të tjerëve.

¹⁹ Jetë pas jete, ata që janë keqdashës, urryes, mizorë dhe të degraduar i gjuaj në mitrat e atyre me natyra të ngjashme demonike. ²⁰ Lindje pas lindjeje e gjejnë veten me prirje demonike. Të degraduar në këtë mënyrë, Arxhuna, dështojnë të më arrijnë dhe bien edhe më poshtë.

²¹ Janë tri porta për te ky ferr vetëshkatërrues: epshi, zemërimi dhe lakmia. Hiq dorë nga këto trija. ²² Ata që shpëtojnë nga këto tri porta të errësirës, Arxhuna, e kërkojnë atë që është më e mira dhe e arrijnë qëllimin suprem të jetës. ²³ Të tjerët i shpërfillin mësimet e shkrimeve të shenjta. Të shtyrë nga merakë vetjak, e huqin qëllimin e jetës, e huqin madje edhe lumturinë e suksesin.

²⁴ Prandaj lejoji shkrimet e shenjta të jenë udhërrëfyese yt në atë që e bën dhe atë që nuk e bën. Kuptoju mësimet e tyre; pastaj vepron në përputhje me to.

Kapitulli shtatëmbëdhjetë: Fuqia e besimit

ARXHUNA

¹ O Krishna, si është gjendja e atyre që i shpërfillin shkrimet e shenjta por prapë adhurojnë me besim? A veprojnë nga sattva, raxhas apo tamas?

KRISHNA

² Çdo krijesë lind me besim të një lloji, qoftë sattvik, raxhasik apo tamasik. Dëgjo, dhe do të ta përshkruaj secilën.

³ Besimi ynë përputhet me natyrën tonë, Arxhuna. Natyra njerëzore përbëhet nga besimi. Një person është ajo çka është shraddha e tij.

⁴ Ata që janë sattvikë i adhurojnë format e Zotit; ata që janë raxhasikë e adhurojnë pushtetin dhe pasurinë. Ata që janë tamasikë i adhurojnë shpirtrat dhe fantazmat. ⁵ Disa shpikin vuajtje të ashpra penduese. Të motivuar nga hipokrizia dhe egotizmi, ⁶ i torturojnë trupat e tyre të pafajshëm dhe mua që rri përbrenda. Të verbuar nga forca dhe pasioni i tyre, veprojnë dhe mendojnë si demonë.

⁷ Tri llojet e besimit e shprehin veten në zakonet e atyre që i mbajnë ato: në ushqimin që u pëlqen, në punën që e bëjnë, në disiplinat që i praktikojnë, në dhuratat që i japin. Dëgjo, dhe do të t'i përshkruaj mënyrat e tyre të ndryshme.

⁸ Njerëzit sattvikë e shijojnë ushqimin që është i butë, i shijshëm, substancial, i këndshëm dhe ushqyes, ushqim që e nxit shëndetin, forcën, gëzimin dhe jetëgjatësinë. ⁹ Njerëzit raxhasikë e pëlqejnë ushqimin e kripur apo të hidhur, të

nxehetë, të thartë apo pikant – ushqim që e nxit dhembjen, parehatinë dhe sëmundjen.¹⁰ Njerëzit tamasikë e pëlqejnë ushqimin e tejpkukur, të ndenjtur, të mbetur dhe të papastër, ushqim që e ka humbur shijen dhe vlerën ushqyese.

¹¹ Sattvikët kryejnë flijime me gjithë mendjen e tyre të fiksuar në destinimin e flijimit. Pa menduar për shpërblimin, i ndjekin mësimet e shkrimeve të shenjta.

¹² Raxhasikët i kryejnë flijimet për hir të shfaqjes dhe të mirës që do t'ua sjellin.

¹³ Tamasikët i kryejnë flijimet duke e injoruar edhe shkronjën edhe frymën. Ata i lënë jashtë lutjet e duhura, ofertat flijuese të duhura, ushqimin e duhur dhe besimin e duhur.

¹⁴ T'u ofrosh shërbim zotave, të mirëve, të urtëve dhe mësuesit tënd shpirtëror; pastërtia, ndershmeria, të përmbajturit në ushqime dhe jodhuna: këto janë disiplinat e trupit. ¹⁵ Të ofrosh fjalë qetësuese, të flasësh me vërtetësi, këndshëm dhe në mënyrë ndihmuese dhe t'i studiosh shkrimet e shenjta: këto janë disiplinat e të folurit. ¹⁶ Qetësia, butësia, heshtja, vetë-përmbajtja dhe pastërtia: këto janë disiplinat e mendjes.

¹⁷ Kur këto tri nivele të vetë-disiplinës praktikohen pa lidhshmëri me rezultatet, por në frymë të besimit të madh, urtakët e quajnë këtë praktikë – satvike.

¹⁸ Disiplinat e praktikuarat për të fituar respekt, nder apo admirim janë raxhasike; ato janë të pambështetshme dhe kalimtare në efektet e tyre. ¹⁹ Disiplinat e praktikuarat për të fituar pushtet ndaj të tjerëve, apo në besimin e hutuar se ta torturosh veten është shpirtërore, janë tamasike.

²⁰ Të japësh thjesht sepse është e drejtë të japësh, pa menduar për kthimin, në kohën e duhur, në rrethanat e duhura, dhe një personi të denjë, është dhënie sattvike. ²¹ Të japësh me keqardhje apo në pritje për ta marrë ndonjë favor apo për të marrë diçka në këmbim është raxhasike. ²² Dhënia në kohë të papërshtatshme, në rrethana të papërshtatshme dhe një personi të padenjë, pa ndjesi të kujdesit apo respektit, është tamasike.

²³ *Om Tat Sat*: këto tri fjalë e përfaqësojnë Brahmanin, nga i cili vijnë priftërijntë dhe shkrimet e shenjta dhe flijimet. ²⁴ Prandaj, ata që i ndjekin Vedat, gjithmonë e përsërisin fjalën *Om* kur ofrojnë flijime, kur kryejnë disiplina shpirtërore apo

kur japin dhurata. ²⁵ Ata që kërkojnë çlirim e jo ndonjë përfitim personal e shtojnë fjalën *Tat* kur i kryejnë këto vepra të adhurimit, të disiplinës e të bamiresisë. ²⁶ *Sat* domethënë “ajo që është”; ajo tregon edhe mirësi. Prandaj përdoret për ta përshkruar një vepër të denjë.

²⁷ Të jesh i qëndrueshëm në vetë-flijim, vetë-disiplinë dhe dhënie është *sat*. Edhe të veprosh në përputhje me këto trija është *sat*. ²⁸ Por të angazhohesh në flijim, vetë-disiplinë e dhënie pa besim të mirë është *asat*, pa vlerë a mirësi, qoftë në këtë jetë apo në të ardhshmen.

Kapitulli tetëmbëdhjetë: Liria dhe heqja dorë

A R X H U N A

¹ O Krishna, shkatërrues i të keqes, të lutem ma shpjego *sanniasa-n dhe tiaga-n* dhe si dallon një lloj i heqjes dorë nga tjetri.

K R I S H N A

² Të përmbahesh nga veprimet vetjake është një lloj i heqjes dorë, i quajtur *sanniasa*; të heqësh dorë nga fruti i veprimit është një tjetër lloj, i quajtur *tiaga*.

³ Ndër të urtët, disa thonë se nga çdo veprim duhet të hiqet dorë si [veprim] i keq. Të tjerë thonë se lloje të caktuara të veprimit – vetë-flijimi, dhënia dhe vetë-disiplina – duhet të vazhdojnë. ⁴ Dëgjo, Arxhua, dhe do t'i shpjegoj tri llojet e *tiaga-s* dhe përfundimet e mija në lidhje me to.

⁵ Nga vetë-flijimi, dhënia dhe vetë-disiplina nuk duhet hequr dorë, se e pastrojnë të vëmendshmin. ⁶ E megjithatë këto, Arxhuna, duhet të bëhen pa merak për shpërblime vetjake. Kjo është esenciale.

⁷ Të heqësh dorë nga përgjegjësitë e tua nuk është e përshtatshme. Të urtët – atë heqje dorë të deluzionuar – e quajnë *tamasike*. ⁸ Ta shmangësh veprimin nga frika e vështirësisë apo paretatizimi fizike është *rahasike*. Nuk ka shpërblim në heqjen dorë të llojit të tillë. ⁹ Por t'i përmbushësh përgjegjësitë e tua duke e ditur se janë të obligueshme, njëkohësisht duke mos pasur merak asgjë për vete – kjo është heqje dorë *sattvike*. ¹⁰ Ata që janë të pajisur me *sattva* e kuptojnë qartë kuptimin e heqjes dorë dhe nuk lëkunden. Nuk tremben nga puna e pakëndshme dhe as nuk e kërkojnë një punë sepse është e këndshme.

¹¹ Përderisa njeriu ka trup, nuk mund të heqë dorë krejtësisht nga veprimi. Heqja dorë e vërtetë është të shkëputesh plotësisht nga çdo merak për shpërblim personal. ¹² Ata që janë të lidhur me shpërblimin personal do t'i korrin pasojat e veprimeve të tyre: disa të këndshme, disa të pakëndshme, disa të përziara. Por ata që heqin dorë nga çdo merak për shpërblim personal shkojnë përtej asaj që e arrin karma.

¹³ Dëgjo, Arxhuna, dhe do t'i shpjegoj pesë elementet e nevojshme për realizimin e çdo veprimi, siç jepet mësim nga urtia e Sankhia-s. ¹⁴ Trupi, mjetet, egoja, të bërit e veprës dhe vullneti hyjnor: ¹⁵ këta janë pesë faktorët në të gjitha veprimet, të drejta a të gabuara, në mendim, fjalë apo vepër.

¹⁶ Ata që nuk e kuptojnë këtë e mendojnë veten si agentë të veçantë. Me intelektet e tyre të vrazhda dështojnë ta shohin të vërtetën. ¹⁷ Personi që është i lirë nga ego, që e ka arritur pastërtinë e zemrës, megjithëse i vret këta njerëz, nuk vret dhe nuk është i lidhur me veprën e tij.

¹⁸ Njohja, gjëja që duhet të njihet dhe njohësi: këta tre e nxisin veprimin. Mjetet, vetë vepra dhe bërësi: këta tre janë tërësia e veprimit. ¹⁹ Njohja, veprimi dhe bërësi mund të përshkruhen sipas gunave. Dëgjo, dhe do të t'i shpjegoj dallimet e tyre.

²⁰ Njohja sattvike e sheh Qenien e pashkatërrueshme që është një në të gjitha qeniet, unitetin që qëndron në themel të shumëllojshmërisë së krijimit. ²¹ Njohja raxhasike i sheh të gjitha gjërat dhe krijesat si të ndara dhe të ndryshme. ²² Njohja tamasike, duke mos pasur ndjesi të perspektivës, e sheh një pjesë të vogël dhe e ngatërron atë duke iu dukur si e tëra.

²³ Puna e kryer për t'i përmbushur obligimet e njeriut, pa mendim për shpërblim personal apo nëse puna është e këndshme apo e pakëndshme, është sattvike.

²⁴ Puna e nxitur nga merak vetjak apo vetë-vullneti, plot stres, është raxhasike.

²⁵ Puna që ndërmerret verbërisht, pa i marrë parasysh pasojat, shpërdorimet, lëndimet e të tjerëve apo kapacitetet e vetë personit, është tamasike.

²⁶ Punonjësit sattvikë janë të lirë nga egotizmi dhe lidhshmëritë vetjake, plot entuziazëm dhe vendosmëri të guximshme si në sukses ashtu edhe në dështim.

²⁷ Punonjësit raxhasikë kanë merake të forta personale dhe janë të etur për shpërblime për veprimet e tyre. Lakmitarë, të papastër dhe destruktivë, shkatërrohen lehtë nga fati, i mirë apo i keq. ²⁸ Punonjësit tamasikë janë të padisplinuara, vulgarë, kokëfortë, mashtrues, të pandershëm dhe dembelë. Dëshpërohen lehtë dhe janë të prirur për zvarritje.

²⁹ Dëgjo, Arxhuna, teksa i përshkruaj tri llojet e të kuptuarit dhe të vullnetit.

³⁰ Të dish kur të veprosh dhe kur të përmbahesh nga veprimi, cili është veprim i drejtë dhe cili është i gabuar, çka sjell siguri e çka pasiguri, çka sjell liri e çka robërim: këto janë shenja të intelektit sattvik.

³¹ Intelekti raxhasik i ngatërron veprimet e drejta dhe të gabuara, dhe nuk mund ta dallojë atë që duhet të bëhet nga ajo që s'duhet të bëhet. ³² Intelekti tamasik është i mbështjellë në terr, duke ua ndërruar vendet plotësisht të drejtës dhe të gabuarës kahdo që kthehet.

³³ Vullneti sattvik, i zhvilluar përmes meditimit, e mban prana-n, mendjen dhe shqisat në harmoni jetike. ³⁴ Vullneti raxhasik, i ndikuar nga meraku vetjak, e ndjek pasurinë, kënaqësinë dhe gjendjen e të qenët i respektueshëm. ³⁵ Vullneti tamasik e shfaq veten në injorancë kokëfortë, ngathtësi, frikë, pikëllim, depresion dhe mendjemadhësi.

³⁶ Tash dëgjo, Arxhuna: janë edhe tri lloje të lumturisë. Me përpjekje të qëndrueshme, njeriu vjen te fundi i pikëllimit. ³⁷ Ajo që duket si helm në fillim, por ka shije si nektar në fund – ky është gëzimi i sattva-s, i lindur nga një mendje që është në paqe me veten. ³⁸ Kënaqësia nga shqisat duket si nektar fillimisht, por është e hidhur si helm në fund. Ky është lloji i lumturisë që u vjen raxhasikëve.

³⁹ Ata që janë tamasikë i nxjerrin kënaqësitë e tyre nga gjumi, përtacia dhe materiet dehëse. Edhe në fillim edhe në fund, kjo lumturi është deluzion.

⁴⁰ Asnjë krijesë, qoftë e lindur në tokë apo midis zotave në qiell, nuk është e lirë nga ndikimi i tri gunave. ⁴¹ Përgjegjësitë e ndryshme që gjenden në rendin shoqëror – brahminët dallues, kshatrija-t, vaishia-t dhe shudra-t – i kanë rrënjët në këtë ndikim.

⁴² Përgjegjësitë për të cilat janë lindur brahminët, bazuar në natyrën e tyre, janë vetë-kontrolli, qetësia, pastërtia e zemrës, durimi, përulësia, të mësuarit, kursimi, urtia dhe besimi.

⁴³ Cilësitë e kshatrija-ve, bazuar në natyrën e tyre, janë guximi, forca, vendosmëria e guximshme, shkathtësia, bujaria, lidershipi dhe vendosmëria e fortë për të mos u tërhequr kurrë nga beteja. ⁴⁴ Profesionet e përshtatshme për një vaishia janë bujqësia, prodhimi i qumështit dhe tregtia. Puna e duhur e një shudra-je është shërbimi.

⁴⁵ Me përkushtim ndaj detyrës së tij të veçantë, secili mund ta arrijë përsosmërinë. Më lejo të të tregoj se si. ⁴⁶ Duke e kryer punën e vet, njeriu e adhuron Krijuesin që rri në çdo krijesë. Adhurimi i tillë e sjell atë person në përmbushje.

⁴⁷ Njeriu është më mirë t'i kryejë detyrat e veta në mënyrë të papërsosur sesa t'i zotërojë detyrat e tjetrit. Duke i përmbushur obligimet me të cilat ka lindur, një personi nuk i ndodh kurrë që befas të dështojë. ⁴⁸ Askush nuk duhet t'i braktisë detyrat sepse sheh defekte në to. Çdo veprim, çdo aktivitet, është i rrethuar me defekte siç është zjarri i rrethuar nga tymi.

⁴⁹ Ai që është i lirë nga lidhshmëritë vetjake, që e ka zotëruar veten dhe pasionet e tij, e arrin përsosmërinë supreme të lirisë nga veprimi. ⁵⁰ Dëgjo dhe do ta shpjegoj tani, Arxhuna, se si ai që e ka arritur përsosmërinë, e arrin edhe Brahmanin, përsosjen supreme të urtisë.

⁵¹ I pagabueshëm në aftësi dalluese, sovran i shqisave dhe i pasioneve, i lirë nga zhurma e pëlqimeve dhe mospëlqimeve, ⁵² një i tillë bën jetë të thjeshtë, të mbështetur në veten të bazuar në meditim, duke e kontrolluar të folurit, trupin dhe mendjen.

⁵³ Të lirë nga vetë-vullneti, agresiviteti, arroganca, zemërimi dhe epshi për të zotëruar njerëz apo gjëra, ata janë në paqe me veten dhe me të tjerët dhe hyjnë në gjendjen unitive. ⁵⁴ Të bashkuar me Brahmanin, gjithmonë të gëzuar, përtej shtrirjes zgjatëse të merakut e të pikëllimit, kanë respekt të barabartë për çdo krijesë të gjallë dhe arrijnë përkushtim suprem ndaj meje. ⁵⁵ Duke më dashur gradualisht ma njohin lavdinë dhe hyjnë në qenien time të pakufishme. ⁵⁶ Të gjitha veprimet e tyre kryhen në shërbimin tim, dhe përmes hirësisë sime ata e fitojnë jetën e përhershme.

⁵⁷ Bëje çdo vepër – ofertë flijuese për mua; më konsidero si mbrojtësin tënd të vetëm. Duke u mbështetur në disiplinën e brendshme, medito për mua gjithmonë. ⁵⁸ Duke më kujtuar, do t'i kapërcesh të gjitha vështirësitë përmes hirësisë sime. Por nëse nuk do të jesh i vëmendshëm për mua në vetë-vullnetin tënd, asgjë nuk do të të bëjë dobi.

⁵⁹ Nëse thua në mënyrë egotiste: “Nuk do ta luftoj këtë betejë”, vendosmëria jote do të jetë e kotë; natyra jote do të të shtyjë në të. ⁶⁰ Vetë karma jote, e lindur në natyrën tënde, do të të shtyjë ta bësh madje edhe atë që nuk dëshiron ta bësh, për shkak të deluzionit tënd.

⁶¹ Zotëruesi rri në zemrat e të gjitha krijesave dhe i rrotullon rreth rrotës së maiës. ⁶² Vrapo tek ai për strehim me gjithë forcën tënde dhe paqja e thellë do të jetë e jotja përmes hirësisë së tij.

⁶³ Unë t'i jap këto fjalë të çmuara të urtisë; reflekto mbi to dhe pastaj bëj si të duash. ⁶⁴ Këto janë fjalët e fundit që do të t'i them, i dashur, për përmbushjen tënde shpirtërore. Je shumë i dashur për mua.

⁶⁵ Ji i vetëdijshtëm për mua gjithmonë, më admiro, bëje çdo vepër – ofertë flijuese për mua, dhe do të vish tek unë; këtë ta premtoj; se je shumë i dashur për mua.

⁶⁶ Hiq dorë nga të gjithë mbështetësit dhe shpreso në mua për mbrojtje. Do të të pastroj nga mëkatet e të shkuarës; mos u pikëll.

⁶⁷ Mos e ndaj këtë urti me askë që i mungon përkushtimi apo vetë-kontrolli, i mungon merakut për të mësuar apo tallet me mua. ⁶⁸ Ata që ua mësojnë këtë mister suprem të Gitës – të gjithë atyre që më duan – e bëjnë veprën më të madhe të dashurisë; ata do të vijnë tek unë pa dyshim. ⁶⁹ Askush nuk mund të më bëjë shërbim më të përkushtuar; askush në tokë nuk mund të jetë më i dashur për mua.

⁷⁰ Ata që meditojnë mbi këto fjalë të shenjta më adhurojnë me urti e përkushtim.

⁷¹ Madje edhe ata që i dëgjojnë ata me besim, të lirë nga dyshimet, do ta gjejnë një botë më të lumtur ku rrinë njerëzit e mirë.

⁷² A ke dëgjuar me vëmendje? A je tash i lirë nga dyshimet dhe hutimet e tua?

A R X H U N A

⁷³ M'i ke davaritur dyshimet dhe deluzionet, dhe kuptoj përmes hirësisë tënde. Besimi im është i fortë tani, dhe do ta bëj vullnetin tënd.

S A N X H A J A

⁷⁴ Ky është dialogu që e dëgjova ndërmjet Krishnës, djalit të Vasudevës, dhe Arxhunës, djalit zemër-madh të Prithës. Çudia e dialogut m'i ngrit flokët përpyetë! ⁷⁵ Përmes hirësisë së Viasës, e kam dëgjuar fshehtësinë supreme të bashkimit shpirtëror drejtpërdrejt nga Zotëruesi i Jogës, vetë Krishna.

⁷⁶ Kurdo që i kujtoj këto fjalë të mrekullueshme e të shenjta ndërmjet Krishnës e Arxhunës, mbushem gëzim. ⁷⁷ Dhe kur e kujtoj formën e Krishnës që të lë pa frymë, mbushem me mahnitje dhe më vërshton gëzimi.

⁷⁸ Kudo që të jenë Krishna hyjnor dhe Arxhuna i fuqishëm, do të ketë mbarësi, fitore, lumturi dhe vlerësim të shëndoshë të rrethanave. Për këtë jam i sigurt!

Parathënia dhe hyrjet e kapitujve

Në këtë rrugë, përpjekja kurrë nuk shkon kot, dhe nuk ka dështim.

Qoftë edhe pak përpjekje drejt vetëdijes shpirtërore

do të të mbrojë nga frika më e madhe. (2:40)

...BHAGAVAD GITA NA E JEP një hartë dhe një libër udhëzues. Ajo e jep një përmbledhje sistematike të territorit, i tregon qasjet e ndryshme kah maja^a me përfitimet dhe kurthet e tyre, ofron rekomandime, na tregon çka të paketojmë dhe çka të lëmë prapa. Më shumë se secili nga të tjerët (Upanishadet dhe Dhammapada), ta jep ndjesinë e udhërrëfyesit personal. Ajo i bën pyetjet që do të mund t'i bënit ju apo unë dhe u përgjigjet atyre – pyetje jo për filozofinë apo misticizmin, por për atë se si të jetosh në mënyrë efektive në një botë të sfidave dhe të ndryshimit. Nga këto trija, është Gita ajo që ka qenë udhërrëfyesim im personal, siç ishte edhe i Mahatma Gandhit. (...)

^a Kulmi, jo maia, në këtë rast (shënim i shqipëruarit)

Hyrje

PAVARËSISHT NGA ORIGJINA E SAJ, në pjesën e hershme të mijëvjeçarit të parë PES i gjejmë të formuluar qartë edhe metodat edhe zbulimet e Brahmavidja-s. Me këtë mjet introspektiv^a *rishi-t* e frymëzuar (fjalë për fjalë “parashikuesit e të ardhmes”) e Indisë së lashtë e analizuan vetëdijen e tyre për përjetimin njerëzor për të parë se a ka diçka në të që ishte absolute. Gjetjet e tyre mund të përmblihen në tri formulime që Aldous Huxley, duke e vijuar Leibnitz-in, i ka quajtur Filozofia e Përhershme sepse ato shfaqen në çdo epokë dhe qytetërim: (1) është një realitet i pafund, i pandryshueshëm nën botën e ndryshimit; (2) i njëjti realitet rri në thelbin e çdo personaliteti njerëzor; (3) destinimi i jetës është të zbulohet ky realitet me përjetim: domethënë, ta kuptosh intuitivisht Zotin sa je këtu në tokë. Këto parime dhe eksperimentet e brendshme për kuptimin intuitiv të tyre mësoheshin sistematikisht në “akademite pyjore” apo ashramet – traditë që vazhdon e pandërprerë edhe pas rreth tre mijë vitesh.

(...)

Për ata që e marrin këtë mjedis dramatik si pjesë të udhëzimit shpirtëror dhe ngatërrohen në çështjen se Gita e justifikon luftën, Gandhi kishte përgjigje praktike: veç bazojeni jetën tuaj në Gitën sinqerisht dhe sistematikisht dhe shihni a mund t’ju duket vrasja apo madje lëndimi i të tjerëve në përputhje me mësimet e saj. (Ai e deklaroi të njëjtën për Predikimin në Mal.) Vetë zemra e mesazhit të Gitës është ta shohësh Zotëruenin në çdo krijesë dhe të veprosh përkatësisht, dhe shkrimi i shenjtë është plot vargje për ta qartësuar se çka domethënë kjo:

Unë jam gjithmonë prezent për ata që më kanë kuptuar intuitivisht në çdo krijesë. Duke e parë tërë jetën si manifestimin tim, ata nuk janë kurrë të ndarë nga unë. Më adhurojnë në zemrat e të gjithëve, dhe të gjitha veprimet e tyre rrjedhin nga unë. Kudo të mund të jetojnë, rrijnë në mua. (6:30–31).

Kur një person reagon ndaj gëzimeve dhe hidhërimeve të të tjerëve si të ishin të tijat, ai e ka arritur gjendjen më të lartë të bashkimit shpirtëror. (6:32)

Atë e dua që është i paaftë për keqdashje, që është miqësor dhe dashamirës e i dhembshur. (12:13)

^a vetë-shqyrtues i ndjenjave, mendimeve apo ideve

Veç ata shohin vërtet, ata që e shohin Zotëruesin njëjtë në çdo krijesë, që e shohin të pavdekshmen në zemrat e tërë atyre që vdesin. Duke e parë Zotëruesin e njëjtë kudo, nuk e dëmtojnë veten apo të tjerët. Kështu e arrijnë qëllimin suprem. (13: 27–28)

Studiuesit mund ta debatojnë këtë pikë përgjithmonë, por kur Gita praktikohet, mendoj, bëhet e qartë se përpjekja për të cilën shqetësohet Gita është përpjekja për vetë-zotërim. Ishte gjenialiteti i Viasës ta marrë tërë epin e madh *Mahabharata* dhe ta shohë si metaforë të luftës së përhershme ndërmjet forcave të dritës dhe forcave të errësirës në çdo zemër njerëzore. Arxhuna dhe Krishna pra nuk janë më thjesht personazhe në një kryevepër letrare. Arxhuna bëhet Gjithkushi, duke ia bërë vetë Zotëruesit, Sri Krishnës, pyetjet e përhershme për jetën dhe vdekjen – jo si filozof, por si njeri kuintencial (mishërim i përsosur) i veprimit. E lexuar kështu, Gita nuk është dialog i jashtëm por asi i brendshëm: ndërmjet personalitetit të zakonshëm njerëzor, plot pyetje për kuptimin e jetës, dhe Vetes sonë më të thellë, që është hyjnore.

Në fakt, nuk ka asnjë mënyrë tjetër të lexohet Gita dhe të kuptohet si udhëzim shpirtëror. Po të mund ta ofroja veç një kuptim kryesor të këtij dialogu hyjnor, do të ishte të kujtonim se ai zhvillohet në thellësitë e vetëdijesisë dhe se Krishna nuk është ndonjë qenie e jashtme, njerëzore apo mbinjerëzore, por shkëndija hyjnore që rri në thelbin e personalitetit njerëzor. Kjo nuk është hamendje letrare apo filozofike; Krishna ia thotë po aq Arxhunës përsëri e përsëri: “Unë jam Vetja në zemrën e çdo krijese, Arxhuna, dhe fillimi, mesi dhe fundi i ekzistencës së tyre” (10:20).

Në formulime të tilla Gita e distilon esencën e Upanishad-eve, jo pjesë-pjesë por në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke i ofruar shkrepjet e tyre intuitive fisnike si doracak jo i filozofisë por i aktivitetit të përditshëm njerëzor – një manual i Filozofisë së Përhershme unik në historinë e botës.

Sfondi upanishadik dhe monoteizmi^a

GITA, MJAFT NATYRSHËM, E MERR PËR TË MIRËQENË se audienca e saj është e njoftuar me idetë themelore të mendimit fetar hindu, shumica e të cilit mund të gjendet në Upanishade. Po ashtu përdor ca fjalor teknik nga psikologjia joga. Tërë kjo duhet të shpjegohet në terma bashkëkohorë nëse lexuesi modern duhet ta kuptojë çka është esenciale dhe e përhershme në mesazhin e Gitës dhe të mos ngecë në terminologji të çuditshme.

Së pari, megjithatë, personi jo-hindu përballet me një pengesë të tretë: shumëllojshmëria e emrave të përdorur për aspektet e Zotit. Nga kohët më të hershme, hinduizmi e ka shpallur një Zot duke e përshtatur adhurimin e tij (apo të saj, se për miliona Zoti është Nëna Hyjnore) në shumë emra të ndryshëm. “E vërteta është një”, thotë një varg i famshëm i Rig Vedës; “njerëzit e quajnë me emra të ndryshëm.” Të përkushtuarit murgërorë mund të zbulojnë se Shiva e mishëron shkëputjen e rreptë që e kërkojnë; të përkushtuarit që duan të jetojnë “në botë”, duke marrë pjesë në kënaqësitë e saj të pafajshme, mund ta zbulojnë te Krishna mishërimin e përsosur të idealeve të tyre. Në çdo rast, kjo veshje e Të Pafundmes në formë njerëzore shërben për ta fokusuar dashurinë e një të përkushtuari dhe për ta ofruar një ideal frymëzues. Por çfarëdo forme që adhurohet, është veç një aspekt i të njëjtit Zot që është një.

Në Gita – në fakt, praktikisht kudo në mitin dhe shkrimin e shenjtë hindu – i hasim edhe “zotat” në shumës. Këto janë *deva-t*, hyjni që duket të kenë ardhur me Arjanët dhe që kanë homologë që mund të njihen në kultura të tjera të ndikuara nga Arjanët: Indra, zoti i luftës dhe i stuhisë; Varuna, zoti i ujërave dhe mbikëqyrës moral; Agni, zoti i zjarrit, ndërmjetësuesi i ngjashëm me Hermesin ndërmjet qiellit dhe tokës; e kështu me radhë. Gita u referohet deva-ve si asi që adhurohen nga ata që duan t’i marrin me të mirë fuqitë natyrore dhe të mbinatyrshme, pakashumë në mënyrën e njëjtë që adhuroheshin para-ardhësit. Në terma moderne, ato mund të kuptohen më së miri se i personifikojnë forcat e natyrës.

(...)

Edhe gjersa India e lashtë po bënte përparime në shkencat natyrore dhe matematikë, urtakët e Upanishadeve po ktheheshin përbrenda për t’i analizuar shënimet që natyra ia paraqet mendjes. Duke depërduar nën shqisat, e gjetën jo një botë të objekteve të ngurta e të veçuara por një proces të pandërprerë të

^a Në origjinal është veç titulli “Sfondi upanishadik” (shënim i shqipëruarit)

ndryshimit – materia duke u bashkuar, tretur dhe duke u bashkuar përsëri në formë tjetër. Mirëpo, nën këtë fluks të gjërave me “emër dhe formë”, gjetën diçka të pandryshueshme: një realitet të pafund, të pandashëm në të cilin përputhen shënimet kalimtare të botës. Ata e quajten këtë realitet Brahman: Esenca e Zotit, baza hyjnore e ekzistencës.

(...)

E kam përshkruar zbulimin e Atman-it dhe Brahman-it – Zoti i kudondodhur dhe Zoti transcendent – si të ndarë, por nuk ka dallim real. Në kulmin e meditimit, urtakët e zbuluan unitetin: i njëjti realitet i pandashëm përjashta dhe prëbrenda. Ishte *advaita*, “jo dy”. Upanishadja Çandogia e thotë epigramatikisht (në mënyrë të shkurtër, të mprehtë e të zgjuar), *Tat tvam asi*: “Ti je Ajo”. Atmani është Brahmani: Vetja në secilin person nuk është e ndryshme nga Esenca e Zotit.

As nuk është e ndryshme nga personi në person. Ajo Vetja është një, e njëjta në secilën krijesë. Ky nuk është njëfarë parimi i veçantë i shkrimeve të shenjta hindu; është dëshmia e secilit që ka kaluar nëpër këto eksperimente në thellësitë e vetëdijesisë dhe i ka ndjekur deri në fund. Ja Ruysbroeck, mistik i madh i Evropës mesjetare; çdo fjalë është zgjedhur me kujdesin më të madh:

Reprezentimi i Zotit gjendet esencialisht dhe personalisht në tërë njerëzimin. Secili e posedon atë të tërë, të plotë dhe të pandarë, dhe të gjithë bashkë jo më shumë se një i vetëm. Në këtë mënyrë jemi të gjithë një, në mënyrë intime të bashkuar në reprezentimin tonë të jashtëm, që është reprezentimi i Zotit dhe burimi në ne i tërë jetës sonë. (...)

Filozofia Sankhia i parashtron dy kategori të veçanta: *Purusha*, shpirti, dhe *prakriti*, gjithçka tjetër. Ky nuk është dallimi perëndimor mendje-materie. Prakriti është fusha e asaj që mund të njihet objektivisht, fusha e fenomeneve (dukurive), bota e çkadoqoftë që ka “emër dhe formë”: domethënë, jo veç e materies dhe e energjisë por edhe e mendjes. Siç e postulon fizika një fushë të bashkuar nga e cila mund të rrjedhin të gjitha fenomenet, Sankhia e përshkruan një fushë që i përfshin edhe fenomenet mendore. Mendja, energjia dhe materia të gjitha i përkasin një fushe të forcave. *Purusha*, shpirti i pastër, është njohësi i kësaj fushe të fenomeneve, dhe i përket një rendi krejt tjetër të realitetit. Veç *Purusha* është e vetëdijshme, apo, më mirë, *Purusha* është vetë vetëdijesia. Ajo që e quajmë “mendje” është veç instrument i brendshëm që e përdor *Purusha*, siç është trupi instrumenti i saj i jashtëm. Për qëllime praktike – të paktën për sa i

përket Gitës – *Purusha* mund të konsiderohet si sinonim për *Atman*. *Purusha* është Vetja, përtej tërë ndryshimit, e njëjta në secilën krijesë.

(...)

Sankhia e përshkruan prakritin si fushë të forcave të quajtura *guna-t* – koncept që tërheq goxha vëmendje në Gitë. (...)

Çdo gjendje e materies dhe e mendjes është kombinim i këtyre trive: *tamas*, amullia, *raxhas*, aktiviteti, dhe *sattva*, harmonia apo ekuilibri. Këto janë veç përkthime të përafërta, se *gunat* nuk kanë ekuivalent në asnjë filozofi tjetër që e njoh.

Gunat mund të ilustrohen duke i krahasuar me tri gjendjet e materies në fizikën klasike: e ngurtë, e lëngët dhe e gaztë. *Tamas* është energji e ngrirë, rezistenca e amullisë. Një bllok i akullit ka goxha energji në lidhjet kimike që e mbajnë bashkë, por energjia është e mbyllur, e lidhur, e ngurtë. Kur akulli shkrihet, një pjesë e asaj energjie çlirohet siç rrjedh uji; *raxhas*, aktiviteti, është si lumë i fryrë, plot fuqi të pakontrolluar. Dhe *sattva*, harmonia, mund të krahasohet me avullin kur shfrytëzohet fuqia e tij. Këto janë paralele shumë joprecize, por e përcjellin një poentë të rëndësishme për *gunat*: të trijat janë gjendje të energjisë, dhe secila mund të shndërrohet në të tjerat.

Esenca e Gitës

GITA NUK PARAQET SISTEM TË FILOZOFISË. Ajo i ofron diçka secilit që e kërkon Zotin, çfarëdo temperamenti pastë ai njeri, nëpër cilëndo rrugë. Arsyeja për këtë cilësi universale tërheqëse është se ajo në thelb është praktike: është doracak për Kuptimin Intuitiv të Vetes dhe udhëzues për veprim.

Disa studiuesve, praktikiteti do t'u duket pretendim i madh, sepse Gita është e mbushur plot me filozofi shumë të lartë dhe madje të vështirë për t'u kuptuar. E prapë madje as filozofia e vet nuk është aty për ta kënaqur kureshtjen intelektuale; ajo është menduar të jetë aty për t'ua shpjeguar aspirantëve shpirtërorë pse kërkohet nga ta t'u nënshtrohen disiplinave të caktuara. Si çdo doracak, Gita ka më së shumti kuptim kur praktikohet.

Siç e shprehin titujt tradicionalë të kapitujve, Gita është *brahmanvidyayam yogashastra*, libër mësimor mbi shkencën supreme të jogës. Por *joga* (*yoga*) është fjalë me shumë kuptime – po aq, mbase, sa ka rrugë për te Kuptimi Intuitiv i Vetes. Çfarë lloji të jogës na e mëson Gita?

Përgjigja e zakonshme është se ajo i paraqet tri joga apo madje katër – katër rrugët kryesore të misticizmit Hindu. Në *xhnana joga (jnana yoga)*, joga e njohjes, aspirantët e përdorin vullnetin dhe aftësinë për të gjykuar se çka është e mirë – për t'a ç-identifikuar veten nga trupi, mendja dhe shqisat deri kur ta dinë se nuk janë asgjë pos Vetes. Ndjekësit e *bhakti jogës (bhakti yoga)*, jogës së përkushtimit, e arrijnë qëllimin e njëjtë duke e identifikuar veten plotësisht me Zotëruesin në dashuri; përgjithësisht, kjo është rruga e ndërmarrë nga shumica e mistikëve të Krishterimit, Hebraizmit dhe Islamit. Në *karma joga (karma yoga)*, joga e veprimit pa-veten, aspirantët e tresin identifikimin e vet me trupin dhe mendjen duke u identifikuar me tërësinë e jetës, duke e harruar veten e fundme në shërbim të të tjerëve. Dhe ndjekësit e *raxha jogës (raja yoga)*, jogës së meditimit, e disiplinojnë mendjen dhe shqisat deri kur procesi-i-mendjes ndërpritet në një prehje shëruese dhe ata shkrihen në Vetën.

Indianëve u pëlqen të klasifikojnë, dhe tetëmbëdhjetë kapitujt e Gitës thuhet të ndahen në tri pjesë gjashtë-kapitullore. E treta e parë, sipas kësaj, merret me karma joga, e dyta me xhnana joga, dhe e fundit me bhakti joga: domethënë, Gita nis me rrugën e veprimit pa-veten, kalon në rrugën e njohjes-së-Vetes, dhe mbaron me rrugën e dashurisë. Kjo skemë nuk është e ngurtë, dhe lexuesve jo-Hindu mund t'u duket vështirë ta zbulojnë atë në tekst. Por temat janë aty, dhe Krishna qartë e zhvendos theksin e vet gjersa vijon duke e përdorur këtë fjalën *joga*. Këtu ai fokusohet në njohjen transcendentale, tejshkuese; atje në veprimin pa-veten, këtu në meditim, atje në dashuri

Kështu Gita ofron diçka për çdo lloj të aspirantit shpirtëror, dhe për dy mijë vite secila nga shkollat madhore të Filozofisë indiane e ka cituar Gitën në mbrojtje të pretendimeve të veta të veçanta. Ky fluiditet (mundësi për ndryshim, jongurtësi) nganjëherë i acaroi studiuesit, që ndihen se Gita bie në kundërshtim me veten. Ajo e çudiste edhe Arxhunën (Arjuna), përfaqësuesin besnik për ty dhe për mua. “Krishna”, thotë ai në fillim të kapitullit 3, “po më thojë se njohja [xhnana] është më e mirë se veprimi [karma]; pra pse më nxit në veprim kaq të tmerrshëm? Fjalët e tua janë jokonsistente; ato më hutojnë. Ma trego atë rrugën e vetme për tek e mira më e lartë” (3:1-2). Pa dyshim ai flet për secilin lexues në këtë pikë, dhe për ata që vijojnë tutje duke e dashur vetëm një rrugë, hutia thjesht përkeqësohet.

Për ata që provojnë ta praktikojnë Gitën, megjithatë, ka një fije të konsistencës së brendshme që kalon nëpër këshillat e Krishna-s. Si një person që ec përreth objektit të njëjtë, Gita e merr më shumë se një pikë-pamje. Kurdo që Krishna e përshkruan një nga rrugët tradicionale për te Zoti ai e shikon atë rrugë nga brenda, duke i lartësuar virtytet e saj mbi të tjerat. Për momentin, kjo është *ajo*

rruga; kur ai flet për joga, e nënkupton atë joga të caktuar. Kështu “kjo fjalë e lashtë” *joga*, thotë miku intim dhe sekretari i Gandit, Mahadev Desai,

nxitet nga Gita në shërbimin që ta ketë kuptimin e tërë gamës së përpjekjes njerëzore për t’ia mësyre portave të parajsës. . . . [Ajo domethënë] gërshetimi i të gjitha fuqive të trupit dhe të mendjes dhe të shpirtit me Zotin; ajo domethënë disiplinë e intelektit, e mendjes, e emocioneve, e vullnetit të cilën e nënkupton një gërshetim i tillë; ajo domethënë një hijeshi e qetë e shpirtit që ia mundëson njeriut ta shikojë jetën në të gjitha aspektet e saj dhe lëmueshëm.

Gita i bën bashkë të gjitha zotësitë e specializuara të fjalës *joga* për ta theksuar kuptimin e tyre të përbashkët: shumën e atyre që njeriu duhet t’i bëjë për ta realizuar Vetën.

Fija përmes mësimin të Krishna-s, esenca e Gitës, mund të jepet në një fjalë (dy në shqip): heqja dorë. Ky është faktori i përbashkët te katër jogat. Është fjalë e zymtë shqip, që ta sjell në mendje asketizmin (rreptësinë) dhe mohimin e dëshirave e interesave që këshillohet fort në urdhrat e murgjërve – “skamja, dëlirësia dhe bindja” e mishëruar kaq përsosmërisht nga Françesku i Asizit (Francis of Assisi). Kur Gita e premton “lirinë përmes heqjes dorë”, përshtypja që e kemi shumica nga ne është se po na kërkohet të heqim dorë nga gjithçka që duam nga jeta; në këtë gjendje të dobët, pasi të kemi humbur çkadoqoftë që çmojmë, do të jemi të lirë nga pikëllimi. Kush e do këtë lloj lirie?

Por kjo nuk është fare ajo çka nënkupton Gita. Madje nuk e këshillon fort as heqjen dorë nga materialja, edhe pse sigurisht që e inkurajon thjeshtësinë. Si gjithmonë, theksi i saj është te mendja. Ajo na mëson se mund të bëhemi të lirë duke hequr dorë jo nga gjërat materiale, por nga ngjitjet vetjake me gjërat materiale – dhe, më e rëndësishme, me njerëzit. Na kërkon të heqim dorë jo nga kënaqësia e jetës, por nga të kapurit pas kënaqësisë vetjake me çfarëdo çmimi që duhet ta paguajnë të tjerët. Ajo kërkon fuqishëm, me një fjalë, heqje dorë nga vetjakësia në mendim, në fjalë dhe në veprim – temë që është e përbashkët për të gjithë mistikët, si Perëndimorë edhe Lindorë.

Mahatma Gandhi e përmbledh mesazhin e Gitës në një frazë: *nishkama karma*, veprim pa-veten, puna e lirë nga çfarëdo motive vetjake. Në këtë kuptim të veçantë, çfarëdo rruge që po e paraqet Gita në një moment të dhënë, ajo mbetet esencialisht doracak i karma jogës, se i adresohet personit që dëshiron ta kuptojë Zotin pa hequr dorë nga një jetë aktive në botë. Në Gita katër jogat tradicionale

nuk janë ndarje të papërshtueshme, dhe në praktikë, të gjitha shkrihen dhe e përkrahin njëra-tjetrën në rrugën për te Kuptimi Intuitiv i Vetes.

Nishkama karma tekstualisht domethënë punë që është pa *kama*, domethënë pa merak vetjak. Kjo fjalë *kama* – në fakt tërë ideja e merakut në psikologjinë Hindu dhe Budiste – keqkuptohet shpesh. Këto fe, besohet nganjëherë, se e mësojnë një ideal të veprimit pa-merak, një nirvana të barazuar me zhdukjen e të gjitha merakeve. Kjo pamje e zyrtë është larg nga e vërteta. Meraku është karburanti i jetës; pa merak nuk mund të arrihet asgjë, e lëre më një arritje kaq mahnitëse si Kuptimi Intuitiv i Vetes. *Kama* nuk është merak; është merak vetjak. Buddha e quan *tanha*, “etje”: dëshira e zjarrtë, nxitëse për kënaqësi personale që kërkon të shuhet me çdo kosto, qoftë ndaj vetes apo ndaj të tjerëve. Kështu koncepti e përfshin edhe atë që mistikët Perëndimorë e quajnë vullnet-i-vetes – egoja lakuriqe që këmbëngul në marrjen e asaj që e do për kënaqësinë e vet. Gita na mëson thjesht se kjo dëshirë e zjarrtë vetjake është ajo që e bën një person të ndihet i ndarë nga pjesa tjetër e jetës. Kur ajo shuhet – kuptimi tekstual i *nirvana* – maska e egos kalimtare e të vockël bie, duke e zbuluar Vetën tonë të vërtetë.

Puno fort në botë pa ndonjë ngjitje vetjake, këshillon Gita, dhe do ta pastrosht vetëdijesinë tënde nga vullneti-i-vetes. Në këtë mënyrë çdo burrë a grua mund ta arrijë gradualisht lirinë nga skllavëria e kushtëzimit vetjak.

Kjo është disiplinë *mendore*, jo fizike, dhe dua ta përsëris se për ta kuptuar Gita-n, është me rëndësi të shikohet nën sipërfaqen e urdhëresave të saj dhe të shihet gjendja mendore e përfshirë. *Nishkarma karma* nuk është “punët e mira” apo aktiviteti filantropik; puna mund t’u bëjë mirë të tjerëve dhe prapë të bartë masë substanciale të përfshirjes së egos. Puna e tillë është e mirë, por nuk është joga. Mund t’u bëjë mirë të tjerëve, por nuk do t’i bëjë mirë bërësit patjetër. Gjithçka varet nga gjendja e mendjes. Veprimi pa motiv vetjak e pastron mendjen: bërësi ka më pak gjasa të jetë i shtyrë nga egoja më vonë. Veprimi i njëjtë i bërë me motiv vetjak e ngatërron personin tutje, pikërisht duke e forcuar atë motiv ashtu që ka më shumë gjasa që përsëri të nxisë veprim vetjak.

Në Gita kjo është thënë në shumë mënyra, dhe nga dallimet në gjuhë mund të duket se Krishna po jep këshilla të ndryshme. Mirëpo, në praktikë, bëhet e qartë se këto janë veç mënyra të ndryshme të thënies së gjësë së njëjtë.

Sa për fillim, Krishna shpesh i thotë Arxhunës të “heqë dorë nga frytet e veprimit” (*karma-phala*):

Ti ke të drejtë në punën, por kurrë në frutin e punës. Kurrë nuk duhet të angazhohesh në veprim për hir të shpërblimit, as nuk duhet ta duash fort mosveprimin. Kryeje punën në këtë botë, Arxhuna, si njeri i etabluar brenda vetes – pa ngjitje vetjake, dhe njësoj si në sukses si në disfatë. Se joga është lëmuesi e përsosur e mendjes. (2:47-28)

“Fruti”, natyrisht, domethënë rezultati. Ajo çka nënkupton Krishna është të hiqet dorë nga ngjitja me rezultatet e asaj që e bën: domethënë, ta japësh më të mirën në çdo ndërmarrje pa këmbëngulur se rezultatet funksionojnë në mënyrën që e do ti, apo madje edhe se a është e këndshme apo e pakëndshme ajo që e bën ti. “Ti e ke të drejtën për veprim, por jo për frutet e veprimit”: secili nga ne e ka obligimin të veprojmë drejt, por asnjë fuqi për ta diktuar se çka do të dalë nga ajo që e bëjmë. Mahatma Gandhi e shpjegon këtë me autoritetin e përjetimit të vet personal:

Me shkëputje nënkuptoj që nuk duhet të shqetësoheni se a rrjedh a nuk rrjedh rezultati që e keni merak nga veprimi juaj, përderisa motivi juaj është i pastër, e mjetet tuaja korrekte. Në të vërtetë, domethënë se gjërat do të bëhen si duhet në fund nëse kujdeseni për mjetet dhe të tjerat ia lini Atij.

“Por heqja dorë nga fryti”, paralajmëron Gandhi,

në asnjë mënyrë nuk nënkupton indiferencë ndaj rezultatit. Në lidhje me secilin veprim njeriu duhet ta dijë rezultatit që pritet të vijojë, mjetet për të, dhe kapacitetin për të. Ai që, duke qenë i pajisur kështu, është pa merak për rezultatit e megjithatë është plotësisht i zhytur në përmbushjen e duhur të detyrës që e ka përpara, thuhet të ketë hequr dorë nga frytet e veprimit të vet.

Ky qëndrim na çliron plotësisht. Çkado që të vijë – sukses a dështim, lavdërim a fajësim, fitore a disfatë – mund ta japim më të mirën tonë me mendje të qartë, e të patrazuar. Asgjë s’mund ta tundë guximin tonë apo ta thyejë vullnetin tonë; asnjë pengesë nuk mund të na dëshpërojë apo të na bëjë të ndihemi “të rraskapitur”. Qartë, siç thotë Gita: “Joga është shkathtësia në veprim” (2:50).

Vetëm personi që është i shkëputur krejtësisht dhe i përkushtuar krejtësisht, thotë Gandhi, është i lirë ta shijojë jetën. Kur i kërkuan ta përmbledhte jetën e vet “në njëzet e pesë fjalë apo më pak”, u përgjigj: “Mund ta bëj me tri!” (katër në shqip) dhe e citoi Upanishad-en Isha: “Hiq dorë dhe kënaqu (shijojë).” Ata që janë të ngjitur pazezistueshëm me rezultatet e veprimit nuk mund të kënaqen e ta shijojnë atë që e bëjnë; ata bëhen të lënduar shpirtërisht kur gjërat nuk funksionojnë dhe kapen më dëshpërueshëm kur funksionojnë. Kështu Gita e klasifikon karmën e ngjitjes si të këndshme në fillim, por “të hidhur si helmi në fund” (18:38), për shkak të skllavërisë së dhembshme të kushtëzimit.

Përsëri, Krishna i thotë vazhdimisht Arxhunës t’i dorëzojë gjithçka atij në dashuri. Por kjo nuk është këshillë tjetër, po thjesht fjalë të tjera. Krishna po kërkon nga Arxhuna të veprojë plotësisht për hir të Tij, jo për ndonjë fitim personal. E tërë poenta e rrugës së dashurisë është të shndërrohet motivimi nga “unë, unë, unë” në “ti, ti, ti” – domethënë të dorëzohen ngjitjet vetjake duke i tretur në merakun për të dhënë.

Krishna e formulon këtë më së bukuri në vargjet e famshme të Kapitullit 9 që nisin: “Çkado që bën, ma bëj dhuratë mua” (9:27). Bëje, domethënë, jo për shpërblim personal por nga dashuria për Zotëruesin, prezent në çdo krijesë. “Çkado që ha, çfarëdo adhurimi që bën, çkado që jep, çkado që vuan”: gjithçka të bëhet e të jepet e të durohet e të shijohet për hir të Zotëruesit në krejt, jo për veten. *Manmana*: ky është refreni i Gitës. Krishna i thotë vazhdimisht Arxhunës: “Mbushe mendjen me mua, fokusoje çdo mendim në mua, mendo për mua gjithmonë”; pastaj “do të jesh i bashkuar me mua” (shih 9:34). E njëjta urdhëresë iu dha Musait (Moisiut) dhe u përsërit nga Jezusi (Isai) dhe Muhamedi. Në terma praktikë, domethënë se vetëdijesia do të integrohet teposhtë deri në skutat më të thella të pavetëdijes, që është pikërisht rëndësia e fjalës *joga*.

Meister Eckhart për këtë gjendje thotë me elokuencë:

Kushdo që e ka Zotin në mendje, thjesht dhe veç Zotin, në të gjitha gjërat, një njeri i tillë e bart Zotin me vete në të gjitha punët e veprat e veta dhe në të gjitha vendet, dhe Zoti i vetëm i bën krejt punët e tij. Ai nuk kërkon asgjë pos Zotit; asgjë s’i duket e mirë pos Zotit. Ai bëhet një me Zotin në çdo mendim. Siç nuk mund ta tretë Zotin asnjë shumë-pjesë-sí, asgjë nuk mund ta tretë këtë njeri apo ta bëjë shumë-pjesësh.

Kështu arrijmë tek ideja e “veprimit të paveprim”: e personave kaq të etabluar në identifikimin me Vetën sa që mu në mes të shërbimit të palodhje për ata përreth vetes, mbesin në paqe të brendshme, ajo që në qetësi e dëshmon veprimin. Ata nuk veprojnë, thotë Gita; është Vetja që vepron përmes tyre: “Veç ata që e shohin se të gjitha veprimet kryhen nga prakriti, gjersa Vetja mbetet e palëvizur - veç ata shohin vërtet” (13:29). Përsëri, kjo është deklaratë universale. Ja një nga më aktivet prej mistikëve, Shën Katerina nga Xhenova (St. Catherine of Genoa):

Kur fryma (shpirti) bëhet asgjë dhe shndërrohet, pastaj ajo nga vetja as s’punon as s’flet as s’dëshiron, as s’ndien as s’dëgjon as s’kupton; as s’ka për veten ndjenjë të jashtësisë a të brendësisë, ku mund të lëvizë. Dhe në të gjitha gjërat është Zoti që e sundon dhe e udhëzon, pa ndërmjetësimin e asnjë krijese. Dhe gjendja e kësaj fryme është pastaj ndjenjë e një paqeje e qetësie kaq të krejtësishtme sa që asaj i duket se zemra e vet, dhe qenia e vet trupore, dhe krejt edhe përbrenda edhe përjashtë, janë zhytur në një oqean të paqes së krejtësishtme... Dhe ajo është kaq plot me paqe sa që edhe pse ajo e shtyp mishin e vet, nervat e veta, eshtrat e vet, asnjë gjë nuk del nga to veç paqe.

Përsëri, kur Gita flet për “mosveprimin mu në mes të veprimit” (4:18, etj.), e thërassim Ruysbroek-un të hedhë dritë mbi këtë që duket si paradoks. Personi që e ka kuptuar-realizuar Zotin, thotë ai, i pasqyron të dy aspektet e Tij: “qetësinë sipas esencës së Tij, aktivitetin sipas natyrës së Tij: prehje absolute, pjellori [produktivitet] absolut[e]”. Dhe pastaj shton:

Personi i brendshëm e jeton jetën e vet sipas këtyre dy rrugëve: domethënë pra, në pushim dhe në punë. Dhe në secilën nga to ai është plotësisht dhe pandashëm; se ai rron plotësisht në Zotin në saje të arritjes së qetë të merakeve dhe plotësisht në vete në saje të dashurisë së vet aktive. . . . Kjo është maja^a supreme e jetës së brendshme.

^a Kulmi, jo maia, në këtë rast (shënim i shqipëruarit)

Ky është lloji i vetëm i joveprimit që e rekomandon Gita. Është veprimi i llojit më të palodhshëm; e vetmja gjë joaktive është ego. Të jetosh pa flijimin ditor (*jaxhna* [*yajna*]) të shërbimit pa-veten – të punosh veç për veten, apo edhe më keq, të mos bësh asgjë – është thjesht të jesh hajdut (3:12). Nuk është e mundur të mos bësh asgjë, thotë Krishna; pikërisht vetë natyra e mendjes është aktiviteti i pandërprerë. Qëllimi i Gitës është të shfrytëzohet ky aktivitet në shërbim pa-veten, duke e hequr zotësinë helmuese të egos: “Përderisa njeriu ka trup, nuk mund të heqë dorë krejtësisht nga veprimi. Heqja dorë e vërtetë është ta heqësh dorë krejtësisht nga merakuri për shpërblim personal” (18:11). Meister Eckhart shpjegon:

Për të pasur të drejtë, një person duhet t’i bëjë një nga dy gjërat: ose duhet të mësojë ta ketë Zotin në punën e vet dhe aty të mbahet fort për të, ose duhet të heqë dorë krejtësisht nga puna e vet. Meqë, megjithatë, njeriu nuk mund të jetojë pa aktivitete që janë edhe njerëzore edhe të ndryshme, duhet të mësojmë ta mbajmë Zotin në gjithçka që bëjmë, dhe çfarëdoqoftë puna a vendi, të vazhdojmë me të, duke mos lejuar të na pengojë asgjë.

Do të ishte vështirë të gjendet përmbledhje më e mirë e mesazhit të Gitës kudoqoftë – dhe kjo, meqë ra fjala, nga dikush që konsiderohet ta përfaqësojë rrugën e njohjes.

Krishna e përmyll krejt këtë në një varg të famshëm: “Braktisi të gjitha mbështetjet dhe më kërko mua për mbrojtje. Unë do të të pastroj nga mëkatet e së shkuarës; mos u pikëllo” (18:66). Krishna është Vetja; fjalët e kanë kuptimin thjesht të hidhen mënjanë rekuizitat dhe varësitë e jashtme dhe të mbështetemi veç në Vetën, duke mos kërkuar fuqi askund pos përbrenda.

Pse veprimi pa-veten çon në Kuptimin Intuitiv të Vetes? Nuk është çështje e veprimit “të mirë” që po shpërblehet hyjnisht. Realizimi-i-Vetes nuk është ndonjëfarë kompensimi për veprat e mira. Ne mund t’i kuptojmë dinamikat nëse e kujtojmë se theksi i Gitës është te mendja. Shumica e aktivitetit njerëzor, edhe i miri edhe i keqi, njolloset nga përfshirja e egos. Aktiviteti i tillë nuk mund ta pastrojë vetëdijesinë, sepse vazhdon të prodhojë karmë të re në mendje – në terma praktikë, vazhdojmë të ngatërrohemi në atë që e bëjmë. Puna pa-veten e pastron vetëdijesinë sepse kur nuk ka gjurmë të përfshirjes së egos, nuk prodhohet karmë e re; mendja thjesht po e përpunon karmë që tashmë e ka grumbulluar.

Shankara e ilustron këtë me ngjashmërinë me rrotën e poçarit. Puna e egos është të vazhdojë pandërprerë ta rrotullojë rrotën e mendjes dhe të bëjë vazo karmike: ide të reja për të vepruar, merake të reja për t'i ndjekur. Kur ndalet ky aktivitet i pakuptimtë, nuk bëhen më vazo, por për ca kohë rrota e mendjes vazhdon të rrotullohet nga vrulli i karmës së vet të shkuar. Kjo është periudhë ankthi në jetën e secilit mistik: ke bërë gjithçka që mundesh; tash veç mund të pritësh me njëfarë durimi të paduruar. Dikur, për asnjë arsye që mund ta kuptojë njeriu, rrota vjen deri te ndalja, duke e tretur procesin mendor në samadhi.

Një imazh më i lartë

MBASE MËNYRA MË E QARTË për ta kuptuar intuitivisht Gitën është të shikohet mënyra se si i përshkruan ajo – ata që i mishërojnë mësimet e saj. Portrete të tilla ka në fillim të Gitës, në mes, dhe në fund, ku secili e ofron një model të potencialit tonë të plotë njerëzor.

I pari është dhënë në fund të kaptinës 2 (2:54-72), vargje të cilat Gandhi tha se e përmbajnë çelësin e tërë Gitës. Arxhunës sapo i është treguar për njohjen-e-Vetes; tani ai e bën një pyetje shumë praktike: kur një person e arrin këtë njohje, si shfaqet ajo? Si sillen njerëzit e tillë në jetën e përditshme? Ne e presim një listë të virtyteve. Në vend të kësaj, Krishna e shpalos një befasi: shenja më e sigurt është se ata i kanë dëbuar të gjitha meraket vetjake. Shqisat dhe mendja e tyre janë stërvitur plotësisht, ashtu që janë të lira nga dëshirat shqisore dhe vullneti-i-vetes. Të identifikuar plotësisht me Vetën, jo me trupin a mendjen, ata e realizojnë pavdekësinë e vet këtu në tokë.

Implikimet e kësaj nuk përcaktohen; ato duhet t'i shohim në një person të gjallë. G. K. Chesterton tha njëherë se për ta kuptuar Predikimin në Mal, nuk duhet ta shikojmë Krishtin por Shën Françeskun (St. Francis). Për ta kuptuar Gitën shkova ta shikoj Mahatma Gandhi-n, që e kishte bërë më të mirën që kish mundur për dyzet vite për t'i përkthyer ato vargje në jetën e vet të përditshme. Duke e parë atë, e kuptova se ata “që e shohin veten në të tërën dhe të tërën në ta” thjesht nuk do të ishin në gjendje t'i dëmtonin të tjerët. Augustini e thotë me guxim: “Duaj, pastaj bëj si të pëlqen”: asgjë nuk do të dalë nga ti pos mirësi. E pashë edhe se çka domethënë ta shohësh trupin tënd me shkëputje: jo indiferencë, por kujdes me dhembshuri si instrument i shërbimit. E pashë çka domethënë të pushosh në vllug të veprimit intensiv. Më e rëndësishmja, e kuptova

intuitivisht një nga idetë më freskuese në misticizmin Hindu: mirësinë origjinale. Meqë Vetja është thelbi i çdo personaliteti, askush nuk ka nevojë të fitojë mirësi a dhembshuri; ato janë aty tashmë. Krejt çka nevojitet është të hiqen shprehitë vetjake që i fshehin ato.

Kapitulli 12 e jep një portret tjetër në vargjet e veta përmbyllëse (12:13-20), dhe këtu e marrim një listë frymëzuese të shenjave të atyre që e ndjekin rrugën e dashurisë:

Atë e dua – që është i paaftë për emocione negative, që është miqësor e i dhembshur. Duke jetuar përtej asaj që e arrin “unë”-i dhe “e imja” dhe përtej asaj që e arrin qejfi e dhembja; të durueshëm, të kënaqur, të vetë-kontrolluar, të qëndrueshëm në besim, që më jepen me tërë zemrën dhe mendjen e vet – me të tillë si këta bie në dashuri. (12:13-14).

Dhe përfundimisht vjen përshkrimi pasionant me të cilin mbaron Gita, kur Krishna i tregon Arxhunës se si ta njohë burrin a gruan që e ka arritur qëllimin suprem të jetës:

Ai që është i lirë nga lidhjet vetjake, që e ka zotëruar veten dhe pasionet e veta, e arrin përsosmërinë supreme të lirisë nga veprimi. Dëgjo dhe do të ta shpjegoj tani, Arxhuna, se si dikush që e ka arritur përsosmërinë – e arrin edhe Brahmanin, përmbushjen supreme të urtisë. (18:49-50)

Këto nuk janë rrugë të ndara, ideale të veçanta. Të tri fragmentet e përshkruajnë një person: vital, aktiv, të dhembshur, që mbështetet në veten në kuptimin më të lartë, se te Vetja kërkon çdo gjë dhe s’i duhet asgjë nga jeta pos shansit për të dhënë. Më shkurt, një person i tillë e di se kush është, dhe në atë dije është gjithçka.

Kjo nuk është turrje ikëse nga jeta, siç pretendohet shpesh. Është turrje *kah* jeta, duar-hapur, krahë-hapur: “duke fluturuar, duke vrapuar e duke u gëzuar”, thotë Thomas à Kempis, se “ai është i lirë dhe nuk do të jetë i lidhur”, asnjëherë i ngatërruar në dyshime-të-vetes, konflikt a lëkundje. Larg nga të qenët pa-merak – shihe Gandhin, Katerinën e Sienës (Catherine of Siena), Shën Terezën (St. Teresa), Shën Françeskun (St. Francis) – burri a gruaja që e kupton-realizon Zotëruesin ia ka nënshtruar të gjitha pasionet njerëzore – merakut mbizotërues

për të dhënë e për të dashur e për të shërbyer; dhe në atë bashkim mund ta shohim, jo zhdukjen e personalitetit, por lulëzimin e tij të plotë. Kjo është domethënia e të qenët plotësisht njerëzor; jetët tona të zakonshme të stimulit e reagimit, marrjes e shpenzimit, krahasimisht duken po aq të zbehta sa ëndrrat që na kujtohen. Ky lulëzim i shpirtit e tërheq, ma merr mendja, secilin. “Ky është gëzimi i vërtetë në jetë”, thotë Bernard Shaw:

qenia që përdoret për një qëllim të njohur nga vetja si [asi qëllimi] i fuqishëm;... të qenët forcë e Natyrës në vend se [të qenët] mpiksje vetjake e vockël e disponimeve të këqija dhe e fyerjeve që ankohet se bota nuk do ta përkushtojë veten të të bëjë të lumtur.

Në vend të “Natyrës” me *N* të madhe, natyrisht, Gita do të thoshte “instrument i Vetes”: por ky është dallimi i vetëm. Një nga veçoritë më tërheqëse të Gitës për kohët tona është se i qartëson keqkuptimet për jetën shpirtërore dhe e shfaq atë siç është: aktive, e gëzueshme, e qëllimshme, rrugë e mesme ndërmjet ekstremeve që e zbukuron jetën e përditshme.

Besimi dhe evolucioni shpirtëror

EDHE NJË KONCEPT TË FUNDIT të papërkthyeshem^a dhe pastaj do ta lë Gitën të flasë vetë për veten. Ai koncept është *shraddha*, dhe ekuivalenti i vet më i afërt anglisht është *faith* (besim, fe). Unë e kam përkthyer ashtu, por *shraddha* domethënë shumë më shumë. Tekstualisht është “ajo që është e vendosur në zemër”: të gjitha besimet që i mbajmë kaq thellësisht sa që kurrë nuk mendojmë t’i vëmë në pyetje, t’i shqyrtojmë. Është grupi, seti i vlerave, i aksiomave, i paragjykimëve dhe i para-ndikimeve të favorshme që i ngjyros perceptimet tona, e qeveris të menduarit tonë, i dikton reagimet tona dhe i formëson jetët tona, përgjithësisht pa qenë ne as të vetëdijsëm për prezencën dhe fuqinë e saj.

Kjo mund të tingëllojë filozofike, por *shraddha* nuk është abstraksion intelektual. Është pikërisht vetë substanca jonë. Gita thotë: “Një person është ajo çfarë është *shraddha* e vet” (17:3). Bibla i përdor pothuaj të njëjtat fjalë: “Siç

^a Kjo është pjesa e fundit e parathënies. Shih para kësaj pjesët “Esenca e Gitës” dhe “Një imazh më i lartë” të botuara në blogun e njëjtë si ky botim.

mendon njeriu në zemër, i tillë është”. Shraddha reflekton gjithçka që e kemi bërë vetë dhe tregon kah ajo që jemi bërë. Por nuk ka asgjë pasive në lidhje me shraddhën. Ajo është plot potencë, se e nxit veprimin, e kushtëzon sjelljen dhe e përcakton se si shohim dhe prandaj si reagojmë ndaj botës përreth nesh.

Kur Norman Cousins flet për një “sistem të besimeve” të ngjashëm me sistemin e organeve të trupit, ky është një aspekt i shraddhës; ai po i referohet fuqisë për të shëruar apo për të dëmtuar që është e qenësishme në idetë tona për veten. Një person me sëmundje serioze beson se ka për t’ia dhënë një kontribut botës dhe kështu shërohet; një tjetër beson se jeta e vet është e pavlerë dhe vdes: kjo është fuqia e shraddhës. Ngjashëm, imazhi-i-vetes është pjesë e shraddhës. Një person beson se do të ketë sukses në jetë dhe tejkalon pengesa të mëdha; një tjetër, që beson se s’mund të bëjë asgjë, mund të jetë më i talentuar dhe të përballet me më pak vështirësi por të arrijë shumë pak.

E megjithatë shraddha nuk është përcaktim brutal apo fantazi që ka shumë pak gjasa të ndodhë. Kur Shën Gjoni i Kryqit (St. John of the Cross) thotë “Ne jetojmë në atë që e duam”, ai po e shpjegon shraddhën. Kjo është bota jonë. Jetët tona janë shprehje elokvente e besimit tonë: asaj që e konsiderojmë t’ia vlejë ta kemi, ta bëjmë, ta arrijmë, të jemi. Ajo për çka përpigemi e shfaq atë që e vlerësojmë; ne e mbështesim shraddhën me kohën tonë, me energjinë tonë, me vetë jetët tona.

Kështu shraddha e përcakton fatin. Siç e formulon Buddha: “Krejt çka jemi është rezultat i asaj që e kemi menduar. Ne ndërtohem nga mendimet tona; ne formësohem nga mendimet tona.” Siç mendojmë, ashtu bëhemi. Kjo është e vërtetë jo veç për individët por edhe për shoqëritë, institucionet dhe qytetërimet, sipas ideve dominuese që i formësojnë veprimet e tyre. Besimi në teknologji, për shembull, është pjesë e shraddhës së qytetërimit bashkëkohor.

“Shraddha e drejtë”, sipas Gitës, është besimi në ligjet shpirtërore; në unitetin e jetës, në prezencën e hyjnore në çdo person, në natyrën esencialisht shpirtërore të qenies njerëzore. “Shraddha e gabuar” nuk është patjetër moralisht e gabuar, po thjesht injorante. Ajo domethënë të besohet se në jetë nuk ka më shumë se ekzistenca fizike, se qenia njerëzore është veç entitet biokimik, se lumturia mund të fitohet duke ndjekur interesa private dhe duke e injoruar pjesën tjetër të jetës. Besimet e tilla janë të papërshtatshme: ne e kemi ngjitur shraddhën tonë me besime që jeta nuk mund t’i vërtetojë. Herët a vonë ato duhet të dalë se janë false, dhe pastaj shraddha jonë ndryshon. Porsi të menduarit tonë, pra – porsi ne vetë – evoluon edhe shraddha. Qëllimi i karmës është t’i shpjegojë pasojat e shraddhës, ashtu që përmes të provuarit e të gabuarit, jetë pas jete,

shpirti individual e fiton llojin e besimit që çon në përmbushjen e qëllimit suprem të jetës. Krishna e shpjegon dinamikën:

Kur një person i përkushtohet diçkaje me besim të plotë, unë e unifikoj besimin e tij në atë gjë. Pastaj, kur besimi unifikohet plotësisht, njeriu e fiton objektin e përkushtimit. Në këtë mënyrë, çdo merak përmbushet nga unë. (7:21-22)

Ky është mbase kuptimi i brendshëm intuitiv më me dhembshuri në evolucionin njerëzor – që është shprehur ndonjëherë. Gita është e zhytur në të, por ai nuk është ekskluziv për Gitën apo për Hinduizmin. “Ju pëlqeu apo jo, e dini apo jo”, thotë Meister Eckhart, “fshehtësisht Natyra kërkon dhe gjurmon dhe përpiqet ta shpalosë e ta qesë në dritë pistën në të cilën mund të gjendet Zotëruesi.” I tërë qëllimi i çdo përjetimi, i çdo aktiviteti, i çdo zotësie, është ta kthejë qenien njerëzore përbrenda dhe ta çojë secilin nga ne prapa te burimi ynë hyjnor. Kështu çdo person që kërkon kënaqësi në botën përjashtë – qejf, fuqi, profit, prestigj – realisht po e kërkon Zotëruesin: “Siç më afrohen, ashtu i pranoj. Të gjitha shtigjet, Arxhuna, çojnë tek unë” (4:11).

Dy forca e përshkojnë jetën njerëzore, thotë Gita: shtytja përpjetë (telart) e evolucionit dhe ngrehja teposhtë e të shkuarës sonë evolucionare. Në fund të fundit, pra, Gita nuk është libër i urdhëresave por libër i zgjedhjeve. Ajo nuk e përmend mëkatin, por kryesisht flet për injorancën dhe pasojat e saj. Krishna i tregon Arxhunës për Vetën, forcat e mendjes, marrëdhëniet midis mendimit e veprimit, ligjin e karmës, dhe pastaj konkludon: “Tani, Arxhuna, reflekto për këto fjalë dhe pastaj bëj si të duash” (18:63). Përpjekja e madhe është ndërmjet dy gjysmave të natyrës njerëzore, dhe zgjedhjet parashtrohen në çdo moment. Secili që e ka pranuar këtë sfidë, ma merr mendja, do të dëshmojë se jeta nuk ofron betejë më të ashpër se sa kjo luftë përbrenda. Ne nuk kemi zgjedhje në lidhje me luftimin; ai është i integruar në natyrën njerëzore. Por e kemi zgjedhjen se në cilën anë do të luftojmë:

Duke më kujtuar mua, do t’i tejkalosh të gjitha vështirësitë përmes mirësisë sime të hijshme. Por nëse nuk ma vë veshin dhe nuk je i vëmendshëm për mua në vetë-vullnetin tënd, asgjë nuk do të të hyjë në punë. Nëse thua në mënyrë egotiste (të vetëkënaqur): “Nuk do të luftoj në këtë betejë”, vendimi yt do të jetë i padobishëm; vetë natyra jote do të të fusë në të. (18:58-59)

Prandaj, më kujto në çdo kohë dhe vazhdo të luftosh. Me zemrën dhe mendjen tënde të synuar tek unë, sigurisht që do të vish tek unë. (8:7)

Kështu Gita e vë fatin njerëzor plotësisht në duart njerëzore. Bota e saj nuk është deterministike, por as s'është shprehje e shansit të verbër: ne i formësojmë vetet tona dhe botën tonë përmes asaj që e besojmë dhe e mendojmë dhe mbi të cilën veprojmë, qoftë për mirë apo për keq. Në këtë kuptim Gita hapet jo te Kurukshetra (qyteti) po te *dharmakshetra* (vendi i shenjtë), fusha e dharmës, kur Arxhuna dhe Krishna po qëndrojnë fort për të gjithë ne.

- Eknath Easwaran

Kapitulli një: Lufta përbrenda

SRI KRISHNA E NGUSHËLLON dhe e udhëzon Princin Arxhuna gjersa ky po shkon në betejë kundër familjes dhe miqve për ta mbrojtur pretendimin e vëllait të madh për fronin e lashtë të Kuru-ve. Kështu nis shkrimi i shenjtë madhështor i quajtur Bhagavad Gita, “Kënga e Zotëruesit”. Sri Krishna është Bhagavan-i, “Zotëruesi”, mishërimi misterioz i Zotëruesit Vishnu, aspektit të Zotit që kujdeset për gjithësinë dhe e ruan nga forcat që vazhdimisht punojnë për ta shkatërruar dhe korrumpuar. Krishna është shfaqur në tokë si princ mbretëror i shtëpisë së Xhadava-ve; kështu ai e kombinon madhështinë tokësore me një fuqi të fshehur shpirtërore. Shumica e njohin veç si princ të parëndësishëm, por urtakët e kanë parë duke e zbuluar fuqinë e vet për ta shkatërruar të keqen dhe për ta mbrojtur të mirën.

Megjithatë, beteja e Bhagavad Gitës nuk është lufta e Krishnës; është e Arxhunës. Krishna është veç karrocieri dhe këshilltari i Arxhunës. I ka premtuar Arxhunës se do të jetë me të nëpër tërë sprovën, por sado që e shpreson me pasion fitoren e Arxhunës, është betuar se do të jetë joluftëtar në luftime. Pozita e karrocierit është e ulët në krahasim me statusin dhe lavdinë e luftëtarit të cilin e vozit, por Krishna e merr këtë rol modest nga dashuria për Arxhunën. Si karrocier, është në pozitë të përsosur t’i japë këshilla dhe inkurajim Arxhunës pa e shkelur premtimin e vet të mos i bashkohet luftës.

Për ta siguruar pretendimin e tyre për fronin, Arxhuna dhe vëllezërit e tij duhet ta luftojnë jo një ushtri të huaj por kushërinjtë e tyre, që e kanë mbajtur mbretërinë për shumë vite. Tragjikisht, forcat kundër tyre e përfshijnë xhaxhain e tyre, mbretin e verbër Dhritarashtra, dhe madje edhe mësuesit dhe pleqtë e nderuar që e udhëzuan Arxhunën dhe vëllezërit e tij kur ishin të rinj. Arxhuna, natyrisht, dëshiron ta fitojë fronin për vëllain e tij, që është trashëgimtari i ligjshëm i dinastisë Kuru dhe ka duruar shumë padrejtësi. Por është i tronditur që pritet t’i luftojë njerëzit e tij. Kështu, në mëngjesin që do të nisë beteja e madhe, i drejtohet Krishnës, mikut dhe këshilltarit të tij shpirtëror dhe i bën pyetje më të thella për jetën që nuk i ka bërë kurrë më parë. Bhagavad Gita është përgjigja e Krishnës.

Luftëtarët e tjerë që shfaqen diku tjetër në dramë përmenden në këtë kapitull të parë të Gitës. Për indianët këto janë figura të njohura nga e shkuara legjendare, por për shumicën e lexuesve perëndimorë do të jenë emra të panjohur dhe madje të pashqiptueshëm. Arxhuna dhe vëllezërit e tij njihen si Pandava-t, “bijtë e Pandu-së”: Xhudhishtira, Bhima, Arxhuna, Sahadeva dhe Nakula. Pala tjetër quhen Kaurava-t, “bijtë e Kuru-së”. Kjo është disi çorientuese, se të dy palët e

familjes mbretërore janë Kuru nga lindja. Por Pandava-t tani janë në pozitën që duken të jenë fraksioni disident, kështu që quhen “bijtë e Pandu-së” për t’i dalluar nga familja më e madhe.

Pandu ishte dikur mbret i mbretërisë së Hastinapurës, por u tërhoq në pyll në vetmim shpirtëror dhe vdiq i ri. Vëllai i tij i madh, Dhritarashtra, ishte i verbër që nga lindja, kështu që nuk u emërua kurrë sundimtar, por e ndau pushtetin me vëllain e tij. Kur vdiq Pandu, duhej ta kishte pasuar djali i tij i madh, Judhishtira; por meqë Judhishtira ishte veç çun, Dhritarashtra vazhdoi pas vdekjes së Pandu-së.

Mirëpo, me kalimin e kohës, lidhja e Dhritarashtrës me djalin e tij të madh, Duriোধana, gradualisht ia mori anën. Në vend se të ngritej në nivelin e paanshmërisë mbretërore dhe t’ia lejonte Judhishtirës pretendimin e tij të drejtë, mbreti i vjetër i verbër nisi të konspirojë me kërkesën e të birit për ta pasuar fronin. Në fakt, linja e trashëgimisë ishte ndërlikuar gjatë disa brezave dhe nuk ishte e paimagjinueshme që Duriোধana duhej të sundonte me radhë. Por cilësitë e jashtëzakonshme të Judhishtirës dhe korruptimi i Duriोधanës gradualisht e vendosën çështjen, të paktën nga pikëpamja morale. Për Duriोधanën, konflikti mund të zgjidhej veç në fushën e betejës.

Luftëtarët e tjerë përmenden shkurt në kapitullin 1. Dy figura veçanërisht të rëndësishme në rrëfimin Mahabharata janë Drona dhe Bhishma. Drona u lind brahmin, anëtar i kastës priftërore, por në kërkim të pasurisë e mori rrugën e luftëtarit dhe shkëlqeu në njohuritë e armëve. Ishte mësuesi, guruja, i të gjithë princave mbretërorë në rininë e tyre, si i bijve të Pandusë ashtu edhe i bijve të Dhritarashtrës. Kështu, ishte ai që ua mësoi të dy palëve aftësitë e luftës – ironi që Duriोधana gjuhë-ashpër e thekson në vargun 3:

O mësuesi im, shikoje këtë ushtri të fuqishme të Pandava-ve, të grumbulluar nga vetë dishepulli yt i talentuar, Judhishtira.

Arxhuna ishte nxënësi më i mirë i Dronës kur ishte fjala për harkun, duke e kaluar madje edhe vetë djalin e Dronës, Ashvatthamën.

Bhishma, “gjyshi” i të dy palëve, në fakt nuk është gjyshi i princave, por burrështetas më i vjetër i respektuar. Si këshilltar shumëvjeçar i Dhritarashtrës, e konsideron detyrë të tij të qëndrojë pranë mbretit të tij dhe të përpiqet ta mbrojë nga dobësitë e tij dhe vendimet e gabuara.

Një figurë tjetër e prezentuar në kapitullin 1 është Sanxhaja, që ia tregon tërë Gitën mbretit të verbër Dhritarashtra. Sanxhaja nuk është i pranishëm në fushën

e betejës, por teksti na tregon se urtaku Viasa, komponuesi i Gitës, i ka dhënë shikim hyjnor që të mund të shohë dhe të raportojë gjithçka.

Kapitulli 1 na lë fort të vetëdijshtëm se jemi në fushë të betejës, duke pritur të nisë një luftë katastrofike; por sapo Krishna e nis udhëzimin e tij, e lëmë prapa fushëbetejën dhe futemi në sferat e filozofisë dhe vizionit mistik. Kapitulli i parë është veç urë për te temat reale të Gitës, dhe prandaj nuk duhet të na vonojë tepër në studimin tonë të poemës.

E megjithatë kapitulli i parë ka shkaktuar debat të madh, kryesisht për shkak të asaj që ka për të thënë për moralitetin e luftës. Në thelb ka pasur dy pikëpamje, që janë pothuaj (por mbase jo plotësisht) të papajtueshme. Së pari, është pikëpamja ortodokse hindu se Gita e miraton në heshtje luftën për klasën e luftëtarëve: është *dharma*, detyra morale, e ushtarëve të luftojnë për një kauzë të mirë, megjithëse kurrë për udhëheqës të këqij. (Duhet shtuar se kjo është pjesë e një kodi të hollësishëm dhe shumë kalorësiak që i përshkruan rregullat e drejta të luftës.) Sipas kësaj pikëpamjeje ortodokse, mësimi i *Mahabharatës* (dhe rrjedhimisht i Gitës) është se megjithëse lufta është e keqe, është e keqe që nuk mund të shmanget – e keqe edhe tragjike edhe e nderueshme për vetë luftëtarin. Lufta për një kauzë të drejtë, e bërë drejt, është në përputhje edhe me vullnetin hyjnor. Për shkak të kësaj, në Mahabharata, Judhishtira dhe vëllezërit e tij fisnikë e gjejnë paqen e tyre në botën tjetër kur ta kenë përfunduar detyrën e tyre në tokë.

Pikëpamja e mistikëve është më subtile. Për ta beteja është alegori, përpjekje kozmike ndërmjet të mirës e të keqes. Krishna e ka zbuluar veten në tokë për ta rivendosur drejtësinë dhe po kërkon nga Arxhuna të angazhohet në përpjekje shpirtërore, jo tokësore. Sipas këtij interpretimi, Arxhunës i kërkohet ta luftojë jo farefisnin e vet po veten e tij më të ulët. Mahatma Gandhi, që e bazonte jetën e tij në Gite që nga të njëzetat e tutje, ndihej se do të ishte e pamundur ta jetosh llojin e jetës që mësohet në Gite dhe ende të përfshihesh në dhunë. Të argumentosh se Gita e miraton në heshtje dhunën, thoshte ai, domethënë t'u kushtosh rëndësi veç vargjeve të saj fillestare – parathënies, si të thuash – dhe ta shpërfillësh vetë shkrimin e shenjtë.

Për disa, ndihmon në qartësimin e kësaj pyetjeje ta shikosh Gitën si një Upanishad, deklaratë mistike nga Vedat, që u përfshi si pjesë e epikës luftarake të një epoke të mëvonshme. Kapitulli 1 i Gitës pastaj formon urë goxha të rrezikshme ndërmjet botës së luftëtarit dhe pjesës thelbësore të Gitës – shpalljeve të Sri Krishnës për të vërtetën shpirtërore.

– Diana Morrison

Kapitulli dy: Kuptimi intuitiv i Vetes

SI MËSUES SHPIRTËROR i Arxhunës, detyra e Sri Krishnës tani është ta zgjojë Arxhunën nga dëshpërimi i vet dhe ta vendosë në rrugën drejt Kuptimit intuitiv të Vetes.

Arxhuna është në thelb njeri i veprimit, i njohur për trimërinë, fisnikërinë dhe aftësinë e tij në artet e luftës – inteligjent, por jo i dhënë pas reflektimit. E megjithatë, në krizën e tij aktuale, e zbulon se jeta aktive nuk mjafton. Detyrohet t'i bëjë pyetjet e përhershme për jetën e vdekjes. A ka ai shpirt? A i mbijeton [shpirti] vdekjes? A ka realitet më të thellë sesa ai që e perceptojmë në botën rreth nesh? Nëse po, a është e mundur të njihet drejtpërdrejt, dhe (meqë Arxhuna është gjithmonë praktik) çfarë efekti ka një njohje e tillë në jetën e përditshme?

Në përgjigjen e tij, Krishna i prek pothuajse të gjitha temat dhe konceptet kryesore të Gitës. Kapitulli 2 është prandaj një lloj përmbledhje e gjashtëmbëdhjetë kapitujve vijues.

Sri Krishna fillon duke ia kujtuar Arxhunës natyrën e tij të pavdekshme: Vetja e tij reale, Atmani, nuk vdes kurrë, se nuk është lindur kurrë; është e përhershme. Pra Gita nuk na çon nga një fazë e vetëdijes shpirtërore te tjetra, por fillon me premisën vendimtare: shpirti i pavdekshëm është më i rëndësishëm se bota kalimtare.

Duke e ditur se është jashtë thellësisë së tij në këto sfera të brendshme të mendjes e shpirtit, Arxhuna i kërkon zyrtarisht Krishnës të jetë mësuesi i tij shpirtëror apo *guru*. Ky është parakusht themelor i anëtarësimit të një dishepulli në traditën hindu, ku besohet se praktikisht të gjithë kërkuesve u duhet udhëzimi i një mësuesi me përvojë. Arxhuna nuk bën përjashtim, dhe është me fat ta ketë vetë Krishnën guru. Në kuptimin alegorik, Krishna është simbol i Atmanit, Vetes më të thellë të Arxhunës.

Ky kapitull e prezenton idenë e rilindjes apo *samsarën*. Vetja e vesh trupin si veshje; kur veshja është e vjetër, hidhet mënjanë dhe vendoset një e re. Kështu shpirti, apo *khiva*, udhëton nga jeta në jetë. Siç është vdekja e sigurt për të gjallët, rilindja është e sigurt për të vdekurit. Krishna e siguron Arxhunën se natyra e tij themelore nuk është subjekt i kohës dhe i vdekjes; e megjithatë ia kujton se ai nuk mund ta kuptojë intuitivisht këtë të vërtetë nëse nuk mund të shohë përtej dualiteteve të jetës: kënaqësia dhe dhembja, sukcesi dhe dështimi, madje edhe nxehti dhe ftohti. Gita nuk e mëson një shpirtërore (spiritualitet) që synon jetë të këndshme në të përtejmen, as nuk e mëson një rrugë për ta rritur fuqinë në këtë jetë apo tjetrën. Ajo e mëson një shkëputje themelore nga kënaqësia dhe dhembja,

siç e thotë ky kapitull më shumë se një herë. Veç në këtë mënyrë një individ mund të ngritet mbi ndikimin e dualiteteve të jetës dhe të identifikohet me Atmanin, Vetën e pavdekshme.

Po ashtu, Gita nuk e mëson një përndritje të bazuar në njohje të shkrimeve të shenjta. Gjëja e rëndësishme është përjetimi i drejtpërdrejtë mistik, të cilin Krishna më vonë do ta nxisë Arxhunën ta fitojë për vetë.

Ky kapitull i përcakton përkufizimet e ndryshme të *jogës* të shpjguara në Gitë. Këtu fjala nuk i referohet pozave fizike dhe ushtrimeve (*hatha joga*) që nënkuptohen në Perëndim; ajo i referohet në radhë të parë disiplinimit të mendjes. “Joga është balansi i mendjes”: shkëputja nga dualitetet e dhembjes dhe kënaqësisë, suksesit dhe dështimit. Prandaj “joga është aftësi në veprim”, sepse ky lloj i shkëputjes kërkohet nëse personi do të veprojë në liri, në vend se thjesht të reagojë ndaj ngjarjeve i shtrënguar nga ndikimi. Krishna nuk po përpiqet ta bindë Arxhunën të bëjë lloj tjetër të jetës dhe të heqë dorë nga bota siç do të bënte një murg apo një vetmitar. Ai i thotë Arxhunës se nëse mund të mirëvendoset në jogë – në qetësi të palëkundshme, në paqe të thellë të mendjes – do të jetë më efektiv në sferën e veprimit. Gjykimi i tij do të jetë më i mirë dhe të pamurit i qartë nëse nuk ngatërrohet emocionalisht me rezultatin e asaj që e bën.

Arxhuna tani e bën pyetjen e tij të parë si student i Krishnës. Mësuesi i tij kishte folur për urtinë shpirtërore: njohjen e drejtpërdrejtë, eksperimentale të Vetes së pavdekshme. Arxhuna dëshiron ta dijë se çfarë ndryshimi bën ky lloj urtie në jetën e përditshme. Nëse një person e mirëvendos një vetëdije gjithmonë-prezente të thelbit të hyjnoritetit brenda vetes, si ndikon kjo në mënyrën si jeton? Arxhuna nuk është i interesuar në atë se çka besojnë njerëzit, por në atë si sillen në jetë.

Përgjigjja e Krishnës (2:55-72) është një nga fragmentet më të cituara në Gitë:

A R X H U N A

⁵⁴ Më trego për ata që jetojnë të mirëvendosur në urti, gjithmonë të vetëdijshëm për Vetën, O Krishna. Si flasin? Si rrinë ulur? Si lëvizin përreth?

K R I S H N A

⁵⁵ Jetojnë në urti ata që e shohin veten në të gjithë dhe të gjithë në ta, që kanë hequr dorë nga çdo merak vetjak dhe çdo ndjesi shumë e fortë e dëshirës vetjake që e torturon zemrën. ⁵⁶ As të trazuar nga pikëllimi as të etur pas kënaqësisë,

jetojnë të lirë nga epshi dhe frika dhe zemërimi. Të mirëvendosur në meditim, janë vërtet të urtë. ⁵⁷ Të paprangosur më nga të lidhurit vetjak, as nuk ngazëlleen nga fati i mirë as nuk dëshpërohen nga i keqi. Të tillë janë të thellët në shpirt.

⁵⁸ Siç i tërheq një breshkë gjymtyrët e saj, të urtët mund t'i tërheqin shqisat e tyre sipas dëshirës. ⁵⁹ Aspirantët abstenojnë nga kënaqësitë shqisore, por ende kanë dëshirë të zjarrtë për to. Këto dëshirime të gjitha zhduken kur ata e shohin qëllimin më të lartë. ⁶⁰ Edhe atyre që e ecin rrugën, shqisat e stuhishme mund t'ua marrin mendtë. ⁶¹ Jetojnë në urti ata që i nënshtrojnë shqisat e tyre dhe e mbajnë mendjen e vet gjithmonë të interesuar thellësisht në mua.

⁶² Kur vazhdon të mendosh për objektet shqisore, vjen të lidhurit. Të lidhurit e prodhon merakun, epshin e zotërimit që digjet në zemërim. ⁶³ Zemërimi e mjegullon gjykimin; më nuk mund të mësoh nga gabimet e shkuara. Humbet fuqia për të zgjedhur midis të urtës dhe të paurtës, dhe jeta jote është shpërdorim i plotë. ⁶⁴ Por kur lëviz mes botës së shqisave, i lirë si nga të lidhurit edhe nga neveria, ⁶⁵ vjen paqja në të cilën mbarojnë të gjitha pikëllimet, dhe ti jeton në urtinë e Vetes.

⁶⁶ Mendja e pabashkuar nuk është fare e urtë; si mund të meditojë? Si të jetë në paqe? Kur ti nuk njeh paqe, si mund të njohësh gëzim? ⁶⁷ Kur e lë mendjen ta ndjekë thirrjen e shqisave, ato ta largojnë gjykimin më të mirë si stuhitë që e shmangin një barkë nga drejtimi i saj i planifikuar në det.

⁶⁸ Përdore tërë fuqinë tënde për t'i çliruar shqisat si nga të lidhurit edhe nga neveria dhe jeto në urtinë e plotë të Vetes. ⁶⁹ Një urtak i tillë zgjohet ndaj dritës në natën e të gjitha krijesave. Ajo të cilën bota e quan ditë është nata e paditurisë për të urtin.

⁷⁰ Si lumenjtë që rrjedhin në oqean por nuk mund ta bëjnë oqeanin e paanë të vërshojë, ashtu derdhen rrjedhat e botës-shqisore në detin e paqes që është urtaku. Por kjo nuk është kështu me merakuesin e merakeve.

⁷¹ Janë përgjithmonë të lirë ata që heqin dorë nga të gjitha meraket vetjake dhe shkëputen nga kafazi-ego i “unë”, “mua” dhe “imja” për t’u bashkuar me Zotëruesin. ⁷² Kjo është gjendja supreme. Arrije këtë dhe kalo nga vdekja në pavdekësi.

Mahatma Gandhi thoshte se këto vargje e përmbajnë esencën e Gitës: po të humbte pjesa tjetër e shkrimit të shenjtë, veç ky fragment do të mjaftonte për ta mësuar një mënyrë të plotë të jetesës. Ata që janë të mirë-vendosur në urti (*sthita-praxhna*) jetojnë në vetëdije të vazhdueshme e të pandërprerë se nuk janë trupi që shuhet por Atmani. Për më tepër, e shohin Vetën e njëjtë në secilin, se Atmani është universalisht prezent në të gjithë.

Një i tillë, thotë Krishna, nuk identifikohet me meraket personale. Këto merake janë në sipërfaqen e personalitetit, dhe Vetja është pikërisht thelbi i tij. Burri apo gruaja që e ka kuptuar intuitivisht veten (i-e vetërealizuar) nuk motivohet nga meraket personale – me fjalë të tjera, nga asnjë merak për *kama*, kënaqësi personale. Kjo ide është mbase e huaj për mënyrat bashkëkohore të të menduarit, por themelore për Gitën – dhe, në të vërtetë, për mistikët e të gjitha traditave.

Më konkretisht, fjala *kama* i referohet çfarëdo kënaqjeje të egos apo të shqisave që na ngatërron në botën e samsarës, dhe kështu na largon nga thelbi i qenies sonë, Vetes. Ata që janë të mirëvendosur në kuptimin intuitiv të Vetes i kontrollojnë shqisat e tyre në vend se t’i lënë shqisat t’i kontrollojnë ata. Nëse shqisat nuk kontrollohen, paralajmëron Krishna, mendja (apo emocionet) do t’i ndjekin kudo që t’i çojnë [shqisat]. Përfundimisht, një person që i ndjek shqisat e humb forcën e vullnetit dhe unitetin e qëllimit; zgjedhjet e tij diktohen nga meraket e tij. Kur vullneti devijohet nga meraku për kënaqësi, mendja bëhet e hutuar dhe e shpartalluar. Në mënyrë vendimtare, paralajmëron Krishna, kjo çon në shkatërrim shpirtëror:

Kur vazhdon të mendosh për objektet shqisore, vjen të lidhurit. Të lidhurit e prodhon merakun, epshin e zotërimit që digjet në zemërim. Zemërimi e mjegullon gjykimin; më nuk mund të mësosh nga gabimet e shkuara. Humbet fuqia për të zgjedhur midis të urtës dhe të paurtës, dhe jeta jote është shpërdorim i plotë. (2:62-63)

E megjithatë Gita nuk e rekomandon asketizmin. Është më shumë çështje e stërvitjes së trupit, të mendjes dhe të shqisave.

Pikërisht në fund të kapitullit, Krishna e prezenton idenë se nuk mjafton t'i zotërosh të gjitha meraket vetjake; nevojitet edhe të nënshtrohet posesiviteti dhe egocentrizmi. Nëse mund të kalohet kjo vijë vendimtare, atëherë kërkuesi do ta njohë Vetën e vërtetë, të pavdekshme përbrenda. Ky është qëllimi suprem i mistikëve: duke e njohur natyrën e vet reale, e njohin pavdekësinë e vet dhe e kuptojnë intuitivisht bashkimin e tyre me Qenien e përhershme.

– Diana Morrison

Kapitulli tre: Shërbimi pa-veten

TITULLI I KËTIJ KAPITULLI në sanskritisht është Karma Joga, “Mënyra e Veprimit” dhe këtu bëjmë kthesë – në shikim të parë të madhe – nga tema e kapitullit të kaluar. Në fakt, Arxhuna e ndryshon temën plotësisht. Krishna është përpjekur ta bindë se ai ka shpirt të pavdekshëm, por Arxhuna vazhdon të shqetësohet për vështirësinë e tij të drejtpërdrejtë. Jo se është i painteresuar për përndritjen mistike, por shqetësimi i tij kryesor për momentin është veç hapi i radhës që duhet ta bëjë tani.

Apo, pyet ai, mbase ajo që e bën nuk është kaq e rëndësishme në fund të fundit. A po i thoshte Krishna të përqendrohet në arritjen e urtisë shpirtërore dhe të harrojë për detyrat e tij të dukshme në botë?

Krishna përgjigjet se nuk ka mënyrë që Arxhuna të mund ta shmangë obligimin e veprimit pa-veten, apo karma joga. Arxhuna duhet të veprojë pa-veten, nga ndjenja e detyrës. Duhet të punojë jo për hir të vetin, por për mirëqenien e gjithçkaje. Krishna thekson se ky është ligj themelor që është në themel të gjithë krijimit. Secila qenie duhet ta bëjë pjesën e vet në skemën e madhe të gjërave, dhe nuk ka mënyrë për ta shmangur këtë obligim – përveç mbase me përndritje të plotë që i çliron të gjitha lidhjet e vjetra të karmës.

Këtu Gita i referohet doktrinës së karmës, një nga mësimet bazë në të gjitha shkrimet e shenjtë hindu dhe budiste. *Karma* fjalë për fjalë domethënë vepër apo veprim; ajo që nganjëherë quhet “ligji i karmës” i referohet një ligji që është në themel të shkakut dhe efektit që shihet se e përshkon tërë ekzistencën. Ideja është se çdo veprim çon në një rezultat të arsyeshëm – dhe, për pasojë, se gjithçka që ndodh mund të gjurmohet te diçka e bërë në të shkuarën. Veprimet e përcaktojnë fatin: kjo është ideja themelore e karmës. Nëse na ndodh çkadoqoftë që është vërtet e mirë, duhet të kemi bërë diçka në të shkuarën për ta merituar; nëse na godet diçka e keqe, atëherë në një kohë në të shkuarën kemi bërë diçka që nuk ishte aq meritore. Ky është ligj themelor moral që është i përbashkët për të gjitha traditat shpirtërore: besimi se korrim çka mbjellim.

Tradita hindu i ka kushtuar shumë të menduar këtij problemi të shkakut dhe efektit moral dhe brez pas brezi mësues shpirtërorë e kuptuan thellësinë dhe implikimet e tij. Një frikë që u zhvillua me kalimin e kohës ishte se tërë veprimi ishte në njëfarë mënyre derë e hapur për robërinë: çkado që ka bërë një person do ta lidhte me ciklin e pafund të shkakut dhe pasojës. Disa “fruta” të veprimit natyrisht do të ishin të këndshme – jo tërë karma është e dhembshme. Por edhe kjo kënaqësi do të ishte kurth, sepse do ta kërkonim në mënyrë të varur, duke e

lidhur veten gjithnjë e më fort me përgjegjësitë dhe shanset e jetës tokësore dhe duke e harruar krejtësisht dimensionin tonë shpirtëror.

Në kapitullin 3 Krishna nis t'ia tregojë Arxhunës rrugën e daljes nga ky labirint i shkakut dhe pasojës. Ajo nuk është t'i shmangët punës, veçanërisht detyrave të kërkuara nga vendi i tij në jetë, por t'i kryejë ato detyra pa lidhje vetjake me “frutin”, apo rezultatit e tyre. Nëse Arxhuna e ndjek këtë rrugë të punës pa-veten, shpjegon Krishna, atëherë do ta shijojë këtë botë si dhe tjetrën. Edhe më e rëndësishme, do të fitojë bekim shpirtëror dhe do të jetë duke e pakësuar borxhin e tij të karmës. Veç kur është i lirë nga çdo lidhje e karmës – çdo pasojë e veprimit të kaluar – ai mund ta arrijë qëllimin vendimtar të jetës.

Bota është e lidhur nga aktiviteti i vet, se të gjitha krijesat përveç burrit apo gruas së përndritur punojnë për kënaqësinë dhe përfitimin e vet. Për shkak se veprojnë në mënyrë vetjake, janë të lidhur nga rezultatet, qofshin të mira apo të këqija. Duhet të veprojmë në frymë pa-veten, thotë Krishna, pa përfshirje-egoike dhe pa u ngatërruar në atë se a shkojnë gjërat siç duam ne; veç atëherë nuk do të biem në rrjetën e tmerrshme të karmës. Nuk mund të shpresojmë t'i shpëtojmë karmës duke u përmbajtur nga detyrat tona: madje edhe për të mbijetuar në botë, duhet të veprojmë.

Vërtet, shkrimet e shenjta hindu e përmbajnë edhe një rrugë tjetër – *xhnana joga*, rruga e urtisë – që nuk e urdhëron veprimin. Por Krishna nuk ia ofron Arxhunës vërtet këtë si alternativë; ajo njihet-pranohet dhe pastaj hidhet. Mbase Krishna e di se Arxhuna nuk është tipi që e shkëput veten dhe niset për ta kërkuar vizionin mistik. Për Arxhunën, jeta aktive është thelbësore.

Rreziku, natyrisht, i një jete me angazhim aktiv në botë është se Arxhuna do të kapet nga veprimet e veta dhe do të nisë të veprojë nga motive vetjake. Nëse do të ndodhte kjo, ai do të ishte i dënuar me dështim shpirtëror.

Duke pasur një vetë-njohje goxha të mirë, Arxhuna e ndjen këtë rrezik. Ai ia bën Krishnës një pyetje themeltare: Çfarë fuqie na lidh me rrugët tona vetjake? Edhe nëse duam të veprojmë drejt, kaq shpesh e bëjmë gjënë e gabuar. Çfarë fuqie na lëviz?

Krishna përgjigjet se zemërimi dhe meraku vetjak janë armiqtë tanë më të mëdhenj. Ata janë fuqitë shkatërruese që mund të na detyrojnë të bredhim larg nga qëllimi ynë, për të mbaruar në vetë-deluzion dhe dëshpërim.

Këtu është e nevojshme të prezentohen dy terme teknike nga filozofia hindu. Gita nuk është vepër akademike a filozofi, por tekst poetik, praktik. Megjithatë, kohë pas kohe i referohet Sankhia-s, njëres nga gjashtë shkollat tradicionale të filozofisë indiane. Në Sankhia, bota fenomenale e mendjes dhe e materies

përshkruhet se i ka tri cilësi apo *guna* themelore: *sattva* – mirësia, drita, pastërtia; *raxhas* – pasioni, aktiviteti, energjia; dhe *tamas* – errësira, padituria, plogështia. Sipas Sankhia-s, evolucioni shpirtëror përparon nga *tamas* në *raxhas* në *sattva*, dhe çlirimi përfundimtar e çon shpirtin krejtësisht përtej tri *gunave*.

Këtu Krishna e paralajmëron Arxhunën të ketë kujdes nga grackat e *raxhas-it*, se pikërisht nga *raxhas-i* shfaqen zemërimi dhe merak vetjak. Arxhuna duhet ta kuptojë intuitivisht se natyra e tij e vërtetë, Atmani, është përmbi ngatërrimin me *gunat*. *Gunat* veprojnë dhe reagojnë ndaj njëra-tjetrës, por qenia e brendshme e Arxhunës nuk ndikohet. Nëse ai nuk mund ta arrijë këtë shkëputje, gjithmonë do të kapet nga stuhitë emocionale të pasionit (*raxhas*) apo nga moçalet e plogështisë (*tamas*) që alternojnë në dominimin e mendjes dhe të trupit.

Krishna ia ofron Arxhunës shembullin e Mbretit Xhanaka, i njohur mirë nga legjenda e shenjtë, si model për gjendjen e bukur mbresëlënëse. Xhanaka ishte mbret që sundonte mirë dhe nuk i shmangej përgjegjësive të tij, e megjithatë ishte i shkëputur dhe punonte nga një ndjesi e detyrës, jo për përfitime a kënaqësi personale. Atë e nderonin si urtak mbretëror që e ndiqte përndritjen e vet jo duke hequr dorë nga bota, por duke punuar në të dhe duke kontribuar në mirëqenien e saj, duke e shijuar kështu më të mirën e të dy botëve.

– D. M.

Kapitulli katër: Urtia në veprim

KRISHNA ËSHTË I ETUR t'ia japë Arxhunës njohjen e të vërtetave më të larta shpirtërore, apo madje edhe një vizion të rrallë mistik; por Arxhuna po i kërkonte Krishnës thjesht ta nxirrte nga vështirësitë e tanishme. Natyrisht këto vështirësi nuk janë të vogla – ai është zënë në një tragjedi familjare që është zhvilluar në konflikt jashtëzakonisht të dhunshëm. Nëse nuk mund të nxirret nga situata, e di se do të duhet të marrë pjesë në një betejë katastrofike të cilën nuk e do askush.

Pra kur Krishna nis t'i tregojë Arxhunës për “mësimet e fshehta” që do të jetë i privilegjuar t'i dëgjojë sepse është ndjekësi i përkushtuar dhe miku më i dashur i Krishnës, kjo vështirësi se lë shenjë në vetëdijen e Arxhunës. Përgjigja e tij është e hutuar. “Si ke mundur t'u kesh mësuar ndonjë urti të fshehtë urtakëve të lashtë?” pyet ai.

Në këtë pikë Krishna ia kujton Arxhunës përsëri procesin e rilindjes. Ata të dytë janë rilindur shumë herë, por natyrshëm Arxhuna nuk i kujton jetët e kaluara sepse nuk ka qasje në këtë lloj njohurie. Krishna i kujton lindjet e tij të mëparshme, por ai nuk është qenie e zakonshme. Ai zbulon se ka zgjedhur ta pranojë lindjen njerëzore shumë herë për mirëqenien e botës. Kurdo që d'hurma, ligji i unitetit të jetës, pëson rënie, ai mbështillet në maia-n e vet dhe e merr një formë të fundme. Kështu kthehet epokë pas epoke.

Vishnu, personi ruajtës apo mbështetës i Trinisë Hindu, nuk përmendet këtu, por Krishna zakonisht shikohet si mishërim i këtij aspekti të Zotit. Si Zotëruesi, shpjegon Krishna, ai rri në secilën qenie, por manifestohet me fuqi të veçantë në mishërimet apo *avatarët* e tij. *Avatara* fjalë për fjalë domethënë zbritje: Vishnu besohet se zbret dhe e mishëron veten në tokë nga epoka në epokë për ta rimirëvendosur ligjin hyjnor (d'harm-ën). Pa ndërhyrje të tillë i tërë universi i krijuar do të shkonte në rënie. Rrjedha natyrale e krijimit është të shkohet nëpër cikle të rigjenerimit dhe të kalbjes, por Vishnu – Krishna – ka dhembshuri për tërë vuajtjen e botës, dhe vjen vetë për ta mbrojtur të mirën dhe për ta shkatërruar të keqen. Kështu Vishnu ka relacion të veçantë me të gjitha qeniet: ai e personifikon aspektin e Zotit që e do botën kaq shumë sa që vjen në të për ta rimirëvendosur pastërtinë dhe lumturinë e Epokës së Artë.

Krishna këtu e zbulon pak nga natyra e tij e fshehur, hyjnore. I tregon Arxhunës se bashkimi mistik me të është i mundur përmes përkushtimit, me të cilin njeriu mund të hyjë në gjendje të dashurisë hyjnore në të cilën njeriu e sheh Zotin në

çdo krijesë. Krishna e merr edhe rolin e krijuesit. Është ai që e ka modeluar botën përgjatë vijave të gunave dhe karmës.

Ky aspekt mistik i qenies së Krishnës e dominon Gitën. Në *Mahabharata*, Krishna është aleat shumë mbresëlënës që është i urtë dhe i guximshëm në përkrahjen e mikut të tij Arxhunës. Por autori i Gitës nuk merret me këtë Krishnë; ai e kthen vëmendjen e tij kah misteri i natyrës hyjnore të Krishnës si aspekt i Vishnu-s. Në këtë kuptim Krishna është Vetja e brendshme në të gjitha qeniet. Emri i tij vjen nga rrënja sanskrite *krish*, “të ngrehësh kah vetja, të tërheqësh”. Ai është “ai tërheqësi”, “Zotëruesi i tërheqjes së dashur”. Sipas një etimologjie tjetër, fjala *Krishna* domethënë “i errëti”. Autori i Gitës e sheh të zbuluar në të Esencën e Zotit, qenien supreme. Por ky realitet shpesh megjulohet, dhe pastaj Krishna shihet si qenie njerëzore e zakonshme – apo, më saktë, si njeri me dhunti të jashtëzakonshme, por jo si Zoti.

Shumë nga fjalët e Krishnës kanë më së shumti kuptim kur e kuptojmë se kur flet për veten, shpesh nuk po e përshkruan aq shumë një realitet transcendental sa po mundohet t’i tregojë Arxhunës për Vetën në çdo qenie njerëzore. Kur thotë, për shembull, “Veprimet nuk më ngjiten sepse nuk jam i lidhur me rezultatet e tyre”, ai do të thotë: “Arxhuna, veprimet nuk i ngjiten Vetes tënde reale.” Vetja në ne nuk preket nga veprimi; çkado që bëjmë, ajo mbetet e panjolllosur. “Ata që e kuptojnë këtë” – për veten – “dhe e praktikojnë jetojnë në liri”.

Pjesa e fundme e këtij kapitulli kthehet prej temave të larta mistike kah problemi i drejtpërdrejtë i Arxhunës. Krishna nis të flasë për veprimin dhe punën dhe gjërat që duhet të bëhen dhe që nuk duhet të bëhen. Është thelbësore, ia kujton Arxhunës, të veprohet me urti, me shkëputje. Urtakët kurrë nuk veprojnë me lidhje vetjake me frytin e punës së tyre; e japin më të mirën si në fat ashtu edhe në fatkeqësi. Njerëzit e tillë veprojnë në liri.

Pjesa tjetër merret me llojet e ndryshme të *jaxhna-s* – adhurimi apo dhurata – që mund të bëhen nga aspirantët shpirtërorë me temperamente të ndryshme. Rituale hindu shpesh e përfshijnë bërjen e një dhurate zotave duke e derdhur një blatim në zjarrin e shenjtë. Këtu imazhi është i njëjtë: çkado që ofrohet hidhet simbolikisht në zjarrin konsumues që ia çon dhuratën Zotit. Dhurata mund të jetë po aq e dukshme sa të mirat tokësore, apo po aq subtile sa njohuria apo meditimi: në çdo rast e kërkon një masë të vetë-flijimit. Jaxhna është veprim themelor, i nevojshëm për jetën, dhe ata që nuk e kryejnë ndonjë lloj të shërbimit pa-veten nuk gjejnë shtëpi në këtë botë apo tjetrën.

Vargjet e fundit të kapitullit 4 e paraqesin një parim të ri. Në kapitullin e fundit, Krishna e përmendi rrugën e urtisë shpirtërore si alternativë ndaj rrugës së veprimit apo karma joga. Tash e zbulon se urtia është qëllimi i veprimit pa-veten:

njohja është fryti i bërjes. Qëllimi i tërë karma jogës apo jaxhna-s është çlirimi dhe urtia shpirtërore. Zjarri i vetëdijesisë shpirtërore e djeg deri në hi madje edhe një grumbull të madh të karmës; kështu njohja e vërtetë është pastruesi më i madh i shpirtit.

Krishna përfundon duke e nxitur Arxhunën t'i zgjidhë dyshimet që ia zënë frymën ende. Kjo është përmendja e parë – por jo e fundit – që e bën Krishna për zemrën dyshuese të Arxhunës. Nuk ka pasur asnjë tregues deri tash se Arxhuna i ka kuptuar dhe pranuar fjalët e Krishnës. Por edhe pse Arxhuna vazhdon t'i zvarrisë këmbët, Krishna nuk e braktis.

– D. M.

Kapitulli pesë: Heqja dorë dhe shijimi

NË FILLIM TË KËTIJ KAPITULLI, qasja tradicionale ndaj jetës shpirtërore – domethënë “lënia e botës”, largimi nga çështjet e zakonshme të punës dhe të familjes – kontrastohet me të punuarit në botë me shkëputje. Termi i përgjithshëm për largimi nga bota është *sanniasa*, “heqja dorë”. Tradicionalisht, sanniasa nënkuptonte heqjen dorë nga të gjitha lidhjet dhe ngjitjet tokësore. Personi që e bënte betimin e sanniasës do ta linte shtëpinë, familjen dhe profesionin për ta ndjekur një jetë të rreptë reflektuese.

Kjo ishte rrugë e zgjedhur nga shumë pak njerëz, madje edhe në Indinë e lashtë. E megjithatë nuk duhet të harrojmë se një numër i habitshëm i njerëzve në shoqëritë tradicionale, edhe në Lindje edhe në Perëndim, kanë zgjedhur jetë murgërisht të larguar nga trazirat e botës. Në Indi, Buda Dashamirës e ofron shembullin klasik të atij që i lë komoditetet dhe përmbushjet e jetës familjare dhe tokësore për ta kërkuar rrugën e vetmuar kah kuptimi intuitiv i Vetes. Tregimi është i njohur në të gjithë Azinë. Siddhartha Gautama ishte princ me çdo kënaqësi tokësore brenda mundësive të tij, që e la pallatin e vet për ta gjetur një mënyrë për ta udhëhequr botën përtej vuajtjes dhe vdekjes. Ai u bë *sanniasi* endacak, murg i vetmuar e i rreptë. Vetëm pasi e kishte arritur përndritjen e plotë iu kthye shoqërisë, për t’i mësuar të tjerët për paqen e nirvanës.

Megjithëse Krishna e pranon këtu se kjo mënyrë e sanniasës mund të çojë te qëllimi, ai e rekomandon rrugën e veprimit pa-veten apo shërbimit pa-veten si rrugën më të mirë. Ai e kontraston mënyrën e Sankhias – që në këtë kontekst domethënë njohja e Vetes në mënyrë të përgjithshme – me mënyrën e jogës, që këtu domethënë mënyra e veprimit. Ky term *joga* paraqet vështirësi në Gitë sepse domethënë gjëra të ndryshme në kohë të ndryshme, dhe janë dhënë shumë përkufizime për këtë term të gjithanshëm. Por për disa kapituj tema e diskutuar ka qenë jeta aktive shpirtërore, apo karma joga, dhe kjo është qartas ajo që nënkuptohet në këtë kontekst. *Sankhia* dhe *joga* mund të përkthehen edhe si “teoria dhe praktika”.

Do të dukej se në kohën e Gitës rruga e urtisë vlerësohej shumë lart, gjersa rruga e veprimit mund të ishte shikuar si falsifikim tëhollues i jetës shpirtërore. Madje është e mundur që Gita ishte shkrimi i parë i shenjtë hindu që e paraqet idenë e re të kombinimit të karma jogës me ndjekjen e njohjes së Vetes. Krishna thonë se veç njerëzit e papjekur dhe pa përvojë i shikojnë rrugët e njohjes dhe të veprimit si të ndryshme. Qëllimi i vërtetë i veprimit është njohja e Vetes. Ndjekja e secilës rrugë besnikërisht do të çojë në vizionin e plotë shpirtëror.

Është thelbësore në karma joga që egoja vetjake të mos presë kënaqësi nga puna. Kur nuk ka përfshirje vetjake në punë, punëtori nuk has dëm shpirtëror. Shembull është lotusi (zambaku i ujit): e kalon jetën e tij duke pluskuar në ujë, e megjithatë pikat e ujit rrokullisen nga gjethet e tij pa i lagur kurrë ato. Ngjashëm, përderi sa jogi-t e karmës nuk presin shpërblim apo t'ia njohin punën, çfarëdo e keqe që mund t'i njollosë nuk ka ku të kapet. Jogi-t e tillë thuhet të jenë të shkëputur nga rezultati apo frytet e veprimeve të veta (*karma fala*).

Krishna e paralajmëron Arxhunën se një jetë me punë, madje edhe me punë të suksesshme, nuk mund të jetë përmbushëse pa njohjen e Vetes. Në fund të fundit, Vetja e vërtetë brenda tij nuk ndikohet nga ajo që e bën ai, qoftë e mirë apo e keqe. Veç njohja e Vetes, që lind si dielli në agim, mund ta përmbushë qëllimin e jetës së tij dhe ta çojë përtej rilindjes.

Kjo njohje e Vetes apo Atmanit është, pikërisht për nga natyra e vet, edhe njohje e Brahmanit, Esencës së Zotit që është gjithëpërfshirës, i kudondodhshëm dhe transcendent. Krishna thotë se personi i përndritur e sheh këtë esencë hyjnore në të gjitha qeniet. Ai apo ajo ka “shikim të qetë” dhe e sheh Vetën hyjnore në të gjitha, pavarësisht aspektit të jashtëm.

Tri vargjet e fundit të kapitullit e përshkruajnë një gjendje të meditimit thellues të quajtur samadhi.

²⁷ Duke i mbyllur sytë e tyre, duke e stabilizuar frymëmarrjen dhe duke e përqendruar vëmendjen e tyre në qendrën e vetëdijes shpirtërore, ²⁸ të urtët i zotërojnë shqisat, mendjet dhe intelektin e tyre përmes meditimit. Kuptimi-Intuitiv-i-Vetes është qëllimi i tyre i vetëm. Të çliruar nga merakut vetja, frika dhe zemërimi, jetojnë në liri gjithmonë. ²⁹ Duke më njohur si mikun e të gjitha krijesave, Zotëruesin e gjithësisë, destinimin e të gjitha flijimeve dhe disiplinave shpirtërore, ata arrijnë paqe të përhershme.

Kur meditimi bëhet shumë i thellë, frymëmarrja bëhet e ngadalshme, e qëndrueshme dhe e barabartë, dhe dritaret e shqisave mbyllen ndaj të gjitha ndjesive të jashtme. Pastaj zotësitë e mendjes qetësohen, duke pushuar nga aktiviteti i furishëm i zakonshëm; madje edhe emocionet primitive të merakut, frikës dhe zemërimit dobësohen. Kur të gjitha këto batica shqisore dhe emocionale janë ndalur së rrjedhuri, atëherë shpirti është i lirë, *mukta* – të paktën për momentin. Ka hyrë në gjendjen e quajtur samadhi.

Samadhi mund të vijë e të shkojë; përgjithësisht në të mund të hyhet veç në një periudhë të gjatë të meditimit dhe pas shumë vitesh të përpjekjeve shumë të forta. Por një varg (5:28) e shton fjalën domethënëse *sada*, “gjithmonë”. Pasi kjo gjendje e përqendrimit të thellë bëhet e mirëvendosur, personi jeton në liri shpirtërore, apo *moksha*, përgjithmonë. Kjo është jashtëzakonisht e rrallë. Mistikët e Perëndimit si dhe të Lindjes kanë arritur pamje të shkurtra të unitetit, por për shumë pak mund të thuhet se kanë qëndruar në të përherë, si të ishte habitati i tyre natyror. Në Perëndim figurat më të spikatura janë Meister Eckhart, Shën Tereza e Avilës dhe Shën Gjoni i Kryqit, megjithëse ka pasur edhe të tjerë. Në traditën hindu është një linjë e gjatë e shenjtorëve dhe e mistikëve që janë munduar të komunikojnë diçka nga natyra e këtij unioni me Realitetin e Zotit, nga regjistruarit e panjohur të Upanishadeve përmes Budës, Shankarës dhe Mirës (Meera), të Ramakrishna dhe Ramana Maharshi.

– D. M.

Kapitulli gjashtë: Praktika e meditimit

KY ËSHTË SIGURISHT një nga kapitujt më intrigues të Gitës, se këtu na jepet një shpjegim i detajuar i meditimit që i drejtohet personit laik. Teknikat e njëjta të meditimit janë dhënë në shkrime më ezoterike, si *Sutrat Joga* të Patanxhalit, por Gita e bën këtë më thjesht, pa ndonjë mister apo kompleksitet të panevojshëm.

Ky kapitull e eksploron edhe pyetjen: “Kush është jogi i vërtetë?” Kjo fjalë *jogi* mund të sjellë në mendje imazhe të njerëzve të mahnitshëm që bëjnë shtrembërime të çuditshme me trupat e tyre. Jogit ende mendohen si asi që qëndrojnë në kokat e veta apo që shtrihen në shtrat me gozhda. Është e vërtetë se ka shumë praktikues të një lloji të jogës që i përfshin ushtrimet dhe pozat fizike; dhe ka asi që kanë bërë arritje të jashtëzakonshme si shtrirja në shtretër me gozhda, apo madje edhe të varrosen të gjallë dhe të mbijetojnë. Por kjo anë fizike e jogës (e quajtur *hatha joga*, “joga e forcës”) nuk është ajo që nënkuptohet në Gita. Në fakt, megjithëse teknikat fizike e kanë vendin e vet, Gita e konsideron theksimin e tepruar të tyre si diçka jashtë rrjedhës normale të zhvillimit shpirtëror.

Në Gita, fjala *jogi* shpesh e ka një përkufizim më modest: mund ta nënkuptojë një person që e bën punën e vet me shkëputje nga shpërblimet (6:1):

Jo ata që u mungon energjia apo përmbahen nga veprimi, por ata që punojnë pa pritshmëri apo shpërblim janë ata që e arrijnë qëllimin e meditimit. E tyrja është heqja dorë e vërtetë.

apo mund të përkthehet si “dikush që e ka arritur qëllimin e meditimit”. Sepse *jogi* fjalë për fjalë domethënë “dikush që është i zoti në joga”, dhe *joga* domethënë “integrimi i shpirtit”. Në këtë kuptim, *joga* domethënë të qenët i plotë apo procesi i të bërit i plotë në nivelin më të thellë shpirtëror. Fjala *joga* përdoret shpesh edhe si sinonim për *raxha joga*, praktika e meditimit siç mësohet nga Patanxhali; se meditimi është mjeti i drejtpërdrejtë për t’u bërë i integruar, i bashkuar me Vetën më të vërtetë, më të thellë të njeriut. Kështu një jogi, ndër të tjera, është person që është i aftë në meditim.

Deri tani, Krishna e ka udhëzuar Arxhunën për nevojën për karma joga, jetën aktive të shërbimit. Tash Krishna është gati ta fusë në praktikën e disiplinave më të brendshme të jetës shpirtërore. Karma joga, thotë ai, është rruga për ata që duan t’i ngjiten malit të kuptimit intuitiv të Vetes; për ata që e kanë arritur

majën, rruga është *shama*, paqja e reflektimit. Në fillimin e jetës shpirtërore, kërkohet përpjekje e madhe; gjersa i afrohemi majes, megjithëse ngjitja nuk bëhet më e lehtë, shtohet dimensionin e reflektimit apo prehjes. Shumë tradita shpirtërore, natyrisht, e përdorin këtë imazh kur flasin për kërkimin fetar. Maja e malit është vendi ku të shenjtët, si Moisiu (Musai), komunikojnë intimisht me Zotin; dhe Shën Gjoni i Kryqit flet për ngjitjen në malin e Karmelit.

Gjatë ngjitjes së këtij mali, vullneti, vetë-ndihma dhe përpjekja intensive personale janë esenciale absolute. Përkthimi fjalë për fjalë i vargut 5 është “njeriu duhet ta ngrisë veten deri te Vetja e vet” – një lojë me fjalën *atman*, që mund ta nënkuptojë Vetën më të lartë si dhe veten në kuptimin e zakonshëm. Për njeriun pra vetja është miku i vet apo armiku i vet. Ajo “vetja më e ulët” është vetë-vullneti – vullneti në kuptimin negativ, vetjak. Një vullnet i padisiplinuar i shtrembëruar kah vetë-lavdërimi është armik që fshehet pikërisht brenda kalasë, ku mund ta bëjë dëmin më të madh. Por ata që e kanë “mposhtur veten nga vetja” e kanë mikun e vet më të vërtetë në Vetën. Veç ata që kanë vetë-disiplinë të vërtetë, që janë “të vetë-mposhtur”, jetojnë në paqe.

Këta, thotë Krishna, janë jogi të vërtetë. Ata nuk mund ta ushqejnë asnjë ligësi, as s’mund ta bëjnë veten ta shohin dikë si armik. Ata janë *samabuddhi*, “me mendje të njëtrajtshme”. Jogit e vërtetë, që janë plotësisht të integruar në të gjitha nivelet e vetëdijesisë, e ndjejnë gëzimin dhe pikëllimin e secilit si të ishte i tyri. E shohin Vetën në të gjitha qeniet, kudo.

Si duhet të bëhet kjo vetë-mposhtje? Shumë thjesht, Gita mëson se mendja duhet të bëhet e fokusuar në një pikë përmes praktikës së meditimit. Kjo është teknika themelore. Në Gita nuk e shohim tendencën për elaborim, për ritual dhe mister, që ndonjëherë e gjejmë në traditën hindu. Krishna thjesht i thotë Arxhunës, së pari, se duhet ta gjejë një vend të përshtatshëm për të medituar. Një vend i përshtatshëm për praktikën e tij do të jetë i pastër dhe i rehatshëm. Duke e pohuar traditën, një varg e rekomandon që ulësja të mbulohet me bar Kusha dhe lëkurë dreri – ulësja tradicionale e jogive. Mirëpo gjëja e rëndësishme nuk është se si është bërë ulësja e meditimit, por ajo që po ndodh në mendje. Meditimi është disiplinë e brendshme për ta bërë mendjen të fokusuar në një pikë, të përqendruar absolutisht.

E dyta, Krishna e udhëzon Arxhunën ta mbajë trupin, kokën dhe qafën në një vijë të drejtë. Kjo mund të duket ezoterike – referencë për shkollën shtrënguese të jogës – por ka qëllim praktik. Ulja absolutisht drejt, me shtyllën kurrizore të drejtuar, e parandalon përgjumjen. Po ashtu, në faza të përparuara të meditimit, e lejon rrjedhjen e lirë të energjisë jetike apo *kundalinin*.

Pastaj jepen këshilla praktike: mosteprimi është rruga. As asketizmi ekstrem as kënaqja e merakeve nuk do t'i ndihmojë meditimit. Një njohje fillestare me kulturën hindu mund ta japë përshtypjen se ai e nxit ose sensualitetin e *Kama Sutrës* ose asketizmin e vetmitarit. Është e vërtetë se në qytetërimin indian mund ta shohim lehtësisht zhvillimin e sensuales dhe artistikes në shumë manifestime – në pikturë, skulpturë, muzikë dhe vallëzim. Dhe kuzhina indiane është e famshme për shumësinë e shijeve dhe erëzave. India na e paraqet edhe thjeshtësinë e ashpër të njeriut të shenjtë endacak apo *sadhu*. Gita, megjithatë, e rekomandon rrugën e mesme. Suksesi në meditim, thotë Krishna, nuk u vjen as atyre që hanë apo flenë tepër shumë as atyre që hanë apo flenë tepër pak. Trupi nuk duhet as të tejkenaqet as të trajtohet ashpër – i njëjti rekomandim që e ofron Buddha.

Ky kapitull e përmban vargun e famshëm (6:19)

Kur zotërohet meditimi, mendja është e palëkundur si flaka e një llampe në një vend pa erëra.

që e krahason mendjen me një flakë të qëndrueshme. Për nga vetë natyra e saj mendja e paushtruar është e shqetësuar, duke u endur vazhdimisht andej-këndeje duke u përpjekur t'i përmbushë meraket e veta. Ajo dridhet egërsisht si një flakë në stuhi – kurrë e fikur plotësisht, e megjithatë në mëshirën e erës. Kudo që të endet mendja, thotë Krishna, duhet ta kthejmë në burimin e saj; duhet të mësohet të pushojë në Vetën. Sapo të jetë në vatër në thellësitë e reflektimit, mendja bëhet e qëndrueshme, si flakë e drejtë përpjetë, që nuk dridhet, në një vend pa erëra. Në këtë meditim të thellë, dhe vetëm aty, qenia njerëzore mund ta gjejë përmbushjen e plotë. Pastaj “mendja që është në prehje e prek Brahmanin dhe e shijon lumturinë.”

Tash Arxhuna e bën një pyetje të pashmangshme. Krishna është shumë përpara tij, dhe dishepulli që po përpiqet fort thjesht nuk mund ta zërë hapin. Ai thotë: “Mendja ime është kaq e shqetësuar dhe e paqëndrueshme sa që as që po mund të kuptoj asgjë për këtë gjendje të paqes mistike për të cilën po flet.” Mendja është kaq e fuqishme, kaq e trazuar, sa që të përpiqesh ta vësh nën kontroll është si të përpiqesh ta kapësh frymën.

Krishna e pranon se mendja është tmerrësisht e vështirë për t'u ushtruar, por pohon se kjo mund të bëhet përmes praktikimit të rregullt nëse njeriu ka shkëputje. Është interesante se ai nuk i ofron ndihmë Arxhunës këtu; kjo do të

vijë më vonë. Tash për tash, i thotë Arxhunës se duhet ta bëjë vetë për veten, përmes punës së palodhur dhe shkëputjes nga motivet private, personale.

Pastaj Arxhuna e bën një pyetje goxha befasuese: çka ndodh me personin që beson në një qëllim shpirtëror por nuk e gjurmon deri në fund? Çka nëse një nga meraket e tij më të fuqishme të pakontrollueshme e merr pjesën e tij më të mirë, duke e shpartalluar vendimin e tij siç shpartallohet një re nga fryma? Ose Arxhuna nuk është i përgatitur ta kërkojë kuptimin intuitiv të Vetes ose ka frikë se disi mund të dështojë nëse do të përpiqej. Nëse do të dështonte, pyet ai, a do të kishte humbur gjithçka – gjithçka nga e cila kishte hequr dorë në jetën tokësore si dhe qëllimin e vet për vetë-përmbushje?

Me dashuri e përkushtim, Krishna e siguron Arxhunën se asnjë përpjekje për ta përmirësuar gjendjen e tij shpirtërore nuk mund të jetë përpjekje e çuar kot. Madje edhe duke parë përpara në jetën tjetër, nuk ka asgjë për të humbur dhe ka gjithçka për të fituar. Ai do të rilindet në një familje të përshtatshme për ta vazhduar kërkimin e tij aty ku e ka lënë. Në jetën e ardhshme, do të ndihet i tërhequr përsëri kah qëllimi shpirtëror, dhe do ta ketë një përparësi kur të fillojë.

– D. M.

Kapitulli shtatë: Urtia nga kuptimi intuitiv

NË SANSKRITISHT KY KAPITULL quhet “Joga e Urtisë dhe e Kuptimit Intuitiv” – apo “Joga e Urtisë nga Kuptimi Intuitiv”. Termi i përdorur për urtinë është *xhnana*; për kuptimin intuitiv, *vixhnana*. Ka hapësirë për huti në këtë terminologji, meqë *xhnana* dhe *vixhnana* janë të hapura për interpretime të ndryshme. Të dy fjalët janë nga rrënja *xhna*, “të dish/njohësh”, që ndërlidhet me fjalën greke *gnosis*. Parashtesa *vi* kur i shtohet një emri zakonisht ia intensifikon kuptimin; pra *vixhnana* mund të nënkuptojë të dish intensivisht apo në një shkallë më të lartë. Në këtë kontekst, megjithatë, *xhnana* është termi standard për llojin më të lartë të dijes: jo njohja nga studimi serioz formal apo leximi i librave por njohja e drejtpërdrejtë e Zotit, urtia shpirtërore. Nëse e marrim *xhnanën* në këtë kuptim, nuk na mbetet kuptim i qartë për *vixhnana*, një “lloj më intensiv i *xhnanës*”. Ramakrishna e kupton *vixhnanën* si njohje përjetimore praktike, intime me Zotin, aftësinë për t’i çuar deri në fund çështjet ditore me të kuptuar më abstrakt që është *xhnana*. Ramakrishna thotë: “Ai që veç ka dëgjuar për zjarrin ka *axhnana*, padije/injorancë. Ai që e ka parë zjarrin ka *xhnana*. Por ai që praktikisht e ka ndërtuar një zjarr dhe ka bërë ushqim në të ka *vixhnana*.”

Në këtë kapitull e gjejmë veten duke i ndjekur disa shtigje dhe nganjëherë e humbim temën unifikuese, që është njohja e realitetit suprem që qëndron në themel të natyrës. Dikur, megjithatë, kthehemi në pikën fillestare: njohja e kontrastuar me padijen, realiteti transcendent i krahasuar me botën fenomenale.

Por, për t’i ndjekur rrugët anësore: së pari diskutohen “dy natyrat” e Krishnës. Në njërën anë, ai i ka krijuar nga vetja elementet dhe të gjitha gjërat që e përbëjnë botën fenomenale. Përtej kësaj është natyra shpirtërore e Krishnës si Zotëruesi transcendent i universit. Këtu Gita po i referohet një koncepti që më vonë u bë baza e shkollës Sankhia të filozofisë hindu. Sankhia i njohu dy parime themeltare që janë në themel të të gjitha gjërave: prakriti, parimi i mendjes dhe i materies, dhe Purusha, parimi i shpirtit të pastër. Bashkimi i këtyre dy forcave të përhershme, themeltare e vë në lëvizje krijimin e botës siç e njohim. Bashkimi i tyre e formëson dhe e definon edhe tërë përjetimin e zakonshëm njerëzor. Në Sankhia, qëllimi i Kuptimit Intuitiv të Vetes shihet si çlirimi përfundimtar i shpirtit (Purusha) nga flirtimi i tij me mendjen dhe materien (prakriti).

Mirëpo, për dallim nga Sankhia, në Gita është Krishna ai që është prapa edhe prakritit edhe Purushës. Në këtë kapitull, Krishna prezentohet si Krijuesi i botës. Natyra e tij hyjnore mund të shihet blic në krijimin e tij tepër kompleks dhe të mrekullueshëm. Në pjesën dërmuese të mitologjisë hindu, është zoti Brahma që i merr meritat për krijimin e botës. Është ai, hyjnia me katër fytyra, që i ka hedhur

botët e shumëfishta të këtij universi dhe të atyre të kaluar (si dhe të ardhshëm). Por në mitologjinë e Vishnu-së, Brahma lindet në lotusin që rritet nga kërthiza e Vishnu-s. Lotusi është mitra e Vishnu-s. Në të lindet Brahma, dhe me nxitjen e Vishnu-s i krijon botët. Vishnu është Krijuesi real; Brahma është gjysmëzot i lindur nga vullneti i Vishnu-së për të krijuar. Këtu në Gita Krishna drejtpërdrejt i merr të gjitha rolet dhe nderimet që zakonisht bashkëndahen me aspektet e tjera të Zotit të adhuruar në besimin hindu. Jo që këto personifikime të tjera hyjnore refuzohen, por thjesht tërë vëmendja është te Krishna. Për autorin e Gitës, Krishna është forma e Zotit që duhet të adhurohet dhe për momentin të gjitha format e tjera të Zotit zhduken. Krishna është vetëm. Në fakt, një varg thotë se çfarëdo zoti tjetër që duket se po e adhuron dikush, ai në realitet po i afrohet vetë Krishnës. Duke e adhuruar atë, duke e njohur atë, ia mundëson atij që përkushtohet t'ia arrijë qëllimit.

Megjithëse fjala nuk përdoret në Gita, ideja e botës si *lila* e Krishnës, lojë e tij, u bë temë e dashur e hinduizmit të mëvonshëm. Krishna, thuhet, e krijoi botën në lojë: si një fëmijë që do të mund të kishte merak të ketë shokë për të luajtur, Krishna kishte merak të kishte shokë, dhe e krijoi botën. Krishna merr pjesë në lojën e jetës: cilësitë e tij hyjnore shkëlqejnë nëpër botë kudo ku ka shkëlqyeshmëri të çfarëdo lloji. Ai është – i tregon ai Arxhunës – esenca e çdo gjëje të krijuar: shijshmëria e ujit, shkëlqimi i zjarrit, përpjekja e aspirantit shpirtëror. Kjo mund të jetë ajo që nënkuptohet me *vixhnana* për titullin tonë – vizioni i mistikut të hyjnore si prezent këtu dhe tani është mbase kuptimi real i termit.

Fjala *maia* (*maya*) shfaqet këtu, megjithëse jo për herë të parë në Gita. Ashtu si konceptet e prakriti dhe Purusha janë zhvilluar më vonë në filozofinë Sankhia, *maia* më vonë ndërtohet në strukturën formale të Vedanta-s, një tjetër nga gjashtë shkollat kryesore të filozofisë indiane. Fjala *maia* vjen nga rrënja *ma*, “të matësh”, dhe fillimisht e nënkuptonte fuqinë e një hyjnie për të krijuar, veçanërisht për ta krijuar atë që filozofia indiane e quan “emër dhe formë”: materien dhe perceptimet e saj. Maia e ka aftësinë magjike të krijojë formë dhe iluzion – fuqi hyjnore e një zoti për t'u veshur me një maskim, apo për të hedhur botë pas bote të jetës. Maia është edhe pamja e jashtme e gjërave, shfaqja kalimtare që e mban të fshehtë qenien e pavdekshme. Maia mund të jetë edhe e lezetshme edhe e rrezikshme, joshëse e megjithatë tradhtuese. Guna-t, tri cilësitë themelore të të gjitha gjërave të krijuara, rrotullohen e përdridhen brenda botës së majës. Kalimi i oqeanit të majës është qëllimi i udhëtarit të urtë, dhe një barkë është përkushtimi. Në këtë kapitull Gita nis ta theksojë rëndësinë e dashurisë dhe përkushtimit – tema që më vonë bëhen mbizotëruese.

Natyra e vërtetë e Krishnës është e fshehur nga maia (7:25).

Pak njerëz shohin përtej vellos së majës. Bota, e deluzionuar, nuk e di se jam pa lindje dhe i pandryshueshëm.

Rreziqet e majës nuk përshkruhen fuqishëm në këtë kapitull por paralajmërohet për “deluzionet” – *moha-t* – e jetës në botën e majës; ato janë, esencialisht, lidhjet e vetë-qendëruara për të cilat paralajmëronte Krishna. *Moha*, që domethënë huti apo deluzion, është diçka si ëndërrimi kur jemi zgjuar, “të jetosh në një ëndërr”. Dualiteti i lidhjes dhe i neverisë (dashuria dhe urrejtja) e mashtron me lajka mendjen në këtë magjepsje-*moha* që në lindje (7:27):

Deluzioni shfaqet nga dualiteti i tërheqjes dhe i neverisë, Arxhuna; çdo krijesë është e deluzionuar nga këto që nga lindja.

Njohja e Krishnës, dhe përkushtimi atij, është rruga përtej këtij deluzioni. Kështu kapitulli 7 e kontraston urtinë (*xhnana* dhe *vixhnana*) me deluzionin (*moha-n*) e paditurisë shpirtërore.

Gjejmë këtu shumë ide thelbësore që janë përpunuar në filozofitë e mëvonshme të Sankhia dhe Vendanta. Megjithatë, këto koncepte të prakritit-t, Purushës, dhe majës nuk e kanë origjinën nga Gita. Fjala *maia* shfaqet në Rig Veda, më e lashta nga Vedat, dhe Purusha është temë e përsëritur në Upanishade. Gita është pika e mesme në rrugën ndërmjet shkrepjeve intuitive spontane të Upanishadeve dhe sistemeve të mëvonshme, shumë të formalizuara filozofike. Në Gita e gjejmë një prezentim të organizuar të këtyre koncepteve dhe koncepteve të tjera kryesore pa shpjegim të rëndë teknik.

– D. M.

Kapitulli tetë: Esenca e përhershme e Zotit

KY KAPITULL I PËRMEND SHKURTIMISHT disa koncepte të rëndësishme të paraqitura më plotësisht në Upanishade, dhe do të jetë e dobishme të citohen Upanishadet për t'i sqaruar këto pika. Po ashtu, ky kapitull e paraqet një pamje shumë të lashtë të udhëtimit të shpirtit pas vdekjes. Këto ide për jetën e përtejme nuk kanë zënë fill në Gita, dhe janë edhe më të lashta se Upanishadet. Një koncept tjetër i lashtë këtu është ai i një universi ciklik, që shtjellohet në shkrime të tjera të shenjta hindu me shumë detaje; ky kapitull thjesht i referohet kalimthi.

Kapitulli nis me Arxhunën që bën pyetje që duket të jenë të teologjisë, por roli i teologut nuk i përshtatet atij natyrshëm. Këto pyetje bëhen në përgjigje të termave teknikë të përmendur në vargun e fundit të kapitullit 7. Kuptimi i përgjigjes së Krishnës është në përputhje me atë që e tha më parë për maia-n e tij: ai është Zoti i kudondodhur në të gjitha gjërat si dhe Zoti transcendent.

Për është pyetja tjetër e Arxhunës ajo që e përcakton drejtimin që e merr diskursi tani. Arxhuna pyet se si Krishna mund të njihet në orën e vdekjes. Këtu, natyrisht, Arxhuna e nënkupton Krishnën në aspektin e tij kozmik, mistik, kështu që në esencë po pyet: “Si mundet personi që e ka kuptuar intuitivisht Vetën të hyjë në gjendjen supreme të pavdekësisë në kohën e vdekjes?” Krishna përgjigjet se kushdo që e kujton atë në kohën e vdekjes do të hyjnë në *madbhavam*, “qenien time”. Nëse Arxhuna mund ta kujtojë Krishnën në orën e vdekjes, do të bashkohet me Krishnën dhe të hyjë në pavdekësi.

Në fakt, sido që të jetë, përmbajtja e mendjes në orën e vdekjes e drejton shpirtin në udhëtimin e tij drejt rilindjes. Kështu mendja ndikon në evolucionin e shpirtit gjersa lëviz në jetën tjetër. Për çkado që një person mendon në jetë – motivimet e tij apo të saj më të thella – ka gjasa të jenë mendimet e fundit në kohën e vdekjes. Pra është një vazhdimësi ndërmjet kësaj jete dhe tjetrës, dhe tërë bagazhi i merakut dhe motivimit shkon krah për krah me shpirtin. Por këtu Krishna po flet për personin – ai shpreson se Arxhuna do të jetë i tillë – që nuk ka bagazh tokësor, që do ta kujtojë Krishnën në orën e fundit.

Për t'u siguruar se do ta përqendrojë përkushtimin e vet te Krishna në orën e vdekjes, Arxhuna duhet ta bëjë praktikë ta kujtojë atë vazhdimisht tani. Nëse e bën mendjen e vet të fokusuar në një pikë në meditim dhe mëson ta fokusojë qenien e tij te Krishna, atëherë natyrshëm në kohën e vdekjes nuk do të mendojë për asgjë tjetër. Përndryshe, në kaosin e vdekjes, do ta kapë paniku dhe do ta humbë rrugën.

Krishna e përshkruan në detaje se çka i ndodh vetëdijes në momentin e vdekjes (8:12-13):

¹² Duke më kujtuar në kohën e vdekjes, mbylli dyert e shqisave dhe vendose mendjen në zemër. Pastaj, gjersa je i zhytur në meditim, fokusoje tërë energjinë përpjetë deri te koka. ¹³ Duke e përsëritur në këtë gjendje emrin hyjnor, rrokjen Om që e përfaqëson Brahmanin e pandryshueshëm, do të largohesh nga trupi dhe do ta arrish qëllimin suprem.

Këto vargje në të vërtetë i përshkruajnë jogi-t si asi që e kanë në kontroll procesin e vdekjes. Duke e drejtuar vetëdijen e vet hap pas hapi nëpër sprovën e rëndë të lënies së trupit, e arrijnë qëllimin suprem. Kjo ide është pranuar edhe nga njëri prej mësuesve më të mëdhenj të meditimit në Indinë e lashtë, Patanjali, që thotë në *Joga Sutras* se jogi vdes kur të dojë. Përshkrime të ngjashme të procesit të vdekjes hasen në Upanishade, megjithëse aty personi që vdes nuk e ka domosdo kontrollin. Upanishadet japin përshkrim të hollësishëm:

Kur Vetja duket se dobësohet dhe zhytet në pavetëdije, frymëmarrjet e jetës mblidhen tek ajo. Pastaj ajo i merr me vete ato grimca drite dhe zbret në zemër. Kur vetëdija që është në sy kthehet prapa, personi që po vdes nuk sheh më ndonjë formë. “Ai po bëhet një”, thonë; “nuk sheh.” “Ai po bëhet një”, thonë; “nuk nuhat erë.” “Ai po bëhet një”, thonë; “nuk ndjen shije.” “Ai po bëhet një”, thonë; “nuk flet.” “Ai po bëhet një”, thonë; “nuk dëgjon.” “Ai po bëhet një”, thonë; “nuk mendon as s’prek as s’di”. Pika e zemrës së tij ndriçohet, dhe përmes asaj drite Vetja largohet, ose nëpër sy, ose nëpër kafkë, ose nëpër ndonjë derë tjetër të trupit. Dhe kur largohet ajo, largohet jeta: dhe kur largohet jeta, të gjitha forcat e tjera vitale largohen pas saj. Ajo është e vetëdijshme, dhe me vetëdijesi e lë trupin. Pastaj njohuria e saj dhe veprat e saj dhe përshtypjet e saj të mëparshme shkojnë bashkë me të. (Brihadaraniaka Upanishad IV.4.1–2).

Së pari vetëdija tërhiqet nga shqisat. Ata që janë duke vdekur më nuk dëgjojnë as s’shohin se çka po ndodh rreth tyre. Ende janë të vetëdijshëm, por “drita” e vetëdijes është tërhequr nga shqisat, këtu të quajtura “dyer” të trupit. Thuhet se janë nëntë dyer të tilla: dy sytë, dy vrimat e hundës, dy veshët, goja dhe organet e riprodhimit dhe të jashtëqitjes. Nganjëherë shtohen edhe dy të tjera: kërthiza dhe

qepja sagjitale (e kulmit të kafkës), që ndodhet në majë të kafkës dhe në sanskritisht quhet *brahmarandhra*, “hapja e Brahmanit”.

Kur vetëdija është tërhequr nga këto porta, thotë Krishna, “mendja vendoset [‘mbyllet’] në zemër”. (8:12) Këtu, si në misticizmin e krishterë, është zemra dhe jo koka që merret të jetë shtëpia e shpirtit. Me gjasë ajo që nënkuptohet është *çakra* e zemrës, qendra e vetëdijes që korrespondon me qendrën e gjoksit. *Prana* (energja vitale) dhe vetëdijesia janë tërhequr nga kufijtë e jashtëm të personalitetit dhe janë konsoliduar përbrenda. Në këtë fazë të procesit të vdekjes një person i zakonshëm nuk ka qasje te vullneti; por pikërisht këtu është vendi që prana, me vetëdijesinë e vetëdijshme, duhet të bëhet të lëvizë përpjetë te koka. Nëse prana e lë trupin përmes *brahmarandhra*-s, nuk do të ketë rilindje: domethënë, personi që po vdes do të hyjë në samadhi në kohën e vdekjes. Në samadhi, prana tërhiqet nga nivelet më të ulëta të vetëdijesisë për të nxituar përpjetë kah qendra e shtatë në kurorën e kokës. Kjo është e mundur veç për jogin që e ka zotëruar plotësisht meditimin dhe kontrollin e pranës. Nëse prana del nga ndonjëra nga njëmbëdhjetë dyert e trupit, thonë Upanishadet, nuk do të arrihet gjendja e pavdekësisë:

Kur ajo largohet nga ky trup, ngjitet me rrezet e diellit, duke e përsëritur rrokjen **Om**. Sapo mendon për të, vjen te dielli. Ajo, në të vërtetë, është dera për në botën tjetër. Ata që dinë hyjnë; ata që nuk dinë ndalohen. Është një poemë:

Njëqind e një gjurmë subtile dalin nga zemra;

Një nga to shkon përpjetë kah kurora e kokës.

Duke shkuar përpjetë me të, ajo shkon në jetën e përhershme.

Të tjerat nisen në drejtime të ndryshme.

(Chandogia Upanishad VIII.6.5–6)

Në Gita, si dhe në këtë pasazh nga Chandogia Upanishad, përdoret mantra *Om*. Nëse jogit mund ta kujtojnë mantrën madje edhe gjersa vetë vetëdija po largohet nga trupi – dhe, shton Gita, nëse mund të meditojnë mbi Krishnën – do të shkojnë te “qëllimi më i lartë”. Duke hequr dorë nga trupi në gjendje të samadhi-t, e arrijnë përjetësinë mistike që është bashkimi me Krishnën.

Në këtë kapitull Gita aludon në dy rrugët: “veriore” dhe “jugore”, që mund t’i marrë shpirti pas vdekjes. Vargjet 24–25:

²⁴ Gjashtë muajt e shtegut verior të diellit, shtegut të dritës, të zjarrit, të ditës, të dyjavëshit të ndritshëm, i çojnë njohësit e Brahmanit te qëllimi suprem.

²⁵ Gjashtë muajt e shtegut jugor të diellit, shtegut të tymit, të natës, të dyjavëshit të errët, i çojnë shpirtrat e tjerë te drita e hënës dhe te rilindja.

e paraqesin në formë të shkurtuar atë që Brihadaraniaka Upanishad e përshkruan në detaje të turbullta:

Ata që e dinë këtë, që meditojnë mbi Të Vërtetën me besim gjersa jetojnë në pyll, shkojnë te drita, nga drita te dita, nga dita te dyjavëshi i rritjes së hënës, nga dyjavëshi i rritjes te gjashtë muajt e udhëtimit verior të diellit, nga ata gjashtë muaj te bota e deva-ve, nga bota e deva-ve te dielli, nga dielli te rrufeja. Pastaj një shpirt u afrohet dhe i çon në botën e Brahmanit. Në atë botë jetojnë për epoka të përhershme. Nuk kthehen më.

Por ata që i pushtojnë botët përmes flijimit, bamirësisë dhe masave shtrënguese kalojnë nëpër tym, nga tymi në natë, nga nata në dyjavëshin e hënës që zbehet, nga dyjavëshi i hënës që zbehet në gjashtë muajt e udhëtimit jugor të diellit, nga aty në botën e para-ardhësve, nga bota e para-ardhësve te hëna, . . . dhe nga aty në rilindje. (Brihadaranjaka Upanishad VI.2.15–16).

“Shtigjet veriore dhe jugore” i referohen shtegut të diellit, që si duket lëviz kah veriu pas solsticit dimëror dhe kah jugu pas solsticit veror. Të vdesësh gjatë periudhës në të cilën dielli po lëviz kah jugu konsiderohej e pafat; të vdesësh gjatë periudhës pas solsticit dimëror, kur dielli po kthehet kah veriu, nënkuptonte se shpirti mund ta mirrte rrugën veriore që të çon në pavdekësi. Në Gita dhe Upanishade, kjo “rrugë veriore” është zhvilluar në nënkuptimin se shpirti është çliruar nga karma dhe nuk ka nevojë të rilindë. Rruga jugore, përkundrazi, e çon shpirtin në një lindje të re në këtë botë, lindje e përshtatshme me karmën e tij. Kjo pamje e udhëtimit të shpirtit pas vdekjes ka cilësi primordiale në lidhje me të, duke e dhënë ndjesinë se ekziston shumë më moti madje edhe se Upanishadet. Mbase është besim i kohëve shumë të lashta që e gjeti rrugën e vet deri te Upanishadet, që thonë se shpirti që është i gatshëm shpirtërisht e bën udhëtimin e rrugës veriore gjersa ata që vetëm i kanë praktikuar ritualet e marrin jugorin.

Ky kapitull aludon shkurtimisht edhe në Ditët dhe Netët e Brahmës. Brahma është Krijuesi i trinitetit hindu, që e prodhon kosmosin me vullnetin e Vishnu-s. Por Brahma në njëfarë kuptimi nuk e ka nën kontroll këtë proces krijues. Siç e ndjek dita natën në ritëm të përhershëm, të pandryshueshëm, ashtu i tërë universi i nënshtrohet cikleve të krijimit, vdekjes dhe lindjes së re. Gjersa agon Dita e Brahmës, kosmosi vjen në qenie; gjersa Dita i afrohet fundit, i tërë krijimi vdes dhe pushon së ekzistuari. Pastaj, për një Natë të gjatë sa Dita kozmike, universi pushon. Pushon të jetë – apo, më saktë, vazhdon veç në formë subtile, të pamanifestuar, ëndërr në mendjen e Vishnu-së, që rri i shtrirë duke fjetur në valët e oqeanit kozmik. Pastaj, pa devijuar nga ritmi i përhershëm, kosmosi rilindet kur të kryhet Nata. Agon universi i ri, dhe Brahma edhe një herë kalon në Ditën e tij aktive, krijuese.

Studiuesit e kanë vërejtur se ky vizion madhështor i kozmosit që lind, vdes dhe rilind për përherë – kozmos pas kozmosi që del nga hapësira e pafund e asgjësisë – është goxha i ngjashëm me teoritë moderne të universit zgjerues e tkurrës të paraqitura nga kozmologjia bashkëkohore. Periudhat e mëdha kohore të pranuar nga fizika e sotme janë po ashtu të ngjashme me Ditët dhe Netët kozmike të Brahmës. Secila Ditë zgjat një mijë joga, që është baraz me 4,320,000,000 vjet. Për këtë pothuajse-përjetësi kohore universi jeton dhe rritet; pastaj vdes dhe qëndron i fjetur për një kohë të barabartë, para se të agojë Dita e re.

Megjithatë, është një gjendje e qenies që është më e lartë se kozmosi i prishshëm, që nuk lindet dhe nuk e vdes vdekjen kozmike. Këtu (8:20):

Por përtej kësaj gjendjeje të paformë është një realitet tjetër, i pamanifestuar, që është i përhershëm dhe nuk shpërbëhet kur shkatërrohet kozmosi.

quhet thjesht *aviakta*, E Pamanifestuara. Ky është qëllimi suprem i të gjitha gjërave të gjalla, dhe është shtëpia e Krishnës (8:21):

Ata që e kuptojnë intuitivisht qëllimin suprem të jetës e dinë se jam i pamanifestuar dhe i pandryshueshëm. Duke pasë ardhur në shtëpi tek unë, nuk kthehen kurrë në ekzistencë të veçuar.

Duke u kthyer në këtë vend përfundimtar të pushimit, shpirti hyn në lumturinë e pavdekshme dhe nuk rilindet.

– D. M.

Kapitulli nëntë: Rruga mbretërore

KY KAPITULL E LAVDËRON KRISHNËN si Qenia Supreme që e ka krijuar botën dhe rri i kudondodhur në krijimin e tij. Theksohet natyra e lartësuar e Krishnës, dhe u jepet paralajmërim atyre që mendojnë se Zoti është i kufizuar në krijimin e tij. Është e vërtetë se Krishna ka marrë formë njerëzore, por ata që e shohin veç një qenie të kufizuar njerëzore dhe i shfaqin mungesë respekti po i sjellin vetes dëm të madh shpirtëror. Këto vargje përmbajnë paralajmërim për ata që do ta nënvlerësonin fuqinë hyjnore të Krishnës.

Në këtë kapitull Krishna i zëvendëson shumë perëndi e perëndesha të panteonit të zakonshëm hindu, ku secili përfaqëson fuqi të ndryshme hyjnore; këtu Krishna shihet si ai që i përmban brenda vetes të gjitha këto fuqi. Është Krishna dhe veç Krishna që duhet të adhurohet: ai është qëllimi, mbështetja, streha e vetme, miku i vetëm i vërtetë; ai është fillimi dhe fundi (9:18):

Unë jam qëllimi i jetës, Zotëruesi dhe mbështetja e të gjithëve, dëshmitari i brendshëm, vend-banimi i të gjithëve. Unë jam strehimi i vetëm, miku i vetëm i vërtetë; unë jam fillimi, të qëndruarit,^a dhe fundi i krijimit; unë jam mitra dhe fara e përhershme.

Rrjedh se ata që praktikojnë fe rituale, duke i ofruar flijimet rituale të përcaktuara nga Vedat, nuk e arrijnë qëllimin e vërtetë të jetës së tyre. E vërtetë, e gëzojnë parajsën pas vdekjes. Por kur rezerva e meritave të tyre harxhohet, linden përsëri ashtu që ta kenë një mundësi tjetër për t'u larguar nga përfitimi personal dhe për ta synuar qëllimin suprem të jetës. Përderisa janë të motivuar veç nga meraket e vetë-qendëruara duhet të linden përsëri e përsëri, dhe evolucioni i tyre shpirtëror ose rri pa lëvizur ose bëjnë përparim shumë të vogël.

Megjithatë, edhe këta shpirtra, realisht po e adhurojnë Krishnën, megjithëse nuk e dinë këtë. Ata e kërkojnë Krishnën, Qenien Supreme, në të gjitha bredhjet e tyre nëpër shumë e shumë jetë dhe madje edhe në qëndrimet e tyre në parajsë, ku e gëzojnë shpërblimin e veprave të tyre të mira. Mirëpo, për shkak se nuk e njohin natyrën e tij reale, nuk do ta arrijnë qëllimin, por do të rilinden.

Një xhiro e pafund e rilindjeve mund të duket si mallkim i gjallë i shpirtit që mundohet fort – shënim i ashpër që do të ishte jokarakteristik për Gitën. Por kjo

^a të rrish

nuk është çështje e mallkimit. Destinimi i jetës është të kuptohet intuitivisht Zoti, dhe deri kur të bëhet kjo, shpirti nuk mund t'i ikë krijimit të më shumë karme që duhet të përpunohet, sado jetë që mund të marrë. Zgjedhja për t'u kthyer kah Kuptimi Intuitiv i Vetes është gjithmonë e hapur.

Megjithatë, Gita nuk ndalet te pengesat, por vazhdon shpejt ta zbulojë natyrën më dashamirëse të Krishnës. Ajo e thekson poentën se çkado që ka merak thellësisht një person – çkado që ai apo ajo adhuron – përfundimisht do të arrihet, në një jetë apo një tjetër. Në veçanti, të kesh dashuri reale, pa-veten, pavarësisht objektit, është ta duash Krishnën, të mirën vendimtare. Ky lloj i dashurisë, i quajtur *bhakti*, është shumë më i fuqishëm se sa ritet dhe ritualet – poentë që Gita po e zbulon ngadalë. Por ta kesh këtë përkushtim pa e kuptuar natyrën e Krishnës nuk mjafton. Në fund, për ta arritur qëllimin e tij, Arxhuna duhet të ketë përkushtim dhe ta kuptojë se është aspekti universal i Krishnës të cilin e do ai. Pastaj ai do ta arrijë vërtet gjendjen e përhershme, të pavdekshme.

Ky kapitull e përmban një seri të famshme dhe shumë të njohur të vargjeve:

Çkado që bën, bëje ofertë flijuese për mua – ushqimin që e ha, flijimet që i bën, ndihmën që e jep, madje edhe vuajtjen tënde. Kështu do të çlirohesh nga skllavëria e karmës, dhe nga rezultatet e saj, edhe të këndshmet edhe të dhembshmet.

(9:27–28)

Krishna e pranon çdo ofertë flijuese që i bëhet në frymën e duhur; ai e siguron Arxhunën për këtë. Pastaj kërkon nga Arxhuna të bëjë gjithçka – çdo veprim, çdo racion të ushqimit, çdo flijim, çdo dhuratë, madje edhe vuajtjet e tij – ofertë flijuese për Zotin. Ai e kërkon këtë që Arxhuna të mund të çlirohet nga skllavëria e karmës. Ky është theks i ri, rrugë e re. Nëse Arxhuna mund të jetojë në bashkim të plotë me vullnetin e Krishnës, duke bërë gjithçka veç për Krishnën, atëherë pikërisht nga ajo pastërti e vullnetit do të çlirohet nga motivet vetjake dhe kështu do të çlirohet nga karma. Shpirti i tij do të jetë i lirë, dhe ai do ta arrijë qëllimin e tij të bashkimit mistik me Krishnën.

Krishna deklaron se është i paanshëm ndaj të gjitha krijesave: ai as nuk e favorizon as nuk e refuzon askë. Është dashuria e tyre e sinqertë ajo që është e rëndësishme. Ata që janë vërtet të përkushtuar ndaj Krishnës jetojnë në të dhe ai rri në ta. Me njëfarë guximi, me gjasë me rrezikun e shqetësimit të atyre që janë

më ortodoksë,^a Krishna shton se edhe një mëkatar që strehohet me gjithë zemër në të bëhet i mirë. Fjala e përdorur është *sadhu*, që fjalë për fjalë domethënë person i mirë por në ndërkohë e nënkupton atë që çon jetë shpirtërore, duke hequr dorë nga tërë meraket vetjake për ta arritur qëllimin përfundimtar. As fjala për mëkatar, *suduraçara*, nuk duhet të shpërfilllet. *Su* është fjalë për fjalë “mirë”; *dur* është “keq”: pra “ai sjellja e të cilit është vërtet e keqe”, siç do të thoshim “bukur nxehtë” për të nënkuptuar vërtet nxehtë.

Krishna premton se ata që i përkushtohen duhet ta arrijnë paqen përfundimisht. Askush që ka dashuri dhe përkushtim të çiltër nuk mund të shuhet. Kuptimi këtu merret të jesh “i shuar” në kuptimin shpirtëror, të pësosh dëm shpirtëror. Mesazhi i këtij kapitulli është i thjeshtë. Nuk përmban filozofi dhe ka veç pak teologji. Mesazhi i vetëm është: kushdo që ka dashuri reale, dashuri për Zotëruesin e Dashurisë i cili është në të gjitha krijesat, në fund do ta arrijë qëllimin. Kjo është fshehtësia mbretërore që Krishna kishte premtuar ta zbulonte.

– D. M.

^a në kuptimin më të bindur ndaj besimeve dhe praktikave tradicionale fetare (shënim i shqipëruarit).

Kapitulli dhjetë: Bukuria madhështore hyjnore

Krishna shkon më thellë në zbulimin e qenies së tij hyjnore duke e zbuluar veten si burimi nga i cili vijnë të gjitha gjërat, Ai Njëshi që është realiteti prapa të shumtëve. Megjithëse burimi i të gjitha virtyteve, ai është edhe realiteti vendimtar që i transcendon^a të gjitha të kundërtat. Kështu ai është edhe lumturia edhe vuajtja, vdekja dhe jeta, qenia dhe joqenia. Si Brahmani i Upanishadeve, ai është përtej dualitetit, krejtësisht përtej kategorive kufizuese të gjërave të kësaj bote. Natyra e tij e vërtetë është përtej mundësive të mendimit. Ai mund të njihet veç në gjendjen e samadhit, ku njohësi dhe e njohura bëhen një.

Arxhuna e quan Krishnën *Purushottama*, “Purusha suprem, Personi suprem”. Krishna tani nuk është karrocier njerëzor, por Bhagavani, “Zotëruesi jashtëzakonisht bujar”; dhe Arxhuna, duke e lënë prapa personazhin e tij luftëtar, tash rri i zbuluar si kërkues i të vërtetës. Me kërkesën e Arxhunës, Krishna tani i zbulon disa nga fuqitë dhe atributet (*vibhuti-t*) e tij hyjnore.

Nga kjo pikë e tutje kapitulli bëhet i vështirë për shkak të shumë emrave të panjohur që përmenden. Në çfarëdo kategorie, Krishna është kryesori, më i miri, më intensiv, më i bukuri, më mbresëlënësi, esenca. Shumë nga aludimet do të jenë të njohura – për shembull, ndër lumenjtë Krishna është Gangu. Por shumë nga emrat vijnë nga mitologjia hindu dhe nuk janë të njohur. Këtu nuk ka hapësirë për ta shpjeguar secilin emër, por paragrafët vijues do t’i theksojnë disa të rëndësishëm.

Së pari, Krishna është Atmani, Vetja e brendshme në të gjitha qeniet. Është me vend të përmendet kjo e para, se nga të gjitha manifestimet e tij të shumta ky është më i rëndësishmi, të paktën për aspirantin shpirtëror që përpiqet fort – që është Arxhuna. Krishna është Vetja më e brendshme e Arxhunës, dhe kështu duhet të njihet ai në reflektim. Nga të gjitha format në të cilat duhet të meditohet mbi Krishnën, Atmani përmendet i pari.

Krishna është Vishnu, Zoti i madh dashamirës, kultivues i besimit hindu. Është Vishnu që i interesojnë kaq shumë vuajtjet e Nënës Tokë dhe fëmijëve të saj sa që vjen në tokë përsëri e përsëri, epokë pas epoke, për ta lehtësuar shtypjen dhe për ta ripërtërirë drejtësinë.

Krishna është dielli, i adhuruar në Indi që nga kohërat e lashta. Ai është Indra, kreu i zotave Vedikë, zotëruesi i stuhisë dhe i betejës, që e hedh rrufenë kundër armiqve të zotave. Në fenë Vedike ai është zotërues i fuqishëm, me të cilin nuk

^a tejkalon

bëhet shaka, por më vonë ai duhet ta pranojë humbjen nga duart e Krishnës, që i mbron njerëzit nga zemërimi i stuhishëm i Indrës.

Krishna është edhe Shankara, aspekti më ndihmëtar i hyjnisë mahnitëse Rudra, që njihet më shumë si Shiva. Ndër malet Krishna është Meru, shtëpia e lartë malore e Shivës dhe e zotave të tjerë, maja më e lartë dhe qendra e botës. Krishna është vetëdija, rrokja *Om*, dhe mantra apo emri i shenjtë. Ai është kali mitik dhe elefanti përrallor që u prodhuan kur oqeani kozmik shpërtheu për eliksirin e pavdekësisë.

Krishna është Ananta, gjarpri kozmik në të cilin fle Zotëruesi Vishnu. Ai është Varuna, zoti Vedit i oqeanëve dhe Jama, zoti i vdekjes; ndër demonët (*asuras*) ai është Prahlada, që, megjithëse i lindur në racën e demonëve, ishte i përkushtuar ndaj Zotit dhe kurrë nuk u lëkund në dashurinë e tij, madje edhe kur babai i tij u përpoq ta vriste. Dhe natyrisht Krishna është Rama, princi i madh luftëtar – po ashtu mishërim i Vishnu-s – bëmat e të cilit tregohen në epin e pavdekshëm, *Ramaiana*.

Nga të gjitha fushat e njohjes, thotë Krishna, ai është njohja e Vetes. Studimet e sanskritishtes dhe të gramatikës së saj ishin të rëndësishme në Indinë e lashtë dhe Krishna nuk e neglizhon këtë fushë. Ai është *A*-ja ndër shkronjat; ndër fjalët e përbëra është *dvandva*, që i bashkon të barabartat. Ai është Gaiatri – metrikë e veçantë që gjendet në poemat e Vedave, por përgjithësisht merret të jetë një lutje e famshme nga Rig Veda (III.62.10) e komponuar në atë metrikë, që është kënduar çdo mëngjes nga adhurues të panumërt për tre mijë vjet.

Është e përshtatshme që ndër stinët Krishna është pranvera, stina e luleve. Më pak i lehtë për t'u kuptuar është pohimi i tij se është kumari i kumarxhive. Krishna ka sens të lojës, dhe meqë kumari është obsesioni i kumarxhiut, duket natyrale që Krishna mund ta pohojë këtë si *vibhuti*. Po ashtu, në Indinë e lashtë kumari konsiderohej argëtim mbretëror, dhe asnjë mbret me reputacion nuk do ta refuzonte një lojë miqësore me zare.

Në sferën njerëzore, krishna është “djali i Vasudevës”, princ i linjës Vrishni – me fjalë të tjera, forma njerëzore që është miku dhe karrocieri i Arxhunës. Ai është edhe Arxhuna! Dhe ai është Viasa, komponuesi i Gitës – në të vërtetë, i tërë *Mahabharatës*.

Kudo që Arxhuna gjen forcë, bukuri apo fuqi, konkludon Krishna, ai duhet ta njohë atë si diçka që vjen nga një shkëndijë e lavdisë së Krishnës. Pastaj, pasi e dërrmon Arxhunën me këtë listë jashtëzakonisht impresive të fuqive dhe zbulesave hyjnore, Krishna pyet me rehati joformale: “Po çfarë dobie ka t'i dish

të gjitha këto detaje? Fakti i rëndësishëm është ta dish se unë jam, dhe se një pjesë e vockël e qenies sime i mbështet të gjitha gjërat.”

– D. M.

Kapitulli njëmbëdhjetë: Vegimi kozmik

Ky është kapitulli më i lartësuar i tërë Gitës, se këtu Arxhuna e sheh vegimin (vizionin) hyjnor të Krishnës në natyrën e tij të plotë si vetë Zoti, Zotëruesi i Universit. Është vështirë të shihet në fillim se pse vegimi vendimtar shpirtëror duhet t'i jepet Arxhunës në këtë pikë. Duhet ta kujtojmë se Krishna dhe Arxhuna kanë qenë bashkudhëtarë për shumë jetëra. E megjithatë në hapjen e Gitës, Arxhuna është luftëtar, jo fort i interesuar për vegime mistike. Hap pas hapi Krishna e ka çuar atë drejt një kuptimi të destinimit të vërtetë të jetës së tij – ta njohë se kush është dhe ta njohë edhe se kush është Krishna. Në kapitullin e fundit, Krishna e kishte arritur pikën ku ishte i gatshëm t'ia zbulonte Arxhunës manifestimet e fuqisë hyjnore. Arxhuna jo veç që kishte pyetur për këto fuqi, por madje edhe kishte dashur ta dinte se në çfarë forma do të mund të meditonte mbi Krishnën – hera e parë që Arxhuna kishte folur për reflektimin.

Tash, në kapitullin 11, Arxhuna kërkon ta shohë Krishnën siç Ai është realisht. Meraku i tij plotësohet dhe në esencë pjesa e mbetur e kapitullit e përshkruan samadhi-n e Arxhunës. *Samadhi* është fjala e përdorur nga Patanxhali në veprën e tij klasike *Joga Sutras*, për ta përshkruar fazën përfundimtare në meditim, në të cilën mendja është plotësisht e përqendruar dhe në lojë hyn një mod/mënyrë e mbivetëdijshme e njohjes. Patanxhali flet për shumë lloje të ndryshme të samadhi-t, por për qëllime praktike mund të flasim për dy: *savikalpa* dhe *nirvikalpa*. Vegimi i Arxhunës nis me *savikalpa* damadhi, në të cilën ai e sheh Zotin në manifestim personal. Pastaj, gjersa kalon nëpër *nirvikalpa* samadhi, Arxhuna i sheh të gjitha format duke u zhdukur në Zotin, deri kur mbetet veç një zjarr i mbinatyrshëm që e konsumon tërë botën fenomenale.

Ky vegim suprem e mahnit Arxhunën me bukurinë madhështore verbuese të njëmijë diejve. Mistikët shpesh i kanë përshkruar përjetimet e tyre në terma të dritës. Në një lutje të lashtë të Vedës, poeti kërkon që urtia hyjnore të agojë në zemrën e tij siç lind dielli në qiell. Dhe në Perëndim kemi dëshmi të panumërta si ajo e Shën Terezës së Avilës:

Kur shpirti shikon në këtë Diell Hyjnor, shkëlqimi e verbon nga mrekullimi atë... Dhe shumë shpesh mbetet plotësisht i verbër, i përthithur, i mahnitur dhe i çuditur nga tërë mrekullitë që i sheh.

Gjersa ky vegim nis të shpaloset, Arxhuna e sheh tërë botën në trupin e Krishnës dhe e nis një himn të lëndit. Ai e sheh Krishnën si Vishnu me armët e tij tradicionale, topuzin dhe diskun, dhe duke e mbajtur një kurorë.

Gjersa vegimi bëhet më intensiv, Arxhuna nis të ndihet i frikësuar. E sheh dritën e Zotit të bëhet zjarr që digjet për t'i konsumuar të gjitha gjërat, sikur në fundin e kohës. Të gjithë luftëtarët në fushën e betejës janë të vdekshëm dhe Arxhuna i sheh të asgjësuar, duke u djegur në zjarrin universal. Të gjitha krijesat nxitojnë drejt shkatërrimit si fluturat e natës në zjarr. Rrezatimi i Zotit është edhe dritë e madhe edhe zjarr djegës.

I tmerruar, Arxhuna dëshiron ta njohë identitetin e këtij Zoti mahnitës, që nuk ka kurrfarë ngjashmërie tani me Krishnën që e kishte njohur si mësuesin dhe mikun e tij. Në përgjigje të pyetjes: “Kush je ti?” përgjigja e Krishnës është vargu (11:32)

Unë jam koha, shkatërruesi i të gjithave; kam ardhur ta konsumoj botën. Madje edhe pa pjesëmarrjen tënde, të gjithë luftëtarut e mbledhur këtu do të vdesin.

që shpërtheu në mendjen e Robert Oppenheimer-it kur e pa bombën atomike të shpërthejë në Trinity në verën e vitit 1945: “Jam bërë Vdekja, shkatërruesi i botëve. . .” Por fjala *kala* domethënë jo veç vdekje por kohë, që dikur i gllabëron të gjitha.

Arxhuna është trim dhe i denjë për këtë vegim, se nuk e humb vetëdijen apo të kolapsojë plotësisht mendërisht. Ai e lavdon Krishnën dhe pastaj kërkon falje nëse gjatë miqësisë së tyre të gjatë ka thënë apo ka bërë ndonjëherë ndonjë gjë për ta ofenduar Zotëruesin duke e ngatërruar me qenie të thjeshtë njerëzore. Përfundimisht, vegimi është i tepërt për Arxhunën. Megjithëse e përjeton paqen e thellë edhe ezimin e thellë të samadhit, është i tmerruar njëkohësisht. Dëshiron ta shohë fytyrën më njerëzore të Zotit.

Krishna ia plotëson merakun dhe kthehet në aspektin e tij të butë, normal. I tregon Arxhunës se sa shumë vështirë është ta shohësh atë në formën e tij të lartësuar si Zotëruesin e Jogës, Zotin e zotave. Veç përkushtimi i pastër e arrin këtë vegim. Kjo temë i dominon kapitujt e mbetur të Gitës: është përkushtimi që është më i rëndësishmi në kërkimin shpirtëror.

Kapitulli dymbëdhjetë: Rruga e dashurisë

Ky kapitull i shkurtër fokusohet në rëndësinë supreme të përkushtimit dhe të besimit në zhvillimin shpirtëror. Këtu dashuria, apo përkushtimi personal, është motivimi më i fuqishëm në jetën shpirtërore.

Fetë e mëdha të botës pajtohen në këtë pikë. Të gjitha fetë e lejojnë një mënyrë të përkushtimit, dhe miliona burra e gra kanë gjetur përmbushje shpirtërore në përkushtimin ndaj Krishtit, Buddhës apo Muhamedit. Hinduizmi e ka lejuar një vend për rrugën e dijes si dhe rrugën e përkushtimit; megjithatë, këtu Gita e thekson efikasitetin e përkushtimit.

Upanishadet, fjala e fundit mbi përjetimin mistik e thënë nga Vedat, e theksonin realitetin vendimtar, të vërtetën e përhershme prapa gjërave kalimtare të kësaj bote. Mësuesit e Upanishadeve u thoshin studentëve të vet ta kërkonin njohjen e Atmanit, Vetes së tyre të vërtetë. Përthithja e kësaj njohurie ishte ta dish se Vetja përbrenda ishte një me Brahmanin, realitetin vendimtar që i përshkon të gjitha gjërat. Kjo ishte përmbledhur në formulimin *Tat tvam asi*, “Ti je ajo” – ajo qenia e pashueshme, ai Realitet i pavdekshëm. Brahmani, Esenca e paemër, e paformë e Zotit, do të mund të njëhej veç në gjendje të mbivetëdijshme.

Gita largohet nga kjo qasje e tillë ndaj fesë. Se siç thotë Krishna, kërkimi i një Esence të përhershme, të papërkufizueshme, të fshehur të Zotit është goxha e vështirë për personin mesatar (apo edhe mbi-mesatar). Në fakt, në këtë kapitull thuhet se është praktikisht përtej mundësive të të gjitha “qenieve të mishëruara” (*dehavat*, “ata që kanë trupa”). Kjo rrugë e urtisë mund të jetë thjesht tepër “shpirtërore” për fëmijët e tokës, sepse atyre që identifikohen në një shkallë të madhe me natyrën e vet fizike – rruga e njohjes u duket tepër e pjerrët për t’iu ngjitur. Mund t’i drejtohem njërit nga ndjekësit perëndimorë të kësaj rruge për ta parë pse; ky është Dionisi i Areopagtit, murg i krishterë i shekullit të pestë, që tingëllon çuditërisht si vargjet 3–4 pikërisht të këtij kapitulli:

Dionisi i Areopagtit:

Pastaj, përtej tërë dallimit ndërmjet njohësit dhe të njohurës, aspiranti bëhet i shkrirë në Realitetin e paemër, të paformë, tërësisht i zhytur në Atë që është përtej të gjitha gjërave dhe në asgjë tjetër. . . . Pasi e ka prehur intelektin dhe mendjen e vet, ai është i bashkuar përmes zotësisë së tij më të lartë me Atë që është përtej tërë njohjes.

Vargjet 3–4:

³ Sa për ata që e kërkojnë Realitetin transcendental, pa emër, pa formë, duke reflektuar për Të Pamanifestuarën, përtej mundësive të mendimit dhe të ndjenjës, ⁴ me shqisat e tyre të nënshtruara dhe mendejn të qetë dhe duke u përpjekur për të mirën e të gjitha qenieve, edhe ata vërtet do të vijnë tek unë.

Fatmirësisht ekziston rruga e dashurisë; se kur Zoti duhet (e duam) në aspekt personal, rruga është jashtëzakonisht më e lehtë. Sipas shkrimeve të shenjta hindu, Zoti mund të duhet (ta duam) si baba i plotmëshirshëm, si nënë hyjnore, si mik i urtë, si person i dashur pasionant apo edhe si fëmijë ngatërrestar.

Mund t’u drejtohem mistikëve të krishterë për ndihmë këtu, se shumica nga ta e kanë ecur rrugën e dashurisë. Vepra e krishterë mesjetare e quajtur *Reja e panjohjes* thotë se dashuria është rruga e sigurt dhe e garantuar për te Zoti: “Përmes dashurisë Ai mund të merret e të mbahet, përmes mendimit kurrë.” Në një pasazh të njohur në Dhiatën e Re, Shën Pali e vë dashurinë mbi njohjen dhe madje mbi fuqitë çudibërëse: “Por do t’jua jap një rrugë më të shkëlqyeshme. . . . Dashuria nuk dështon kurrë. Por po pati profecira, do të dështojnë. Po pati gjuhëra [goje], do të ndalen. Po pati njohje, do të zhduket”. Dhe Shën Gjoni i Kryqit tregon përmbledhur pse shumicës dërmuese të qenieve njerëzore u duket më lehtë t’i tejkalojnë dobësitë e tyre përmes dashurisë se përmes dijes:

Në mënyrë që t’i mposhtim meraket tona dhe të heqim dorë nga të gjitha ato gjëra, për të cilat dashuria dhe prirja jonë e kanë zakon ta ngjallin vullnetin që kënaqet në to, kërkojmë zjarr më të flaktë dhe dashuri më fisnike – atë të Dhëndrit. . . . po të mos përflakej natyra jonë shpirtërore me pasione të tjera dhe më fisnike, kurrë nuk do të duhej ta flaknim zgjedhën kufizuese të shqisave.

Por një dashuri e tillë shpesh nuk është e disponueshme në shpirtin që përpiqet fort, madje as në atë si Arxhuna. Kështu që Krishna thotë se nëse Arxhuna nuk është në gjendje ta fokusojë përkushtimin e tij, duhet të mësojë ta bëjë këtë përmes praktikës së rregullt të meditimit. Madje edhe dashuria dhe përkushtimi mund të kultivohen përmes praktikës së rregullt; ato nuk duhet të konsiderohen si forca misterioze, dhurata hyjnore të shpirtit.

Nëse madje edhe përpjekja për stërvitje të rregullt do të dështonte, Krishna ende nuk është gati ta lërë Arxhunën ta pranojë disfatën. Ai duhet, thotë Krishna, të punojë me vetëmohim pa merak për frytet e punës së tij. Por paqja e vërtetë e mendjes vjen veç nga heqja dorë. Fjala *tiaga* këtu si duket nënkupton heqje dorë apo braktisje të vetë-vullnetit më shumë se gjithçka tjetër. Vetë-dorëzimi i tillë mund të jetë zgjidhja e fundit, por nëse është e çiltër sjell paqe të menjëhershme.

Vargjet 13-20 i përshkruajnë karakteristikat e atij që e do çiltërsisht Zotin:

¹³ E dua atë që është i pa-aftë për keqdashje, që është miqësor dhe dashamirës i dhembshur. Ata që jetojnë përtej asaj që e mbërrin Unë-i dhe imja dhe që e mbërrin kënaqësia dhe dhembja, ¹⁴ të durueshëm, të kënaqur, që e kontrollojnë veten, të qëndrueshëm në besim, që më janë dhënë me tërë zemrën e vet dhe mendjen e vet – me të tillët si këta jam i dashuruar.

¹⁵ Duke mos e trazuar botën as duke mos u trazuar nga ajo, qëndrojnë mbi ndikimin e ngazëllimit, të konkurrencës dhe të frikës: ai është i dashuri i m.

¹⁶ Ata janë të shkëputur, të pastër, efikasë, të paanshëm, asnjëherë të shqetësuar, pa-veten në të gjitha ndërmarrjet e tyre; ata janë të përkushtuarit e mi, shumë të dashur për mua.

¹⁷ I dashur për mua është ai që nuk vrapon pas të këndshmes apo të ikë nga e dhembshmja, që nuk pikëllohet, nuk e pshon, por i lë gjërat të vijnë e të shkojnë siç ndodhin.

¹⁸ Ai i përkushtuar që e shikon mikun dhe armikun në mënyrë të njëjtë, që nuk inkurajohet nga lavdërimi as nuk zhgënjehet nga fajësimi, njësoj në nxehtë dhe në ftohtë, kënaqësi dhe dhembje, i lirë nga të lidhurit vetjak, ¹⁹ i njëjti në nderim dhe çnderim, i qetë, gjithnjë i plotë, në harmoni kudo, i qëndrueshëm në besim – i tilli është i dashur për mua.

²⁰ Ata që meditojnë mbi këtë dharmë të pavdekshme siç e kam deklaruar, plot besim dhe duke më kërkuar mua si qëllimin suprem të jetës, janë vërtet të përkushtuarit e mi, dhe dashuria ime për ta është shumë e madhe.

Një person i tillë i shenjtë, thekson Krishna, është shumë i dashur [nga Krishna] dhe i shtrenjtë për vetë Krishnën.

– D. M.

Kapitulli trembëdhjetë: Fusha dhe njohësi

Ky kapitull na njofton me dy kategori të gjera: “fusha” dhe “njohësi i fushës”. Për ta thjeshtuar, mund të mendojmë për fushën si trupi dhe për njohësin e fushës si Vetja që rri në trup. Ky kapitull, pra, ka të bëjë me dualitetin ndërmjet “shpirtit dhe trupit”. Ky dualitet shihet si i përhershëm, ndarje themelore e të gjitha gjërave – koncept themeltar i shtjelluar në filozofinë Sankhia.

Thamë se “fusha” është trupi, por kjo nuk është mjaft e saktë. Fusha e përfshin edhe mendjen: në fakt, i përfshin të gjithë përbërësit e prakritit, duke e përfshirë *ahamkara*-n – vetëdijesinë që e ka secili nga ne se jemi ego individuale, nga *aham* “unë” dhe *kara* “bërës”. Ahamkara është vetëdijësia themelore e veçimit: ajo që më bën “unë”, qenie të ndarë nga pjesa tjetër e krijimit. Në këtë kuptim të gjerë fusha përfshin gjithçka, përveç vetëdijes së pakuptueshme intuitivisht që “e njeh” fushën. Fusha është objekti; njohësi është subjekti. Krishna është njohësi i fshehur i fushës: domethënë, Vetja.

Ky termi “fusha” është çuditërisht modern, se e përshkruan atë që sot do të mund ta quanim zgjerim i kontinuumit të masës, energjisë, kohës dhe hapësirës për t’i përfshirë edhe shtresat e mendjes – me fjalë të tjera, fushë e forcave edhe fizike edhe mendore. Ashtu si fizika që nuk i konsideron më materien dhe energjinë si esencialisht të ndara, Gita nuk do ta konsideronte materien dhe mendjen të ndara; ato janë aspekte të ndryshme të prakritit, “lëndës” që është nën ekzistencën.

Një dimension tjetër i përdorjes së fjalës “fushë” nxirret nga një anekdotë tradicionale hindu. E pyesin një *sadhu* apo njeri të shenjtë endacak se cila është puna e tij në jetë; ai përgjigjet: “Jam bujk.” Kur pyetësi duket i habitur, ai shton: “Ky trupi im është fusha ime. Mbjelli mendime dhe veprime të mira, dhe në trupin tim i korr rezultatet.” Buddha shpjegon: “Gjithçka që jemi është rezultat i asaj që e kemi menduar: është themeluar në mendimet tona; është bërë nga mendimet tona.” Ajo që e mendojmë, bëhemi, se siç thotë Emersoni, para-ardhësi i çdo veprimi është një mendim. Kështu mendimet tona, të marrura së bashku, japin fryte në veprimet, vendimet dhe meraket që i formësojnë jetët tona. Pjesërisht, trupi e jep frytin e asaj që e mendojmë për aq sa mënyra jonë e të menduarit ndikon në shëndetin dhe sigurinë tonë fizike. Por në kuptim më të gjerë, e tërë fusha e aktivitetit njerëzor (në të vërtetë tërë prakriti) është edhe “fushë e karmës” – ku, për shembull, ambienti global formësohet nga shuma e asaj që e bëjnë banorët e tij, që në anën tjetër formësohet nga mënyra se si mendojnë. Kjo ide do të rikthehet dhe shtjellohet detajisht në kapitujt përmbyllës të Gitës.

Vargjet 7–11 pastaj e përshkruajnë personin që e kupton natyrën e vet të vërtetë.

⁷ Ata që dinë vërtet[,] janë të lirë nga krenaria dhe mashtrimi. Janë të butë, falës, të drejtë dhe të pastër, të përkushtuar ndaj mësuesit të tyre shpirtëror, të mbushur me forcë të brendshme, dhe e kontrollojnë veten. ⁸ Të shkëputur nga objektet shqisore dhe vetë-vullneti, e kanë mësuar mësimin e dhembshëm të lindjes së veçuar dhe vuajtjes, të pleqërisë, të sëmundjes dhe të vdekjes.

⁹ Të lirë nga të lidhurit vetjak, nuk ngatërrohen në mënyrë të pakontrollueshme madje as në shtëpi dhe familje. Janë me mendje të njëtrajtshme nëpër fatin e mirë dhe të keq. ¹⁰ Përkushtimi i tyre ndaj meje është i pashkëputur. Duke e shijuar vetminë dhe duke mos e ndjekur turmën, më kërkojnë veç mua. ¹¹ Kjo është dije-njohje e vërtetë, ta kërkoh Vetën si qëllimin e vërtetë të urtisë gjithmonë. Të kërkoh çkado tjetër është padituri.

Ky është përshkrim tërheqës i personit modest, vërtet të urtë që e kontrollon jetën e vet. Një rrjedhim i këtyre vargjeve është se është goxha arritje të kuptohet dallimi ndërmjet fushës dhe Vetes, njohësit. Shumica e njerëzve i ngatërrojnë ato, duke e marrë trupin dhe mendjen se janë ata që janë. Në rrjedhën e zakonshme të ngjarjeve, mund të jemi plotësisht të pavetëdijshëm se është një Vete, një vetëdijesi nën vetëdijen sipërfaqësore të një “unë”-i të veçuar. Vargjet 12–17 e përshkruajnë realitetin vendimtar që është përfundit: Brahmani, vetëdijesia e pastër pa veçori dalluese, baza hyjnore e ekzistencës.

Vargu 19 na kthen në diskutimin e dualitetit themelor të mendjes/materies dhe shpirtit (Vetes):

Dije se prakriti dhe Purusha janë të dyjat pa fillim, dhe se nga prakriti vijnë gunat dhe gjithçka që ndryshon.

Përsëri përdoren termat teknike *prakriti* dhe *Purusha*. Purusha është njohësi dhe prakriti fusha. Nga bashkimi i këtyre dyjave linden të gjitha gjërat. Edhe prakriti edhe Purusha janë esenciale për krijimin e botës: asgjë nuk do të mund të ekzistonte pa bazën shpirtërore të Purushës, dhe asgjë nuk do të mund të zhvillohej në formë të manifestuar pa mendjen dhe materien e prakritit.

Me nevojën e vet për të menduar për parime abstrakte në terma njerëzorë, hinduizmi i mishëron këto dy parime të përhershme në figurat e Shivës dhe Shaktit, Babait hyjnor dhe Nënës hyjnore. Gita nuk i përmend këta dy sepse kjo vjen esencialisht nga tradita Vishnu, por në rrjedhën tjetër të madhe të besimit hindu, Shiva është Shpirti i përhershëm, Absoluti, i përfaqësuar si asi që rri larg në majen malore të paqes shpirtërore. Shakti, Nëna Hyjnore, është partnerja e tij krijuese, dhe pa të, Shiva nuk do të kishte mundur ta krijonte botën kurrë. Shakti – ajo ka emra shumë emra në manifestimet e saj të ndryshme – sundon në sferën e lindjes dhe të vdekjes; Shiva, Purusha, jeton në sferën e të pavdekshmëve. Bashkë të dytë e përfaqësojnë Brahmanin, Esencën pa-atribute të Zotëruesit pa-atribute, dhe fuqinë krijuese të Esencës së Zotëruesit që quhet maia. Kështu, pikërisht në bashkimin e Shivës dhe Shaktit linden të gjitha gjërat.

Ky kapitull thekson se Vetja, njohësi i vërtetë, është gjithmonë i papërfshirë në forcat ndërruese që luajnë nëpër fushë. Nuk ka asnjë mundësi që ndonjë shpirt të humbet përherë, se të gjitha qeniet kanë hise në natyrën e pavdekshme, të pastër të Purushës. Mund të durojmë epoka të panumërueshme të lindjes e vdekjes, por përfundimisht duhet ta gjejmë prehjen tonë në shpirtin e përhershëm. Sipas përkufizimit, asgjë që ndodh në sferën e prakritit nuk mund të ndikojë te Purusha; por natyra e saktë e ndërveprimit të këtyre dyjave është mister i thellë.

Vargu 32 e shpjegon këtë mister duke e bërë një krahasim me *akasha*, elementin më subtil të njohur nga filozofët e lashtë:

Meqë akasha e përshkon kozmosin por mbetet e panjolllosur, Vetja nuk mund të ndotet kurrë edhe pse rri në çdo krijesë.

Akasha është vetë hapësira. Siç e përshkon hapësira kozmosin, e megjithatë mbetet e pastër edhe mu në mesin e gjërave të papastra, ashtu Vetja mbetet plotësisht e pastër, edhe pse rri në të gjitha gjërat. Edhe pse duket se jeton në tokën e vdekatarëve dhe se i nënshtrohet ndryshimit dhe vdekjes, njohësi real në çdo krijesë është i pavdekje, “i fshehur në zemër”.

– D. M.

Kapitulli katërbëdhjetë: Forcat e evolucionit

Kapitulli i fundit na e dha dallimin ndërmjet Purushës dhe prakritit. Ky kapitull do të na tregojë më në detaje për natyrën e prakritit – bazës së botës së mendjes dhe të materies. Këtu Gita e shpjegon përjetimin njerëzor në terma të tri cilësive të prakritit, të njohura si *guna-t: sattva, raxhas* dhe *tamas*. Kur shpirti e arrin përndritjen shkon përtej kufizimeve të prakritit në sferën shpirtërore të Purushës. Por deri atëherë, shpirti duhet të mësojë të merret me këto tri forca të plotfuqishme.

Asnjë fjalë e vetme angleze (apo shqipe) nuk mund të jepet për t'i përkthyer fjalët *sattva, raxhas* dhe *tamas*. Cilësia e *sattva-s* i kombinon mirësinë, pastërtinë, dritën, harmoninë, balansin. Në terma të evolucionit, *sattva* është në nivelin më të lartë. *Raxhas* është energji – apo në nivelin njerëzor, pasion – që mund të jetë edhe i mirë edhe i keq. Në personalitet *raxhas* mund të shprehet në zemërim, urrejtje apo pangopësi; por po ashtu e ofron motivimin, vullnetin për të vepruar. *Raxhas* është ambicioze, që nuk është krejtësisht gjë e keqe për evolucionin e shpirtit. Definitivisht është superiore ndaj *gunës së tretë, tamas*, që e kombinon amullinë, përtacinë, errësirën, paditurinë, pandjeshmërinë. Kjo është gjendja më e ulët për sa i përket evolucionit; sepse *tamas* domethënë stabilitet i vdekur, ku nuk ndodh asgjë për të mirë apo për të keq. Edhe më keq, *tamas* mund të nënkuptojë jo veç stabilitet por edhe rrëshqitje prapa në përpjekjen e evolucionit, ku të qëndrosh pa lëvizur mund të nënkuptojë të të lënë prapa (14:18):

Ata që jetojnë në *sattva* shkojnë përpjetë; ata në *raxhas* mbeten aty ku janë. Por ata të zhyturit në *tamas* fundosen teposhtë.

Në çfarëdo personaliteti apo fenomeni, me gjasë të tri *gunat* janë prezente. Është përzierja e të trijave që e ngjyros përjetimin tonë. *Sattva* mund të jetë dominuese, me një përzierje të *raxhas* apo *tamas*. Apo mbase *raxhas* dominon, me pak *sattva* dhe një sasi të mirë të *tamas*. Në fund, personaliteti mund të jetë në thelb *tamasik*, me pak rreze të dritës së *sattva-s* dhe pak nga nxehtësia e *raxhas*. Në çdo rast, asnjë përzierje e tri *gunave* nuk është stabile, se është pikërisht natyra e prakritit të jetë në gjendje të ndryshimit të vazhdueshëm. *Gunat* janë duke u zhvendosur vazhdimisht, duke gjithmonë ndryshuar në intensitet.

Është thelbësore që *gunat*, edhe në pastërtinë dhe mirësinë e *sattva-s*, të tejkalohen (transcendohen) nëse shpirti do ta arrijë çlirimin e vet përfundimtar.

Sepse të tri gunat janë forca që operojnë brenda botës së prakritit: në fakt, tri fijet e tyre e përbëjnë tërë fabrikën e botës fenomenale. Çlirimi qëndron përtej ndikimit të prakritit, në sferën e Purushës. Kur Arxhuna i kërkon Krishnës ta përshkruajë personin që ka shkuar përtej rrjetës së prakritit, Krishna përgjigjet se një person i tillë është i shkëputur nga zhvendosja dhe ndërveprimi i vazhdueshëm i gunave. I identifikuar me Vetën, ai apo ajo e kupton intuitivisht se gunat dhe loja e tyre janë të jashtme – madje edhe emocionet dhe mendimet që duken kaq personale, kaq të brendshme, janë realisht veç lojë e prakritit. Mendimet dhe emocionet, dhe vetë ahamkara, ndalen te porta e Vetes së brendshme. Vetja rri në dhomëzën e brendshme të zemrës, gjithmonë në paqe, pavarësisht nga çfarëdo forca që mund të mësyjnë jashtë. Burri apo gruaja e përndritur mban balans të mendjes në lumturi dhe pikëllim.

Në fund të kapitullit, duke ia kujtuar përsëri fuqinë e përkushtimit (*bhakti*), Krishna thotë se Arxhuna mund t'i transcendojë gunat përmes dashurisë së patundur. Nëse ai ka përkushtim dhe ka shkuar përtej tri gunave, atëherë do të jetë i përshtatshëm për ta njohur Brahmanin.

– D. M.

Kapitulli pesëmbëdhjetë: Vetja supreme

Ky është kapitull i vështirë, se merret esencialisht me pyetjet e teologjisë dhe të përjetimit vendimtar mistik.

Krishna e zbulon se e transcendon jo veç botën e materies por edhe Atmanin e pavdekshëm që rri si “njohësi” i vetëdijshtëm brenda të gjitha qenieve. Krishna ka thënë se është Atmani; por paradoksi është se ai edhe e transcendon Atmanin. Në këtë aspektin më të lartë Krishna është Ishvara, Zotëruesi kozmik, që rri në misterin e vet. Vetja e çliruar e shijon bashkimin me Krishnën dhe jeton në shtëpinë më të lartë të Krishnës. Por Vetja nuk bëhet Krishna: shpirti i pavdekshëm, edhe kur çlirohet nga udhëtimi i tij vdekatar, nuk bëhet Zot.

Kapitulli hapet me një imazh të një peme të përmbysur, një peme botërore me rrënjë në Brahmanin që degëzohet në krijim të shumëfishtë në këtë mbretëri më poshtë. Kjo thuhet të jetë një *ashvattha* apo pemë pipali, një lloj fiku. Sikur pema bania, i çon rrënjët në ajër duke u shpërndarë lart e poshtë.

Në këtë kapitull për natyrën më të lartësuar të Krishnës, është e përshtatshme të përshkruhet “shtëpia” e tij, qëllimi më i lartë i të gjithëve. Ajo është një banesë e dritës dhe e jetës së përhershme. Pikërisht për shkak të natyrës së vet, është përtej përshkrimit të gjuhës njerëzore. Vargu 4 e përdor një fjalë elementale dhe të lashtë për realitetin vendimtar që është pothuajse e pamundur të përshkruhet, apo të mendohet: *Tat*, që thjesht domethënë “ajo”.

pastaj gjeje rrugën që nuk kthehet më. Kërkoje Atë, Shkakun e Parë, nga i cili erdhi gjithësia shumë kohë më parë.

Këtu Gita e personalizon Tat-in në atë masë sa t'i japë Asaj shtëpi: *aviaiam padam*, shtëpia e pavdekshme, qëllimi i përhershëm. *Pada* domethënë edhe këmbë apo hap, dhe është me interes këtu ta kujtojmë një mit nga Vedat. Në fillimin e kohës Vishnu i bëri tre hapa që e matën tërë kozmosin. Hapi i tretë dhe më i larti u bë botë qiellore, mbretëria e të bekuarve. Në Rig Veda (I.154.5), poeti digjet nga merakuri për ta gjetur veten në këtë shtëpi të Zotëruesit:

Shkofsha në këtë botë të bekuar
 Ku ata që i duan zotat ngazëllehen;
 Se atje, vërtet, është shoqëria e zotit të stërmadh,
 Burim mjalti në hapin më të lartë të Vishnu-s.

Gita e përshkruan shtëpinë e Krishnës si mbretëri e dritës përtej dritës së diellit (15:6):

As dielli as hëna as zjarri nuk mund t'i shtojnë asaj drite. Ky është vendbanimi im suprem, dhe ata që hyjnë aty nuk kthehen në ekzistencë të veçuar.

Këtu do të mund ta krahasojmë Gitën me Katha Upanishad (5:15):

Atje nuk shkëlqen as dielli, as hëna, as ylli,
 As vetëtimja as zjarri i ndezur në tokë.
 Vetja është drita e reflektuar nga të gjithë.
 Ai duke shkëlqyer, gjithçka shkëlqen sipas tij.

Megjithatë, madje edhe këtu, na përkujtohet se Krishna nuk jeton veç në këtë mbretëri më të lartën por edhe në botën më poshtë, ku bashkë-ekzistojnë edhe errësira edhe drita. Në misterin e tij hyjnor ai dërgon fragmente të vetes për t'u bërë Vetja e brendshme në çdo krijesë. Në këtë kuptim Vetja hyn në trup kur ndodh ngjizja, rri në trup, dhe pastaj largohet kur ndodh vdekja. Krishna është prana – frymëmarrja e vitalitetit – e trupit. Upanishadet flasin për pesë prana; këtu Gita i përmend dy më të spikaturat: prana me të cilën marrim frymë dhe prana që e tret ushqimin.

Kapitulli gjashtëmbëdhjetë: Dy rrugët

Në këtë kapitull që është më i pazakonshmi, Gita largohet nga një pamje e lartë e natyrës njerëzore dhe i përshkruan dy forca që kundërshtohen. Tendencia më e lartë, hyjnore, çon në rritjen e lumturisë dhe në rrjedhën e evolucionit të shpirtit, dhe dikur në çlirimin e tij; por është edhe një rrymë që shkon teposhtë kah vuajtja dhe skllavërimi i shpirtit. Ky kapitull është i pazakonshëm në atë se i jep vëmendje të barabartë, nëse jo në fakt më shumë, kësaj ane të errët të natyrës njerëzore. Këtu e marrim një përshkrim të detajuar të cilësive hyjnore që i çlirojnë cilësitë “demonike” që skllavërojnë (16:5):

Cilësitë hyjnore çojnë në liri; djallëzoret, në robëri. Por mos u pikëllo, Arxhuna; je lindur me attribute hyjnore.

Me ton të rrallë të zymtë, Krishna e përshkruan personin mëkatar, individin e llojit demonik – dhe duket se e di se për çka po flet. Por së pari e siguron Arxhunën se ai është i tipit hyjnor, kështu që nuk duhet të shqetësohet.

Personaliteti “demonik” është në thelb ateist. Për njerëzit e tillë jeta nuk zë fill në Zot apo në realitet hyjnor por bazohet në biologji, në merak seksual. Duke u përcaktuar për pikëpamje të ulët të natyrës njerëzore, njerëzit e tillë i shkaktojnë vuajtje vetes si dhe të tjerëve. Janë arrogantë dhe kanë shumë merake të pangopura, dhe nuk ngurrojnë të bëjnë çkadoqoftë që do t’ua sjellë atë që e duan. Krishna e pranon se ata mund t’i arrijnë meraket e tyre, duke e shijuar pasurinë dhe pushtetin, por destinimi i tyre është ferri – një ferr i krijuar nga vetë ata, shpesh pikërisht në këtë jetë, gjersa karma e tyre jep fryte.

Një nga karakteristikat më pak të pëlqyeshme të personaliteteve “demonike” është ndjenja e tyre e rëndësisë së vetes. U pëlqen të japin dhurata në mënyrë të dukshme dhe ofrojnë flijime rituale; kjo e legjitimon pasurinë e tyre dhe i bën të ndihen të respektueshëm e të vlerësuar. U pëlqen të jenë bujarë nëse kjo do t’i bëjë të duken mirë.

Krishna nuk e fsheh neverinë e tij ndaj njerëzve mizorë. Ai i thotë Arxhunës se aranzhon për ta që të linden përsëri e përsëri në botë të ashpër. Shpirtrat e tillë me sa duket nuk mund t’i pastrojnë zemrat e tyre mëkatore; duke i përsëritur mënyrat e njëjta vetjake, zhyten gjithnjë e më poshtë. Kjo është pamje e zymtë, në të cilën Gita rri veç në këtë kapitull. Por madje edhe këtu, në mes të ngrysisë, Krishna nuk thotë se një shpirt i tillë është i mallkuar përherë. Mund

të ndodhë që një krijesë e tillë mëkatore është e dënuar në lindje pas lindjeje në rrethana të vështira e të pafavorshme, duke u zhytur në gjendje të mendjes gjithnjë e më ferore; por cikli vazhdon, zgjedhja për ta ndryshuar drejtimin është gjithmonë e hapur, dhe vetë Atmani nuk mund të njolloset kurrë.

Epshi, zemërimi dhe pangopësia janë tri dyert për te ferri në të cilat Arxhuna nuk duhet të hyjë me asnjë çmim. Personi që hyn jo veç që do të dështojë ta arrijë qëllimin përfundimtar të jetës, por nuk do ta arrijë asnjë masë të lumturisë dhe të prosperitetit të qëndrueshëm.

Në sanskritisht ky kapitull quhet “Rruga e Fateve Hyjnore dhe Demonike”. Fjalët *deva*, zot, dhe *asura*, demon, nuk duhet të merren tepër fjalë-për-fjalë këtu. Shkrimet e shenjta hindu shpesh tregojnë rrëfime të betejave ndërmjet zotave dhe demonëve; kështu e dramatizojnë luftën midis të mirës dhe të keqes në botë. Asnjë personazh hyjnor nga miti hindu nuk i shpëton sfidës nga ndonjë demon. Zakonisht zoti apo perëndesha është fitimtar-e; por shpesh demoni do ta fitojë një betejë a dy, megjithëse jo fitoren përfundimtare. Krishna ka regjistër të gjatë të betejave, të lartësuar me epitete si Madhusudana, “vrasësi i demonit Madhu”. Rama, një mishërim tjetër i Vishnu-s, duhej të përballej dhe ta vriste Ravanën. Rrëfimet vazhdojnë tutje. Zotat kurrë nuk duket se pushojnë gjatë: gjithmonë është një sfidë e re ndaj autoritetit të tyre, një burim i ri i të keqes së ligë që duhet të shkatërrohet.

Mahabharata dhe Gita nuk ndalen në këto beteja mitike. Këtu interesi është më sinqerisht njerëzor, dhe kur Krishna i diskuton cilësitë “hyjnore” dhe “demonike”, nuk flet për zotat dhe demonët po për të mirën dhe të keqen njerëzore.

Kapitulli shtatëmbëdhjetë: Fuqia e besimit

Në fund të kapitullit të shkuar, Krishna i tha Arxhunës t'u kushtojë vëmendje shkrimeve të shenjta për t'i udhëzuar veprimet e tij, ashtu që të mund t'i shmanget rrugës më të poshtme që çon teprapa në një gjendje më pak të evoluuar. Tash Arxhuna dëshiron të dijë për ata që nuk e ndjekin rrugën ortodokse të përcaktuar në shkrimet e shenjta, por që megjithatë e ofrojnë një lloj adhurimi me besim në zemrat e tyre.

Në përgjigje Krishna hyn në më shumë detaje për tri gunat – sattva, raxhas dhe tamas. Ai po ashtu e thekson rëndësinë e *shraddha* apo besimit. Kjo është fjalë e vështirë. “Besimi” nuk është përkthim adekuat, dhe etimologjia e fjalës është e mjegullt; me gjasë brendësisht e ka kuptimin e “asaj që mbahet në zemër”. Do të mund të thoshim se *shraddha* jonë është tërësia e plotë e vlerave tona, ajo që vërtet e konsiderojmë të rëndësishme në jetën tonë. Çdo qenie njerëzore, thotë Krishna, është *shardhamaya*, “e përbërë nga besimi” – siç e formulon Bibla, siç mendojmë në zemrën tonë, ashtu jemi.

Këtu, si gjetiu në Gitë, *shraddha* është cilësi pozitive. Është mirë të kesh besim; e megjithatë besimi mund të jetë i llojeve të ndryshme, i cilësive të ndryshme. Besimi *sattvik* është më i evoluari, më i pastërti. Besimi *raxhasik* është dinamik, evolues, e megjithatë i njollosur me motive vetjake. Besimi *tamasik* devijon në shkretëtirë shpirtërore.

Për ta ilustruar këtë, Krishna i tregon Arxhunës se njerëzit *sattvikë* i adhurojnë deva-t – zotat e qiellit, të dritës. *Raxhasikët* i adhurojnë *jaksha-t* dhe *rakshasa-t*. *Jakshat* janë shërbyes të zotit të pasurisë; *rakshasat* janë shpirtira të fuqishëm, të frikshëm që nxiten nga epshi për pushtet dhe kënaqësi. Në fund, njerëzit *tamasikë* i adhurojnë shpirtirat e të vdekurve dhe fantazmat.

Në një digresion praktik, Krishna i përshkruan llojet e ndryshme të ushqimit që pëlqehen nga *sattvikët*, *raxhasikët* dhe *tamasikët*. Pastaj ia zbaton tri guna-t aktit të adhurimit dhe flijimit apo shërbimit pa-veten (*jaxhna*).

Vargjet 14–16 i kthehen pyetjes së rëndësishme të *tapas* apo *sadhana*, disiplinave të cilave u nënshtrohen disa, për hir të rritjes shpirtërore:

¹⁴ T'u ofrosh shërbim zotave, të mirëve, të urtëve dhe mësuesit tënd shpirtëror; pastërtia, ndershmëria, të përmbahesh në ushqime dhe jodhuna: këto janë disiplinat e trupit. ¹⁵ Të ofrosh fjalë qetësuese, të flasësh me vërtetësi, këndshëm dhe në mënyrë ndihmuese dhe t'i studiosh shkrimet e

shenjta: këto janë disiplinat e të folurit. ¹⁶ Qetësia, butësia, heshtja, vetë-përmbajtja dhe pastërtia: këto janë disiplinat e mendjes.

Gita konsideron se asnjë përparim i qëndrueshëm nuk është i mundur në rrugën shpirtërore pa vetë-disiplinë. Rrënja e fjalës *tapas* është *tap*, të jesh i nxehtë apo të vuash dhembje; dhe në fakt *tapas* mund të nënkuptojë edhe nxehtësi apo vuajtje. Kur zotërohen praktika të caktuara shpirtërore, e krijojnë një ndjesi të nxehtësisë në trup, që është shenjë e një potenciale të rritur shpirtërore. *Tapas* i referohet edhe fuqisë së fituar përmes rreptësisë shpirtërore. Krishna e largon besimin e gabuar se *tapas* domethënë nënshtrimi disiplinor apo torturimi i trupit, dhe thekson se disiplinat shpirtërore mund të jenë *sattvike*, *raxhasike* apo *tamasike*. Lloji *sattvik* i *tapas* ofrohet për qëllim vërtet shpirtëror; *tapas* *raxhasike* bëhet për ta përfituar një qëllim vetjak, me gjasë admirimin e të tjerëve. I mashtruar nga *tamas*, një person do t'i nënshtrohet praktikave të dhembshme, budallaqe për të provuar të fitojë pushtet mbi të tjerët, apo madje edhe t'i lëndoje.

Duke e ndryshuar drejtimin për një moment, Krishna e diskuton mantrën *Om Tat Sat*. *Om* është më e lashta nga mantrat hindu; është rrokja e shenjtë që është Brahmani, tingulli kozmik që dëgjohet në thellësitë e meditimit. *Tat* është “Ajo”, realiteti suprem përtej asaj që mund ta përshkruajë gjuha apo ta mendojë mendimi. Dhe *sat* domethënë edhe “ajo që është” edhe “ajo që është e mirë”. Mantra *Om Tat Sat* pohon se veç e mira ekziston realisht; fjala e kundërt *asat*, nënkupton se e keqja është kalimtare dhe prandaj nuk është reale në mënyrë vendimtare.

Vargu i fundit konkludon se asnjë veprim apo synim nuk mund ta shtojë rritjen shpirtërore nëse është “i pabesim”. Një veprim i bërë pa shradhda është *asat*, joreal; nuk mund të ketë kuptim as në këtë botë as në tjetrën.

Kapitulli tetëmbëdhjetë: Liria dhe heqja dorë

Ky kapitull i fundit i Gitës kalon nëpër shumë tema, duke filluar me një diskutim të meritave të heqjes dorë kundrejt jetës së veprimit të përfshirë personalisht. Për t'ia nisur, Arxhuna pyet për dy fjalë që përdoren zakonisht për heqjen dorë në sanskritisht: *sanniasa* dhe *tiaga*. Të dy fjalët vijnë nga rrënjët që nënkuptojnë të heqësh dorë apo të braktisësh. *Sanniasa* e mori kuptimin e specializuar të heqjes dorë nga jeta e zakonshme për ta jetuar jetën e rreptë, endacake të një pelegrini të pastrehë. Një *sanniasa* është murg: asi që nuk merr pjesë në jetë familjare dhe është tërhequr nga shoqëria. Në një kuptim, është tërhequr nga jeta. Krishna nuk e rekomandon këtë lloj të heqjes dorë. Në fakt, thotë se është e pamundur për këdo që “të heqë dorë” në këtë mënyrë, se përderisa kemi trup, duhet ta bëjmë një sasi të caktuar të punës veç për ta mirëmbajtur. Krishna nuk e këshillon braktisjen e jetës, dhe Gita në radhë të parë u drejtohet njerëzve që jetojnë “në botë” e megjithatë dëshirojnë përmbushje të çiltër shpirtërore.

Lloji i heqjes dorë që e rekomandon Krishna është *tiaga*, ku nuk është aktiviteti po merak vetjak për shpërblimet e veprimit – të punës apo të jetës – ai nga i cili duhet të hiqet dorë. Arxhuna këshillohet t'i përmbushë të gjitha përgjegjësitë e tij, por pa motiv vetjak. Në veçanti, nuk do të duhej të hiqte dorë nga tri veprat e mëdha të virtytshme – flijimi, dhënia dhe disiplinat shpirtërore.

Pasi ia ka bërë të qartë Arxhunës se heqja dorë është esenciale, Krishna vazhdon të shpjegojë se heqja dorë mund të jetë e tri llojeve, varësisht nga guna që e dominon personalitetin e individit. Siç mund të pritet, heqjet-dorë raxhasike dhe tamasike lënë diçka për t'u dëshiruar.

Shumë herë Krishna ka thënë se heqja dorë nga frytet e punës është esenciale. Mbase vargu në kapitullin 2 e ka thënë më së miri – se kemi kontroll ndaj punës dhe veprimeve tona, por nuk i kemi në dorë rezultatet. Fjala *karma-fala-tiaga* shfaqet përsëri e përsëri, dhe përkthimi fjalë për fjalë është “heqja dorë nga frytet e veprimit”. Në këtë kapitull të fundit, fjalë për fjalë “Liria [moksha] që vjen nga heqja dorë”, Krishna e përmbledh mësimin e tij se në punë, në jetë njeriu nuk duhet të nxitet nga një merak vetjak për asnjë lloj shpërblimi, se puna e tillë e obsesive mundet veç ta pengojë zhvillimin e plotë shpirtëror. Përveç kësaj, thekson Krishna, kur veprojmë nga ngjitja vetjake, duhet të marrim pjesë plotësisht në rezultatin, karmën, e secilit mendim, fjalë dhe vepër; dhe megjithëse këto rezultate mund të jenë ajo që e kishim merak, mund të jenë edhe diçka që nuk e kishim merak fare, apo pak nga të dyjat (18:12):

Ata që janë të lidhur me shpërblimin personal do t'i korrin pasojat e veprimeve të tyre: disa të këndshme, disa të pakëndshme, disa të përziera. Por ata që heqin dorë nga çdo merak për shpërblim personal shkojnë përtej asaj që e arrin karma.

Në këtë jetë nuk mund të jemi kurrë të sigurt se gjërat do të shkojnë siç janë planifikuar.

Në vargun 13 filozofia Sankhia përmendet përsëri. Studiuesit besojnë se në kohën kur u kompozua Gita shkolla Sankhia ishte në fazë të hershme të zhvillimit, e megjithatë edhe këtu e shohim metodën karakteristike të kategorizimit gjithëpërfshirës. Duke i përdorur kategoritë Sankhia të tri guna-ve, Gita vazhdon të japë më shumë detaje për punën, që është e tri llojeve – satvvike, raxhasike dhe tamasike. Ngjashëm, bërësi i punës tregohet se dominohet nga një prej këtyre cilësive të kudo-përhapura. Në një pasazh shumë interesant Krishna flet për tri lloje të lumturisë – zbatim praktik i teorive abstrakte të Sankhia-s (18:36-39):

³⁶ Tani dëgjo, Arxhuna: janë [edhe] tri lloje të lumturisë. Me përpjekje të qëndrueshme, njeriu vjen te fundi i pikëllimit. ³⁷ Ajo që duket si helm në fillim, por ka shije si nektar në fund – ky është gëzimi i sattva-s, i lindur nga një mendje që është në paqe me veten. ³⁸ Kënaqësia nga shqisat duket si nektar fillimisht, por është e hidhur si helm në fund. Ky është lloji i lumturisë që u vjen raxhasikëve. ³⁹ Ata që janë tamasikë i nxjerrin kënaqësitë e tyre nga gjumi, përtacia dhe materiet dehëse. Edhe në fillim edhe në fund, kjo lumturi është deluzion.

Duke e ndjekur botën e punës, dhe mënyrën si kontribuon ajo në rritjen shpirtërore, Gita e jep një shpjegim të thjeshtë të kastës në këtë kapitull. Gita nuk është veçanërisht e interesuar për kastën – hierarkinë shoqërore të shoqërisë hindu – por e gjejmë një shpjegim të shkurtër këtu. *Sanniasi*, murgu që ka hequr dorë, e ka lënë shoqërinë dhe prandaj nuk i përket asnjë kaste, por Krishna nuk ia thekson atë drejtim Arxhunës. Në vend të kësaj, ai dëshiron që Arxhuna të bëjë jetë aktive. Krishna i tregon se përkushtimi ndaj detyrës së tij është më i miri. Është më mirë ta bësh punën tënde, qoftë edhe në mënyrë të papërsosur, se sa të provosh ta marrësh ndonjë punë tjetër. Më pas përshkruhet puna e duhur për secilën nga katër kastat. Në përgjithësi, Gita ka pikëpamje liberale ndaj kastës,

dhe do të ishte e gabuar të interpretohej ky kapitull si asi që mbështet sistem të ashpër të kastave.

Pjesa e fundit e këtij kapitulli, vargjet 50 e tutje, e japin një përshkrim të personit që e ka arritur *siddhi*-n – suksesin apo përsosjen – në jetën shpirtërore dhe që vazhdon të bashkohet me Brahmanin.

Në vargun 61 Krishna i kthehet një teme të preferuar – Zotëruesi rri në zemrat e të gjitha qenieve.

Zotëruesi rri në zemrat e të gjitha krijesave dhe i rrotullon rreth rrotës së maias.

Por këtu e shton një shpallje befasuese: Zotëruesi rri në të gjithë, e megjithatë “i rrotullon” nëpër maia si të ishin lodra të montuara në një makinë. Pasi e ka trazuar Arxhunën me këtë imazh mahnitës, Krishna e risiguron se ai mund të shpëtojë nga makina, rrota e kohës, përmes përkushtimit ndaj Zotit. Nëse me gjithë zemër strehohet në Zotëruesin përbrenda, atëherë përmes dashamirësisë hirore të Krishnës do të gjejë paqe.

Si fjalë të tij pothuajse të fundit, Krishna ia kujton Arxhunës se e çmon dhe e do shumë. Përmes përkushtimit, Arxhuna do të jetë në gjendje ta gjejë rrugën e tij, dhe duhet të mos harrojë se Krishna ndjen dashuri të thellë për të.

Marrëdhënies ndërmjet mësuesit dhe nxënësit i jepet një fjalë lamtumire, pjesërisht paralajmëruese. Krishna nuk do që këto të vërteta të thella t’i thuhesh askujt që nuk është gati. Askush që i mungon përkushtimi apo vetë-kontrolli, që nuk do të dëgjojë udhëzime shpirtërore apo që tallet me to, nuk duhet të pranohet si student. Akti i shenjtë i dhënies së udhëzimeve shpirtërore nuk mund të ndërmerret lehtë. Është puna më e lartë, dhe burri apo gruaja që e bën atë është më i dashuri për Krishnën.

Në fund, Krishna e pyet Arxhunën se a ka kuptuar. Arxhuna thotë po, konfliktet e tij kanë mbaruar; është gati t’i ndjekë udhëzimet e Krishnës. Kjo e përmbyll dialogun ndërmjet Krishnës dhe Arxhunës dhe udhëzimet e veçanta të Gitës. Sanxhaja, që po ia rrëfente poemën mbretit të verbër Dhritarashtra, i shton disa vargje të fundit të uratës. Ai e ka “parë” këtë dialog përmes vizionit të tij mistik, të dhënë nga dashamirësia e hirshme e Viasës. Veç kujtimi i kësaj bisede të mrekullueshme ia ngrit flokët në ekstazë, dhe kur e kujton bukurinë e mrekullueshme të Krishnës, gëzimi i tij është i pakufi.

– D. M.

Bibliografia

Easwaran, Eknath. The Bhagavad Gita:(Classics of Indian Spirituality).
Vol. 1. Nilgiri Press, 2007.

Online

<https://botimetr.b.wordpress.com/>

Licensimi

Ky publikim lëshohet nën licensën



Attribution-NonCommercial-ShareAlike

CC BY-NC-SA

This license lets others remix, tweak, and build upon your work non-commercially, as long as they credit you and license their new creations under the identical terms.

që nënkupton se i lejon të tjerët ta shkarkojnë dhe ta shpërndajnë te të tjerët, ta ndryshojnë punën në mënyrë jokomerciale, përderisa e përmendin burimin dhe i licencojnë krijimet e reja nën terma identike. Për më tepër, shih:

<http://creativecommons.org/licenses/>